



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E AUDITIMIT

**PROJEKT RAPORT
MBI
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE FINANCIAR NË AGJENCINË E
MBIKËQYRJES POLICORE.**

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) funksionon në zbatim të ligjit nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”. AMP është një institucion i mbikëqyrjes së jashtme të punonjësve me grada të PSH, GR dhe MZSH me kompetenca parandaluese ashtu edhe represive ndaj çdo sjellje jo etike, abuzimit me detyrën, shkeljes së ligjit dhe paligjshmërisë në përmbushje të detyrës funksionale dhe të performancës së strukturave. Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale si dhe i shkeljeve të ligjit, inspektimi dhe trajtimi i ankesave, vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të veçantë të strukturave, objekt i veprimtarisë së saj.

Marrëdhëniet e punës për personelin e kësaj njësie shpenzuese rregullohen në zbatim të kërkesave ligjore e nënligjore të ligjit nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, të VKM nr.532, datë 29.07.2022 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e AMP-së”, të ligjit për Nëpunësin Civil dhe në Kodin e Punës.

Menaxherët kryesorë të Institucionit për periudhën e auditimit janë: Drejtori i Përgjithshëm, z.Muhamet Rrumbullaku deri në Shtator 2022, z.Ardi Veliu deri në Tetor 2023 dhe në vijim z.Florian Sulejmani; Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse z.Gëzim Sala dhe Shefi Sek.Buxhet/Financës znj.Pranvera Hajdini për të gjithë periudhën e auditimit e në vijim.

Objekti i auditimit: Në këtë auditim u synua dhënia e një opinioni të arsyeshëm duke siguruar Titullarin e njësisë së audituar dhe Ministrin e Brendshëm mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet identifikimit me profesionalizëm të fushave sipas nivelit të rrishtit duke filluar nga fushat me rrisht të lartë, evidentimit të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

Qëllimi i auditimit: Të vlerësojë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë njësi dhe në tërësi, veprimtarinë ekonomike dhe administrative në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara për kryerjen e misionit që ka kjo njësi. Nëpërmjet rekomandimeve të përshtatshme, të ndihmojë Institucionin e AMP-së, në realizimin e objektivave duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm për një përdorim, sa më efektiv e transparent të fondeve të akorduara si dhe të burimeve në përdorim të këtij institucioni.

Në mënyrë të përmbledhur paraqesim gjetjet e rezultuara gjatë auditimit të këtij institucioni sipas nivelit të prioritetit, për të cilat janë lënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së organizatës për të ardhmen, si më poshtë:

- Auditimi për funksionimin e kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK-së;

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e AMP-së e miratuar me VKM nr.532/2022, ka procedura të shkruara, por rezulton se në këtë rregullore mungon përshkrimi dhe detyrat sipas organizimit strukturor të AMP-së, mungon mënyra e organizimit të drejtorive në qendër dhe sektorëve në varësi të tyre si dhe mungon organizimi i drejtorive rajonale dhe sektorëve përkatës.

-Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, referuar germës (i) të nenit 16, të ligjit 128/2021 për AMP, janë miratuar përshkrimet e punës nëpërmjet procedurave standarde për drejtoritë përbërëse dhe sektorët e varësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të AMP-së, por rezultoi se për Drejtoritë Rajonale nuk janë hartuar dhe miratuar procedura standarde, përshkrimet e punës dhe rregullat për organizimin, funksionimin dhe raportimin e këtyre strukturave.

-Referuar organizimit dhe hierarkisë së strukturës së miratuar të AMP-së rezultoi se; nuk ka një raport studimi objektiv/të përshtatshëm mbi organizimin referuar veprimtarisë së mbikëqyrjes, detyrave funksionale, numrit të punonjësve, shtrirjes së territorit ku kryhet veprimtaria e Drejtorive në Qendër (Hetimi dhe Inspektimi/Ankesa) në raport me Drejtoritë Rajonale. Konkretisht; Drejtoria Qendrore e AMP-së është e përbërë nga 6 drejtori ku ndër të tjera është Drejtoria e Hetimit (e përbërë nga 3 sektorë, gjithsej me 12 punonjës) dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave (e përbërë nga 3 sektorë, gjithsej me 16 punonjës), referuar ushtrimit të aktivitetit të Drejtorisë së Hetimit mbulon/mbikëqyr strukturat e veçanta të DPPSH-së dhe vetë DPPSH, ndërsa Drejtoria e Inspektimit, inspekton me program pune Institucionet e DPPSH, trajton edhe ankesa. Ndërsa Drejtoritë Rajonale kanë në përbërje 2 sektorë të emërtuar, Sektori i hetimit dhe ankesave (1) dhe (2) të përbërë nga disa specialistë 2-3 dhe referuar ushtrimit të aktivitetit të secilës Drejtori Rajonale mbulon/mbikëqyr strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë, Kufi Migracionin, Komisaritetet përkatëse në 2 Qarqe të territorit të RSH (shtrirje e gjërë territoriale), nga ana e cdo specialisti me atributet e OPGJ, kryhet hetimi edhe trajtimi i ankesave të administruara në këto drejtori por edhe të deleguara nga Drejtoria Qendrore.

-Me urdhër të titullarit nr.350 datë 29.09.2022 në cilësinë e nëpunësit autorizues, është bërë delegimi i disa detyrave për Zv/ Drejtorin dhe Drejtorëve të Drejtorive në qendër. Ky urdhër delegimi në mbështetjen ligjore të përcaktuar rezulton se nuk i referohet Ligjit 10296 /2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, për rrjedhojë as nenit 15 “*Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave*” si dhe në disa nga detyrat e deleguara Drejtori të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse lidhur me nënshkrimin e dokumentacionit për raportimin periodik të treguesve buxhetor, prokurimeve, investimeve, shpenzimeve, rezulton se ky delegim, është në mospërputhje me germën (f) të pikës 4 të nenit 9 të Ligjit 10296 /2010, pasi këto raportime janë detyrë funksionale e hartohen nga nëpunësi zbatues e si i tillë nuk mund edhe të raportohen, nënshkruhen në cilësinë e nëpunësit autorizues.

-Me shkresë nr.2396, datë 26.10.2022 nga Drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues është bërë delegimi i disa detyrave shifes së sektorit të financës, referuar këtij delegimi pika e parë “*Përgatitja e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike*” është një detyrë e cila nuk duhet të delegohet, veprim në mospërputhje me pikën 4 të nenit 12 të Ligjit 10296 /2010 “*Për menxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar.

-Për nëpunësit civil të AMP, përcaktimet e klasave dhe shtesat për kushte e natyrë e vecantë pune janë bërë në lidhjen 2, të VKM-së 321, datë 31.05.2023 “*..Për pagat e punonjësve të AMP-së*”, referuar ligjit për nëpunësin civil por edhe ligjit nr. 35/2023 “*Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike*”, AMP është pjesë e administratës publike e si e tillë nëpunësit civil të këtij

institucioni duhet të përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar.

-Për periudhën e audituar nga ana e AMP-së Drejtoria e Përgjithshme, janë hartuar dhe miratuar regjistrat e riskut përmbledhës, regjistër në të cilën janë evidentuar kryesisht risqet e Drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse, mungon identifikimi dhe vlerësimi i risqeve nga ana e drejtorive të tjera përbërëse të Drejtorisë Qëndrore, si dhe identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të Drejtorive Rajonale të AMP-së. Regjistrat e miratuar nuk i përmbahen plotësisht formatit të aneksit nr.5 të MFK-së; konkretisht nuk janë përcaktuar të gjitha objektivat referuar prioriteteve të AMP-së, si dhe për objektivat e parashikuar në regjistrin e riskut nuk janë identifikuar për cdo objektivat risqet e mundshme, për rrjedhojë edhe aktivitetet e menaxhimit të risqeve nuk janë të plota.

-Mungonte harta dhe manuali i proceseve të punës për cdo funksion të miratuar në organikën dhe strukturën e AMP-së.

-Mungon kontrolli dhe dokumentimi lidhur me saktësinë e hartimit sipas nivelit strukturor të objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur). Në analizën vjetore e veprimtarisë së AMP-së për vitin 2022-2023 konstatohet se, nuk evidentohen produktet dhe aktivitetet e përfunduara me impakt në produktin përkatës dhe mosrealizimin e objektivave referuar prioriteteve, përgjegjësia e mos përmbushjes.

-Nga auditimi i realizuar lidhur me komponentët e MFK si dhe dinamikën e punës në Drejtorinë Rajonale të AMP-së, të cilat janë struktura teknike operacionale dhe administrative në nivel vendor, u evidentuan mangësi sa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm të cilët nuk funksionojnë sic duhet. Mungesë të përshkrimeve të punës, regjistrave të riskut, mospërcaktimi i zonës mbikqyrëse në urdhrat e emërimit të specialistëve hetim/ankesës, mos ndarje pune specifike për secilin specialist me impakt në vlerësimin e produktit të punës.

-Mungesë të posteve të punës në komisariate si rezultat i mungesës së rrjetit elektronik të dedikuar të AMP-së (Intranetit), ky sistem elektronik ekziston vetëm në Drejtorinë Vendore të Policisë, me impakt/ndikim në veprimtarinë operacionale, përmbushjen e plotë të misionit referuar edhe shtrirjes së gjërë territoriale të Drejtorive Rajonale.

-Drejtorinë Rajonale trajtonin ankesat e administruara nga vetë ato por edhe ankesat e deleguara nga Drejtoria e inspektimit dhe ankesave në Drejtorinë Qëndrore të AMP-së, rezultoi se aktivitetin/kohën më të madhe të punës për specialistët e merrte trajtimi i ankesave (detyrim ligjor), numri më i madh i ankesave ishin të pabazuara dhe të pa provuara si dhe ankesa të ripërsëritura.

Rekomandim; Menaxhimi i lartë i AMP-së, referuar gjetjeve të konstatuara të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në përputhje me përcaktimet ligjore të komponentëve të MFK-së; hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara; hartimin e objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur); përmirësimin e regjistrit të riskut i cili duhet të jetë i konsoliduar me të gjithë drejtorinë dhe sektorët; rishikimin e strukturës dhe organikës, përfshirjen, konform akteve ligjore e nënligjore për administratën publike, duke mundësuar optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion, me qëllim mundësimin e vendimmarrjeve cilësore, performancë në arritjen e objektivave të AMP-së.

- Auditimi i sistemit të procedurave ligjore të prokurimit të fondeve publike;

Nga auditimi i hartimit të regjistrave të parashikimit dhe realizimit të prokurimit sipas periudhave respektive të audituara u konstatua se, nuk i përmbaheshin plotësisht kërkesave të përcaktuara dhe formateve Tip të Udhëzimit të APP nr.4 datë 18.06.2021. Në regjistrin e parashikimit për vitin kalendarik/buxhetor përfshiheshin edhe procedurat e prokurimit të realizuara në vitin paraardhës

të cilët e kishin kohëzgjatjen e realizimit në periudhë 2-3 vjeçare, ndërkohë që në regjistrin e parashikimit duhet të evidentohen vetëm ato procedurat të cilat janë parashikuar për tu realizuar gjatë vitit kalendarik/buxhetor për plotësimin e nevojave të institucionit.

-Në regjistrin e realizimit nuk evidentoheshin të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit tip, por regjistroheshin edhe të dhëna të panevojshme si rezultat i regjistrit të parashikimit i cili përmbante procedurat e realizuara në vitin parardhës.

-Në sistemin elektronik të APP-së referuar regjistrave të prokurimeve (parashikim dhe realizim) u konstatua se, për procedurat e prokurimit marrëveshje kuadër nuk pasqyroheshin në sistemin elektronik lidhja e minikontratave të marrëveshjes kuadër, veprim në mospërputhje me pikën 7 të Manualit Teknik të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Konkretisht “Sa i takon krijimit në sistem të njoftimeve të tjera të kontratave që do të nënshkruhen (minikontratat) gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, duhet të krijohen si element/e në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit...”.

-Për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, me objekt “Rritja e kapaciteteve tekniko shkencore për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambiental dhe vëzhgimit sekret” me fond limit 13.324.668 lekë pa tvsh, rezultoi se; Kërkesa e paraqitur për nevojën e këtyre mallrave, projekti, duhet të ishte e mirëargumentuar dhe e konkretizuar me nevojën reale, sasitë konkrete të domosdoshme dhe argumentet përkatëse. Argumentimi përse këto mallra duhet të klasifikohen si procedura sekrete në përputhje me listën e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror për dokumentacionin e AMP-së të përcaktuara në Vendimin nr.-L datë 17.11.2021 seksioni D; Nr.1-67. Në testimin e tregut nuk dokumentohet qartë nëse dërgimi i listës së mallrave për ofertë është e shoqëruar me specifikimet teknike të hartuar nga specialistët e fushës. Si dhe nuk ishin administruar në dosje shkresat e dërguara me protokoll për marrje oferte e si rezultat edhe ardhja e ofertave me protokollin zyrtar të institucionit, veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit të MFK-së.

-Referuar dokumentacionit në dosjen e procedurës së prokurimit Rikonstruksion/Përforcim i godinës rezultoi se, ato ishin të administruara të nënshkruara dhe të inventarizuara, por konstatohet se nuk kishin një numër protokollit në vijimësi, pra për procedurat e prokurimit në librin e protokollit duhet të vijoj me numrin e protokollit të urdhrin të prokurimit e deri në përfundim të procedurës protokoll/fraksion, kjo për efekt të mirëadministrimit dhe dokumentimit hap pas hapi të procedurave prokuruese, gjurmës së auditimit sipas komponentit e aktivitetit të kontrollit.

Rekomandim: Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet përcaktimeve me procedure standarte, të të gjitha fazave dhe veprimet konkrete që duhet të ndiqen për realizimin e procedurave prokuruese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (nisur nga kërkesë/nevoja për shërbim ose mallra dhe deri në marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave), referuar akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen dhe sigurinë dhe akteve ligjore e nënligjore për mirëpërdorimin dhe mirëadministrimin e fondeve buxhetore.

-Drejtori i Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e regjistrave të prokurimeve në zbatim të plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e APP-së nr.4 datë 18.06.2021, të azhurnohet regjistri në sistemin elektronik të APP-së duke pasqyruar minikontratat e lidhura për procedurat marrëveshje kuadër.

-Për të gjitha procedurat prokuruese, dokumentacioni përkatës për realizimin e procedurës ti referohet një numri protokollit (urdhrit të prokurimit) dhe të vijohet me të njëjtin protokoll me fraksion deri në përfundim dhe arkivimin e dosjes së prokurimit.

-Auditimi i pasqyrave financiare/bilanci;

Nga auditimi i mbylljes së pasqyrave financiare/bilancit për vitin ushtrimor 2022 dhe 2023, u konstatua se situata financiare e institucionit të AMP pasqyrohet me vërtetësi. Nga auditimi u konstatuan disa mangësi në pozicionimin e llogarive financiare në bilancin kontabël por pa cënuar vërtetësinë e shifrave që bartin pasqyrat financiare, konkretisht:

-Llogaria 423,429, “*Personeli, paradhënie, defiçite gjoba*”, në vitin 2023 rezulton me shumën 20,010,329 lekë, pozicionimi i kësaj shume në këtë llogari është bërë i gabuar, pasi kjo vlerë përfaqëson detyrimet e institucionit për pagat e punonjësve për muajin Dhjetor dhe duhej që në pasqyrën e aktivitetit të paraqitej në llogarinë 4342, “*Operacione me shtetitn (të drejta)*”, që është e barabartë me shumën në pasiv të bilancit të llogarive 42, “*Detyrime ndaj personelit*”, 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim e taksa*”, 435 “*Sigurimet shoqërore*”, dhe 436 “*Sigurimet shëndetsore*”.

-Llogaria 468 “*Debitor të ndryshëm*” me shumën 1,191,994 lekë, kjo shumë është pozicionuar gabim në pasiv të bilancit në llogarinë 475 “*Të ardhura për t’u regjistruar*”, ndërkohë kjo shumë duhet të pozicionohet në kredi të llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”.

-Gjendja debitore e llogarisë 423,429 “*Personeli, paradhënie, defiçite gjoba*”, plus llogarinë 468 “*Debitor të ndryshëm*”, në aktiv të bilancit duhet të jenë të barabarta me gjendjen kreditore të llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”, në pasiv të bilancit.

Llogaria 4341, “*Operacione me shtetin (detyrime)*”, në pasiv të bilancit ka pasqyruar për vitin 2022 vlera 229,572 lekë dhe për vitin 2023 vlera 529,138 lekë këto vlera duhet të pasqyroheshin në llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, sepse shumat analitike që përfaqësojnë janë detyrimet e institucionit kundrejt OE për faturat e pa paguara të muajit Dhjetor.

-Nuk ishin klasifikuar sipas planit kontabël llogaritë 31 “*Materiale*” dhe 32 “*Inventari i imët*”.

-Likujdimi i situacioneve pjesore të investimit për shtesë kati në godinën e AMP janë pasqyruar në bilancin kontabël në llogarin 212, (*Ndërtesa e Konstruksione*), kontabilizim i gabuar, duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 231, (*Investime, Për aktivet afat gjata materiale*), deri në përfundim të investimit, me akt marrjen në dorëzim të objektit.

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori i financës, të marrin masat e duhura për sistemimin, pozicionimin dhe kontabilizimin e veprimeve në llogaritë përkatëse në bilancin kontabël të vitit 2024, duke zbatuar planin kontabël dhe standardet të miratura të kontabilitetit.

- Auditimi i dokumentacionit kontabël dhe procesit të inventarizimit fizik të aktiveve të institucionit;

Nga ana e sektorit të finances, dokumentacioni i kontabilitetit regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj), mbaheshin në format elektronik (excel), për të cilat nuk kishte gjurmë të nënshkrimit dhe arkivimit në sekretarinë e institucionit, me impakt në mosvlerësimin e rrishtit për humbjen e të dhënave dhe gjurmimin e veprime të kryera në mënyrë kronologjike dhe sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Dokumentacioni i administruar nga specialistja e financës e ngarkuar për mbajtjen e inventarëve, vlerave monetare dhe kontabilizimin e veprimeve, nuk paraqet siguri të arsyeshme pasi ky dokumentacion mbahej në format elektronik (excel), i cili nuk ishte i printuar e i nënshkruar dhe as i arkivuar për periudhat e audituara, me impakt në regjistrimin e veprimeve kronologjike dhe sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë etj.

-Mungonte gjurma e rakordimit periodik midis specialistit të financës dhe magazinierit në partitarët aktiveve.

-Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, nuk është dokumentuar dhe rakorduar saktësisht, sektori i financës nuk ka kryer përpara procesit të inventarizimit fizik, rakordimin dhe dokumentimin me procesverbal të llogarive të aktiveve materiale, me gjendjen në magazinë dhe librave kontabël të financës. Komisionet e inventarizimit fizik për asetet në administrim nga institucioni ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve duke dokumentuar procesin e inventarizimit bazuar në fletë inventarët kontabël të llogarisë të nxjerra e nënshkruara nga specialisti i financës.

-Komisioni i inventarizimit për vitin 2023 kishte konstatuar në 9 raste me PV, teprica dhe mungesa të aktiveve si dhe parregullsi në administrimin dhe dokumentimin e aktiveve në përdorim të punonjësve në Drejtoritë Rajonale por këto nuk dokumentoheshin me proces verbal rakordimi përfundimtar, ku të pasqyrohej gjendja mes inventarve fizik dhe gjendjes kontabël, për rrjedhojë nuk saktësohet sistemimi i aktiveve që kanë në përdorim punonjësit, ku të kryheshin dhe të kontabilizoheshin diferencat eventuale (nëse ka). Në raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik nuk kanë rezultuar diferenca dhe teprica, për rrjedhojë sistemimi konstatimeve të mësipërme rezulton të jetë bërë extra kontabël.

-Me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”, janë nxjerrë nga përdorimi 2 (dy) Motoçikleta të cilët nuk figuronin në inventarët e institucionit, pavarësisht se ishin pronë e institucionit.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” përgjegjësi e nëpunësit zbatues dhe sektorit të financës.

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori i financës të dokumentojë dhe administrojë librat kontabël në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore të kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik. Procesi i inventarizimit fizik dhe dokumentimi i tij të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Auditimi i sistemit të burimeve njerëzor dhe trajtimit të punonjësve me paga e të ardhura të tjera: Referuar lëvizjeve të personelit, emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve për periudhën e audituar, lëvizje të cilat mbaheshin edhe në databazën e personelit (e cila duhet përditësuar në vazhdimësi) bazuar në strukturën e re të miratuar, u evidentua se nga ana e ish titullarit të institucionit janë emëruar 15 punonjës pa proces konkurimi, (2 punonjës gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2022, 13 punonjës në vitin 2023) për 5 nga punonjësit e emëruar pa konkurim, nga ana e institucionit është vepruar duke u kryer procedurat e konkurimit për ta legjitimuar emërimin konformë akteve ligjore e nënligjore të AMP-së.

Emërimi i punonjësve pa kryer procedurat e konkurimit, pa nënshkruar kontratën e punës është në mospërputhje me nenet 51-57 “Emërimi dhe ecuria në karrierë” të Ligjit 128/2021 “Për AMP” dhe me nenet 67-85, Pjesa 5, Kreu I, “Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë” të VKM nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP”, me impakt/ndikim negativ në buxhetin e shtetit, pasi referuar pikës (g) të nenit 85 të VKM-së nr.532/2022, është përcaktuar se periudha e qëndrimit në punë në AMP është 5 vite, ky përcaktim bën që lëvizjet e punonjësve largimet e tyre të mos shoqërohen me efekte financiare shtesë dhe si rrjedhojë të ketë edhe një qëndrueshmëri në punë, pasi institucioni investon nëpërmjet shkollimit/trajnimeve etj, përgjegjësi e Ish Titullarit të AMP-së.

-Bashkëlidhur listpagesave, dokumentacioni justifikues urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të hartuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore për lëvizjet, transferimet, emërimet dhe largimet, rezultoi se, në urdhrat e emërimeve të punonjësve të AMP-së, nuk evidentoheshin saktë elementët përbërës

të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsia në punë, me impakt në saktësinë e elementëve financiar të pagës, *veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit si dhe detyrat funksionale sipas përshkrimeve të punës për burimet njerëzore.*

Rekomandim; Menaxhimi i lartë i institucionit, për pranimet dhe emërimet në punë të punonjësve të AMP-së të veprojnë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të ligjit 128/2021 “Për AMP” dhe VKM nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP”, referuar kriterëve të përcaktuara për funksionin dhe përshkrimin e punës.

-Sektori i Burimeve Njerëzore në hartimin e urdhrave për lëvizjet, transferimet, emërimet të evidentojë saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsinë në punë.

-Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme;

Nga 9 rekomandimet të lëna në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme rezulton se, janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime dhe 5 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara e në proces zbatimi. Moszbatimi i plotë i rekomandimeve dhe në afat të cilat janë të pranuar nga Institucioni për tu zbatuar sjellë mospërmirësimin si dhe sa duhet të procedurave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rekomandim; Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masat e menjëhershme për zbatimin e plotë të rekomandimeve të trajtuara në pikën e parë në këtë material. Të hartojë planin e veprimit duke përfshirë të gjitha rekomandimet, të përcaktojë afatet, persona përgjegjës dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e tyre. Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas planit të veprimit.

-Auditimi i shërbimit të armatimit;

Dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (*armë, municione e paisje speciale*), nuk plotësohet i plotë sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit siç dhe përmban formati i miratuar i dokumentit (*emërtesa, njësia, sasia, çmimi, vlera, etj*). Gjithashtu regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave pa përcaktuar çmimin përkatës dhe vlerën e transaksionit. Vlera e armatimit municioneve e paisjeve speciale nuk ishte pasqyruar në kontabilitet dhe në bilancet kontabël.

Rekomandim; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me sektorin e armatimit në DP Policisë së Shtetit, të marrin masat që mallrat e materialet, (*armë, municione e paisje speciale*), të regjistruara deri më tani vetëm në sasi, të bëjnë përcaktimin e çmimeve të tyre dhe në vijimësi dokumentacioni të plotësohet i plotë duke i regjistruar me çmim dhe vlerën e tij. Të përfshihet në bilancin kontabël të Institucionit vlera e armatimit, municionit dhe paisjeve speciale, sipas inventarit, me mbylljen e vitit ushtrimor 2024.

- Auditimi i shërbimit të autotransportit;

Nga auditimi i dokumentacionit të administrimit dhe shfrytëzimit të mjeteve u konstatua se nga ana e AMP nuk është kryer pranë DRTRR Tiranë ndryshimi i pronësisë/çertifikatave të pronësisë së automjeteve, nga QSHAMT në pronësi të AMP, kjo për arsye se automjetet janë dorëzuar nga QSHAMT në Dhjetor 2021, pesë muaj nga dalja e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin kapital të automjeteve”, çka do të thotë se ndryshimi i pronësisë është kërkuar përtej afatit 30 ditorë, që parashikon neni 93 pika 1 e kodit rrugor të RSH, dhe sipas pikës 4 të këtij neni penaliteti me gjobë shkon nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë, ku për 27 mjete ky penalitet shkon në 540,000 lekë penalitete me impact në buxhetin e shtetit.

Rekomandim: Menaxhimi i lartë i AMP-së, Drejtoria e financës dhe e shërbimeve mbështetëse, të marrë masat e nevojshme procedurale, duke shmangur penalitetet për ndryshimin e çertifikatës së pronësisë së mjeteve që ka inventar.

Në përfundim të këtij auditimi, referuar gjetjeve të evidentuara më sipër, si dhe në trajtimin më të hollësishëm në pjesën “Gjetje e konkluzione” në vijim vlerësojmë se, AMP, ndonëse është përpjekur për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushat përkatëse evidentohen gjetje, për të cilat nuk janë marrë masat e mjaftueshme procedurale dhe administrative për funksionimin me eficiensë të sistemit të kontrollit të brendshëm, ka vend për identifikimin e kontrolleve të munguara, forcimin e kontrolleve ekzistuese, duke u mbështetur në vlerësimin e riskut për secilën nga fushat objekt i veprimtarisë së këtij institucioni.

II. HYRJE

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.154 datë 19.10.2023, “Për miratimin e Planit Vjetor të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024”, ka dalë autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit të auditimit nr.prot 6719, datë 10.06.2024. Audituesit e ngarkuar për kryerjen e auditimit fillimisht kanë plotësuar dhe konfirmuar deklaratën e pavarësisë e cila është miratuar nga drejtuesi i njësisë së auditimit. Në zbatim të autorizimit, u përgatit dhe u dërgua në organizatë, njoftimi për fillimin e auditimit nr.prot 6719/1, datë 10.06.2024. Për realizimin e angazhimit të auditimit të kombinuar, grupi auditimit u bazua në respektimin e akteve ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e AMP-së dhe aktet në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Grupi ka rënë dakord mbi fushat e auditimit, zyrën e grupit të punës, linjat e komunikimit etj, duke plotësuar dhe konfirmuar formularin standard nr.7 “Takimi fillestar me organizatën”. Fillimisht grupi i punës u njoh me objektivat e këtij Institucioni për periudhën për të cilën do kryhej auditimi. U bë ndarja e detyrave midis anëtarëve të grupit duke caktuar përgjegjësitë individuale të audituesve. Në zbatim të manualit të auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, u hartuan pyetësorët në përmbushje të kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm dhe u bë vlerësimi i riskut si dhe identifikimi i fushave më të rëndësishme për tu audituar. Duke marrë dhe vlerësimin e riskut në programin vjetor të AMP-së “I lartë” për shkak të kompleksitetit dhe materialitetit të këtij Institucioni, auditimi u shtri edhe në fusha të rezultuara me risk të mesëm e të ulët.

U përgatit programi i punës për auditim të kombinuar duke marrë në konsideratë riskun e vlerësuar më parë dhe kohëzgjatjen e auditimit.

Gjatë auditimit në terren dhe në përfundim të punës, grupi i i auditëve, ka diskutuar me personat përgjegjës mbi gjetjet e rekomandimet të cilat janë dokumentuar nga audituesit mbi bazën e evidencave mbështetëse. Auditimi u krye në zbatim të standardeve të miratuara për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Projekt Raporti i Auditimit, u hartua referuar gjetjeve të auditimit duke evidentuar dhe rekomandimet për të përmirësuar funksionimin e njësisë në të ardhmen.

III. METODA E AUDITIMIT

Shërbimi i sigurisë nëpërmjet vlerësimit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të këtij Institucioni, u krye nga auditët e Drejtorisë së Auditimit në MB: znj.Arbëresha Zyka (Përgjegjëse grupi) z.Mezan Hoxha dhe znj.Alena Skënderi. Auditimi u krye nga data 18.06.2024 deri në datën 09.08.2024 për periudhën nën auditim 01.05.2022 deri më 30.06.2024. Për të

zhvilluar këtë angazhim auditimi u përdor kryesisht metoda e auditimit të intervistimit, duke përdorur teknikat e pyetësorëve për kontrollet e brendshme si dhe analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion.

Referuar vlerësimit të përgjithshëm të riskut gjatë hartimit të planit vjetor të punës i cili ka rezultuar “I lartë” për shkak të moskryerjes së këtij lloji auditimi në periudhat e mëparshme, është bërë vlerësimi i riskut të përgjithshëm të kontrollit referuar dhe vlerësimit të riskut për komponentët e kontrollit duke përdorur formularët standard në zbatim të Manualit të Auditimit të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të Auditimit të Brendshëm”. Gjatë zhvillimit të angazhimit të auditimit, u përdor metodologjia e induksionit dhe deduksionit (nga e veçanta te e përgjithshmja dhe anasjelltas) dhe u arrit në një opinion mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe u evidentuan kontrollet e munguara.

IV. GJETJE DHE KONKLUZIONE

IV/1. Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në përfundimet e auditimit të mëparshëm.

-Marrja në konsideratë e rekomandimeve të lëna nga auditët e mëparshëm. Hartimi i planit të veprimit me persona përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Auditimi mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, përgjegjësitë dhe arsyet e moszbatimit të tyre.

AMP është audituar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MB dhe ka përfshirë periudhën deri më 30.04.2022. Në përfundim të auditimit, në raportin final të auditimit të dërguar me shkresën nr.7014/5, datë 04.11.2022 janë lënë dhe janë pranuar nga institucioni për zbatim 9 rekomandime. Për zbatimin e rekomandimeve nga ana e strukturës menaxhuese të institucionit është hartuar plani veprimit nr.3802/1, datë 23.10.2023, i cili është dërguar në DA në MB. Në planin e veprimit të hartuar me afate dhe persona përgjegjës janë përfshirë të 9 rekomandimet e lëna për tu zbatuar por nuk është përcaktuar personi përgjegjës për monitorimin, e raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve sipas planit të veprimit.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve është bërë auditimi temati nga drejtoria e auditimit në muajin Prill 2023, për të cilën është hartuar raporti final mbi zbatimin e rekomandimeve sipas statusit të zbatueshmërisë në atë periudhë. Nga ana e AMP-së është caktuar personi përgjegjës z.G.Sala Drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetëse, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe komunikimin me DA në MB mbi progresin e zbatimit të tyre. Nga auditimi rezulton se është raportuar progresi i zbatimit të rekomandimeve shkresërisht dhe me email.

Grupi i auditimit auditori zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe rezultoi si më poshtë:

I-Rekomandimi. “Menaxhimi lartë i organizatës të marrë masat e duhura dhe në afat për analizimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”. Në plan veprim për zbatim të rekomandimit është caktuar sektori buxhet financës me afat deri në 05.01.2023. Ky rekomandim ka të bëjë me rekomandimin e mëparshëm “Menaxhimi i lartë i institucionit, të marrë në analizë gjetjen dhe të kërkojë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor i Shkallës së Parë Tiranë, avancimin e hetimeve për humbjen e pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiëifi” me vlerë fillestare 700,000 lekë. Sektori i financës të mos e regjistrojë si detyrim debitor vlerën e mbetur prej 221,484 lekë, pasi nuk ka dokumente që kjo paisje është futur në përdorim në vitin 2014. Sektori i financës të regjistrojë në kontabilitet, në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, më vlerë fillestare pajisjen “Sistem regjistrimi UniFiëifi”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka të rregjistruar procedimin penal nr.7493 e vitit 2019, dhe njëkohësisht ndaj ish punonjësit është bërë padi në

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka caktuar seancën gjyqësore në datë 28 Shkurt 2023. Është bërë seanca gjyqësore e cila është shtyrë për 07.07.2023.

-Rekomandim në proces realizimi. Vazhdon procesi gjyqësor me personin përgjegjës Znj. Ariada Girengir, seanca gjyqësore zhvillohet në 4 Shtator 2024.

2-Rekomandimi. *“Menaxhimi i lartë i AMP, referuar edhe gjetjeve që janë evidentuar në këtë raport, mbështetur në legjislacionin për menaxhimin financiar (nenet 9, 10, 11 dhe 18, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar), të marrë masat e duhura për krijimin dhe zbatimin e një sistemi kontrolli të brendshëm, sa më efektiv sidomos në drejtim të prokurimit të fondeve, trajtimit financiar të personelit, menaxhimit të aktiveve, inventarizimit të pasurisë, ndjekjes së debitorëve etj”.*

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar. Institucioni ka marrë masa të vazhdueshme për krijimin dhe zbatimin e një efektiv të kontrollit të brendshëm, por referuar gjetjeve të rezultuara gjatë këtij auditimi ka vend për përmirësime në fusha dhe drejtimet e audituara. Më konkretisht në materialin në vijim.

3-Rekomandimi. *Sa i përket vlerësimit gjatë auditimit të zhvillimit të kësaj procedure, në mungesë të dokumentacionit standart, sic dhe rezultoi edhe në takimin ballafaques të datës 05.10.2022 rekomandojmë që, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të AMP, të marrë në shqyrtim faktin e mungesës së dokumentacionit standart të rëndësishëm për realizimin e procedurës së prokurimit, por edhe të domozdoshëm për të dhënë një vlerësim të plotë lidhur me këtë procedurë nga ana e audituesëve. - Të fillojë hetimin administrativ duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse ndaj strukturës përgjegjëse të ngarkuar. Në përfundim të kësaj procedure AMP, të njoftojë zyrtarisht DAB në MB mbi rezultatet, për të vijuar nga ana e jonë më procedurat e mëtejshme të auditimit. Rekomandim i zbatuar. Për mangësitë e evidentuara në këtë procedurë, DA i ka kaluar për shqyrtim Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila shkresërisht ka kërkuar nga AMP dokumentacionin e administruar në dosje dhe me shkresën nr.8318/3, datë 29.12.2022 ka konfirmuar se, për këtë procedurë APP nuk ka kompetencë shqyrtimi pasi procedura është kryer sipas nenit 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006.*

4-Rekomandimi. *Për zbatimin korrekt të kontratës si dhe rakordimin në vijim të fondit të kontraktuar me shërbimin e realizuar nga OE për vitin 2022 dhe 2023 në objektin “Mirmbajtje rrjeteve dhe sistemeve IT për tre vitet 2021-2023”, rekomandojmë që, struktura menaxhuese e AMP të negociojë me OE për miratimin e aneksit të kontratës në të cilën të përcaktohen çmimet për njësi të zërave të shërbimit të dakortësuar në kontratë, mbi bazën e të cilave të vijohet me realizimin e shërbimit të kontraktuar me OE”.*

Ky rekomandim është zbatuar. Nga ana e titullarit të institucionit (Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit në AMP) është bërë nënshkrimi i aneksit të kontratës nr. 4428/3, datë 06.12.2022 me OE CCS për objektin “Mirmbajtje rrjeteve dhe sistemeve IT për tre vitet 2021-2023” e cila është e shoqëruar me çmimet respektive të zërave të punimeve sipas edhe kërkesës në rekomandim.

5-Rekomandimi. *Menaxhimi i lartë i institucionit, të marrë masat e nevojshme, për implementimin e organikës së re të miratuar, duke rregulluar emërimet e punonjësve në përputhje me gradat që kanë dhe gradën për funksion të miratuar. Për vlerën 793,288 lekë pagë bruto të përfituar padrejhtësisht nga 3 punonjës, të marrë masat për regjistrimin e sajë sipas punonjësve në llogarin debitore dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës.*

Ky rekomandim është në proces zbatimi.

Sa i përket detyrimit debitor për vlerën 793,288 lekë pagë bruto të përfituar padrejtësisht nga 3 punonjës, titullari me urdhërat nr.550,551 dhe nr.552 datë 07.12.2022 ka miratuar deklarimin debitor të tre punonjësve. Sektori financës i ka marrë në llogari vlerat debitorë dhe është bërë njoftimi për punonjësit për shlyerje vullnetare të vlerës së debive shkresat (nr.2719/1, nr.2721/1, nr.2720/1, datë 07.12.2022).

Gjithashtu pas njoftimit, për 1 punonjës (A. Caka) është lidhur aktmarveshje dhe është mbyllur arkëtimi vlerës debitorë në shumën 26,488 lekë.

Për punonjësen (S. Bulku, është lidhur aktmarveshje e cila po shlyen debinë, sipas Akt marrëveshjes.

Për punonjësin (A. Ismaili) i larguar nga AMP, është bërë kërkesë padi në Gjykatë për shlyerje detyrimi sipas shkresave (nr.820 dhe 821 datë 20.03.2023).

6-Rekomandimi. “Drejtoria e shërbimeve mbështetëse të institucionit që ka në varësi sektorin e personelit, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e një database në të cilin të regjistrojë të gjitha lëvizjet e personelit dhe të kërkojë e administrojë në dosjet e punonjësve librezat e punës të plotësuar nga punonjësit për të gjithë karrierat në punë”.

Ky rekomandim është zbatuar.

7-Rekomandimi. “Nga ana e menaxhimit të AMP të merret në analizë procedurat e ndjekura për debitorët, të vlerësohet përgjegjësia procedurale e ndjekur dhe të merren masat për dokumentimin dhe ndjekjen në rrugë gjyqësore të procesve deri në arkëtimin e plotë të vlerave debitorëve”.

Në plan veprim për zbatim të rekomandimit është caktuar Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbështetëse me afat zbatimi deri më 28.02.2023.

Ky rekomandim është në proces zbatimi.

Nga vlera totale 582,969 lekë debitorë deri në këtë auditim është bërë arkëtimi vetëm i vlerës 112,831 lekë nga 2 ish debitorët (Fadil Zenelaj me detyrim për 41,281 lekë dhe Klevis Qose, me detyrim për 71,550 lekë). Mbeten ende pa u arkëtuar 470,138 lekë debitorë në ngarkim të 7 ish punonjësve.

8-Rekomandimi. Menaxhimi i lartë i Institucionit, të analizojë konstatimet e auditit dhe të marrë masat për krijimin e komisionit për rivlerësimin e 11 automjeteve me vlerën e tregut, për tu dhënë mjeteve vlerën e dobishme për kontributin që japin si aktive me afat të gjatë përdorimi dhe në gjendje të mirë.

Ky rekomandim është realizuar. Me urdhër të titullarit nr.500, datë 15.11.2022 është krijuar komisioni për konstatimin e defekteve në automjetet e institucionit të cilat janë në llogari pa vlerë si rezultat i llogaritjes së amortizimit. Komisioni ka realizuar procesin e rivlerësimit dhe të 10 automjetet i ka rivlerësuar me vlerë (procesverbali nr.2606/1, datë 23.11.2022 dhe relacioni për titullarin 2606, datë 23.11.2022).

9-Rekomandimi. “Menaxhimi i lartë i Institucionit, bazuar në konstatimet e auditit në lidhje me procesin e inventarizimit dhe menaxhimin e aktiveve, të marrë masat e nevojshme procedurale dhe financiare për rakordimin e llogarisë inventariale midis librave të llogarisë dhe mallrave e materialeve gjendje në magazinë e në përdorim si dhe për armët gjendje t’i vlerësojë e regjistrojë në llogari me vlerën e tyre. Të marrë masat për të siguruar një ambient pranë amjenteve të

institucionit për magazinimin e mallrave, të kërkojë nga DPP furnizimin me armatim të institucionit dhe kompletimin me armatim e të gjithë personelit.

Ky rekomandim është realizuar pjesërisht.

Sa i përket procesit të rakordimit të llogarisë inventariale midis librave të llogarisë dhe mallrave e materialeve gjendje në magazinë e në përdorim si dhe për armët gjendje t'i vlerësojë e regjistrojë në llogari me vlerën e tyre rezulton se, kjo kërkesë e rekomandimit është zbatuar. (Institucioni me shkresën nr.461, datë 14.02.2023 ka kërkuar nga DPP “*vënien në dispozicion të çmimit të armëve e municionit*”. Nga DPP me përgjigjen nr.1934, datë 27.02.2023 ka konfirmuar pjesërisht çmimet e armëve (*vetëm për armën GLLOK*) ndërsa për paisjet dhe armët e tjera në përdorim nga institucioni AMP nuk ka çmime referuese.

Sa i përket kërkesës “*Për të siguruar një ambjent pranë amjenteve të institucionit për magazinimin e mallrave*”, është realizuar pasi institucioni ka realizuar investimin për shtesën e katit në godinën e saj.

-Në auditimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme rezultoi se : Nga 9 rekomandime të lëna, institucioni ka realizuar gjithsej 4 rekomandime ndërsa 5 rekomandime janë në process realizimi. Zbatimi i plotë i rekomandimeve të AB është përgjegjësi e menaxhimit të lartë të institucionit.

Titulli i gjetjes: *Moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm*

Nr. Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Institucioni AMP.
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat menaxhuese për funksionimin e Institucionit AMP, MB.
Përmbledhja e bazës ligjore	-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. Udhëzimi MF nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin publik”. Urdhëri MB nr.268, datë 01.07.2021 “ <i>Për zbatimin e rekomandimeve</i> ”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga 9 rekomandimet të lëna në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme rezulton se, janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime dhe 5 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara e në proces zbatimi. Kriteri: Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, (<i>nenin 12 pika d</i>). Manuali AB miratuar me Urdhërin e MF nr.100, datë 25.10.2016 Udhëzimi MF nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin publik”. Urdhëri MB nr.268, datë 01.07.2021 “ <i>Për zbatimin e rekomandimeve</i> ”. Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve dhe sipas afateve të miratuara në planin e veprimit, ndikon në mos funksionimin sa e si duhet të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

	Shkak: Mos marrja e masave të plota dhe në kohë nga ana e menaxhimit të Institucionit, për ndjekjen dhe zbatimin e plotë të rekomandimeve.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Nga ana e personave të ngarkuara për ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve, nuk janë marrë masat e duhura dhe nuk është punuar sa e si duhet për zbatimin e plotë të rekomandimeve dhe përmirësimin e sistemeve të funksionimit të kësaj njësie.
Rekomandimi	Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masat e menjëhershme për zbatimin e plotë të rekomandimeve të trajtuara në pikën e parë në këtë material. Të hartojë planin e veprimit duke përfshirë të gjitha rekomandimet, të përcaktojë afatet, persona përgjegjës dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e tyre. Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas planit të veprimit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijimësi
Statusi i rekomandimit	

Opinion, bazuar në analizimin e zbatimit të rekomandimeve institucioni ndonëse është përpjekur për vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve, zbatimi i tyre është nuk është në nivelin e duhur, me ndikim në mospërmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të organizatës, referuar edhe vlerësimin të dokumentacionit e procedurave të ndjekura gjatë periudhës së audituar.

IV/2. Auditimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të kontrollit, (Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktiviteti i Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” dhe “Monitorimi dhe Raportimi) në AMP dhe në Drejtoritë Rajonale të varësisë.

Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë publike të Republikës së Shqipërisë, ndër të cilat edhe AMP.

Në zbatim të nenit 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, nenit 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, Nëpunësi autorizues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njësisë publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës. Sipas këtij ligji, dy elementët kyç në implementimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike janë përcaktimi i funksionit të Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe hartimi i planit të zhvillimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, element të cilët nuk janë dokumentuar në këtë institucion.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Nga AMP akoma nuk është ngritur një sistem funksional dhe efektiv për menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të

brendshëm siç përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin të sipërcituar, detajuar në vijim: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.

-Auditimi i komponentit “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”:

Mjedisi i kontrollit si komponenti i parë i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit zë peshën më të madhe në këtë fushë krahasuar me komponentët e tjerë, për shkak të elementëve që përfshin: objektivat, struktura organizative, ndarja e detyrave, planet strategjike apo vjetore të punës, delegimi i detyrave, politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, etika personale dhe profesionale, etj.

-Hartimi i politikave, miratimi dhe monitorimi i objektivave të AMP-së, i planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Programimi dhe planifikimi strategjik i punës në AMP, mbështetet në prioritetet dhe objektivat kombëtare, në kuadrin e integritetit të vendit në BE, në programin e Qeverisë, në prioritetet dhe objektivat e MB, aktet ligjore dhe nënligjore dhe në planifikimin strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është një institucion i mbikëqyrjes së jashtme policore, me kompetenca si parandaluese ashtu edhe represive ndaj çdo sjellje jo etike, abuzimit me detyrën, shkeljes së ligjit dhe paligjshmërisë në përmbushje të detyrës funksionale dhe të performancës së strukturave, objekt i veprimtarisë së saj.

Në funksion të reformimit të vazhdueshëm institucional dhe përshtatshmërisë ligjore, organizative e funksionale me detyrimet ligjore të përcaktuara nga reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngritjes së institucioneve të reja nga njëra anë dhe procesit të vetingut në Polici e jo vetëm nga ana tjetër, Agjencia ka ndërmarrë një sërë reformash afatgjata dhe afatmesme në interes të përmbushjes së standardeve të kërkuara.

Në këtë kontekst, e në analizë të realizimit dhe përmbushjes së prioriteteve dhe objektivave të parashikuara në Dokumentin Strategjik Afatmesëm “Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë 2020-2024 dhe Plani i Veprimit 2020-2022 dhe 2023”, ku janë të parashikuara 4 prioritete , konkretisht; 1- Vijimi i konsolidimit organizativ dhe funksional i AMP-së, 2- Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, 3- Rritja dhe forcimi i rolit mbikëqyrës të Agjencisë kundër paligjshmërisë ndër radhët e strukturave, me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën, 4- Rikonceptimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për caktimin e objektivave secila strukturë sipas organizimit, identifikon problemet që ka pasur në të shkuarën dhe punon për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Vendosja e objektivave SMART, duhet të kontrollohet dhe ti shërbejë përmbushjes së strategjisë vjetore në rang institucioni.

Në zbatim të strategjisë vjetore të miratuar dhe objektivave të përcaktuar në këto strategji, është kërkuar hartimi dhe miratimi i programeve vjetore të punës.

Nisur nga objektivi primar i përcaktuar që është vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe funksionimi i tyre, auditimi është përqendruar kryesisht në metodat, procedurat dhe proceset e punës sipas ndarjes strukturore, për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe raportimin e informacioneve financiare ose jo financiare sipas komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Nga ana e drejtorive, pjesë përbërëse e AMP-së në fillim të çdo viti janë hartuar dhe miratuar planet vjetore të punës dhe mujore, referuar objektivave të AMP-së dhe raportohet periodikisht nëpërmjet shkresave zyrtare dhe në format elektronik mbi realizimin e planit mujor. Në fund të

vitit strukturat përbërëse të AMP-së hartojnë analizën vjetore e cila nga ana e sektorit të analizës dhe informacionit përmbledhet dhe unifikohet raporti vjetor i AMP-së.

- Mungon kontrolli dhe dokumentimi lidhur me saktësinë e hartimit sipas nivelit strukturor të objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur). Në analizën vjetore e veprimtarisë së AMP-së për vitin 2022-2023 konstatohet se, nuk evidentohen produktet dhe aktivitetet e përcaktuara me impakt në produktin përkatës dhe mosrealizimin e objektivave referuar prioritetëve, përgjegjësia e mos përmbushjes.

-Auditimi i detyrave dhe përgjegjësi të strukturave në AMP (Drejtoria qendrore dhe Drejtorive Rajonale) nëse janë të përcaktuara qartë dhe nëse ka mbivendosje, hartimi i përshkrimeve të punës për gjitha strukturat dhe miratimi i tyre nga Drejtori i Përgjithshëm, dokumentimi mbi njohjen e punonjësve me përshkrimet dhe me detyrat që do të kryejnë, kërkesat e kualifikimeve të nevojshme dhe linjat e raportimit.

AMP funksionon në zbatim të ligjit 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”. Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, statusin e AMP-së në MB, si dhe rregullon marrëdhënien juridike e administrative, karrierën, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve të kësaj Agjencie. VKM nr.532, datë 29.07.2022 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e AMP-së”.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e punës në bazë ligjit 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, ligjit për “Statusin e Nëpunësit Civil” dhe në Kodin e Punës. Rregullorja e institucionit e miratuar me VKM nr.532, datë 29.07.2022 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e AMP-së”, rregullon veprimtarinë e kësaj organizate, referuar akteve ligjore, nënligjore e normative. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për organizimin e brendshëm, si dhe funksionimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të AMP-së.

-Rregullorja ka procedura të shkruara, por rezulton se në këtë rregullore mungon përshkrimi dhe detyrat sipas organizimit strukturor të AMP-së, mungon mënyra e organizimit të drejtorive në qendër dhe sektorëve në varësi të tyre si dhe mungon organizimi i drejtorive rajonale dhe sektorëve përkatës.

Për periudhën e audituar (nga 01.05.2022 deri më 30.06.2024), institucioni i AMP-së, ka patur ndryshim sa i përket organikës dhe strukturës organizative e cila nga muaji Korrik 2022 e në vijim organika e institucionit nga 157 funksione të miratuara është ndryshuar me urdhër nr.117, datë 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AMP” me 170 funksione, efektet e të cilës hyn në fuqi në Janar 2023, e konkretisht; (108 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, 62 punonjës në Drejtorinë Rajonale).

Me urdhërin nr.31, datë 30.01.2020, “Për miratimin e strukturës dhe përbërjes organike të SHÇBA” i ndryshuar, deri në Dhjetor 2022 struktura organizative ka qenë e miratuar me 15 Sektorë dhe 12 Drejtori, ndërsa në vijim me hyrjen në fuqi të strukturës së re kemi 6 Drejtori dhe 17 Sektorë në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së dhe 7 Drejtori Rajonale me 13 sektorë gjithsej.

-Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, referuar germës i të nenit 16, të ligjit 128/2021 për AMP, ishin miratuar përshkrimet e punës nëpërmjet procedurave standarde për drejtorinë përbërëse dhe sektorët e varësisë të Drejtorisë e Përgjithshme të AMP-së, por rezultoi se për Drejtorinë Rajonale nuk ishin hartuar dhe miratuar procedura standarde, përshkrimet e punës dhe rregullat për organizimin, funksionimin dhe raportimin e këtyre strukturave.

-Referuar organizimit dhe hierarkisë së strukturës së miratuar të AMP-së rezultoi se; nuk ka një raport studimi objektiv/të përshtatshëm mbi organizimin referuar veprimtarisë së mbikëqyrjes,

detyrave funksionale, numrit të punonjësve, shtrirjes së territorit ku kryhet veprimtaria së Drejtorive në Qendër (Hetimi dhe Inspektimi/Ankesa) në raport me Drejtorinë Rajonale. *Konkretisht*; Drejtoria Qendrore e AMP-së është e përbërë nga 6 drejtori ku ndër të tjera është Drejtoria e Hetimit (e përbërë nga 3 sektorë gjithsej me 12 punonjës) dhe Drejtoria e Inspektimit dhe ankesave (e përbërë nga 3 sektorë gjithsej me 16 punonjës), referuar ushtrimit të aktivitetit të Drejtorisë së Hetimit mbulon/mbikëqyr struktura e veçanta të DPPSH-së dhe vetë DPPSH, ndërsa Drejtoria e inspektimit, inspekton me program pune Institucionet e DPPSH, trajton edhe ankesa. Ndërsa Drejtorinë Rajonale kanë në përbërje 2 sektorë të emërtuar Sektori i hetimit dhe ankesave (1) dhe (2) të përbërë nga disa specialistë 2-3 dhe referuar ushtrimit të aktivitetit të secilës Drejtori Rajonale ajo mbulon/mbikëqyr strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë/ Kufi Migracionin, Komisaritetet përkatëse në 2 Qarqe të territorit të RSH (shtrirjen e gjërë territoriale), nga ana e cdo specialisti me atributet e OPGJ, kryhet hetimi edhe trajtimi i ankesave të administruara në këto drejtori por edhe të deleguara nga Drejtoria Qendrore.

-Referuar nenit 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, të Ligjit 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, rezultoi se për periudhën e auditimit janë bërë urdhra delegimi, nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

-Me urdhër të titullarit të institucionit në cilësinë e nëpunësit autorizues nr.350 datë 29.09.2022 është bërë delegimi i disa detyrave për ZV/ Drejtorin dhe Drejtorëve të Drejtorive në qendër. Ky urdhër delegimi në mbështetjen ligjore të përcaktuar rezulton se nuk i referohet Ligjit 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për rrjedhojë as nenit 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave” si dhe në disa nga detyrat e deleguara Drejtori të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse lidhur me nënshkrimin e dokumentacionit për raportimin periodik të treguesve buxhetor, prokurimeve, investimeve, shpenzimeve, etj, rezulton se ky delegim është në mospërputhje me germën (f) të pikës 4 të nenit 9 të Ligjit 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *konkretisht* “ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara”, pasi këto raportime janë detyrë funksionale e hartohen nga nëpunësi zbatues e si i tillë nuk mund edhe të raportohen, nënshkruhen në cilësinë e nëpunësit autorizues.

-Me shkresë nr. 2396 datë 26.10.2022 nga Drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetëse në cilësinë e nëpunësi zbatues është bërë delegimi i disa detyrave shëfës së sektorit të financës, referuar këtij delegimi pika e parë “Përgatitja e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike” është një detyrë e cila nuk duhet të delegohet pra ky përcaktim i përket pikës 2 (a) të nenit 12 të Ligjit 10296 /2010, veprim në mospërputhje me pikë 4 të nenit 12 të Ligjit 10296 /2010 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, konkretisht; “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike nuk kanë të drejtë delegimi të përgjegjësive të përmendura në pikën 2 dhe në pikën 3 shkronjat "a", "ç", "e", "g" dhe "gj" të këtij neni”.

Nga ana e institucionit të AMP-së, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së nr.325, datë 19.09.2022 dhe urdhër nr.48, datë 17.01.2024 “Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik, në AMP”, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GSM), bazuar në nenin 16, të ligjit nr.128/2021 për AMP, nenit 8 dhe 27 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Në përbërje struktura menaxhuese e institucionit (Z/Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive në Qendër dhe Shefi i Sektorit Buxhet-Financë). Ky grup ishte mbledhur periodikisht 1 herë në 4 muaj.

Referuar kuadrit ligjor për të cilën funksionon dhe vepron AMP, në zbatim të ligjit të janë hartuar dhe miratuar VKM-të përkatëse, rezultoi se me VKM 321, datë 31.05.2023 për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të AMP, trajtohen elementët e pagave për punonjësit me status të veçantë, nëpunësit civil ndërsa për punonjësit administrativ trajtimi me pagë i referohet vendimit përkatës të këshillit të ministrave për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme të administratës publike.

Për nëpunësit civil të AMP, përcaktimet e klasave dhe shtesat për kushte e natyrë e vecantë pune janë bërë në lidhjen 2, të VKM-së 321, datë 31.05.2023 *“..për pagat e punonjësve të AMP-së”*, referuar ligjit për nëpunësin civil por edhe ligjit nr. 35/2023 *“Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike”*, AMP është pjesë e administratës publike e si e tillë nëpunësit civil të këtij institucioni duhet të përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*.

-Auditimi i komponentit Menaxhimi i riskut. Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas përcaktimit të objektivave dhe planifikimit të fondeve buxhetore institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e objektivave dhe të treguesve buxhetore.

Për periudhën e audituar nga ana e AMP-së Drejtoria e Përgjithshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, neni 11, *“Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”*, pika 2, ka hartuar regjistrin e riskut përmbledhës i cili është miratuar nga titullari AMP, regjistër në të cilën janë evidentuar kryesisht risqet e drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse, mungon identifikimi dhe vlerësimi i risqeve nga ana e drejtorive përbërëse të Drejtorisë Qëndrore, si dhe identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të Drejtorive Rajonale të AMP-së.

Referuar regjistrin të riskut të hartuar dhe të miratuar edhe pse nuk është i plotë, identifikimi i risqeve nga të gjitha strukturat pjesë përbërëse e AMP-së, konstatohet se edhe ky regjistër nuk i përmbahet formatit të aneksit nr.5 të MFK-së; konkretisht nuk janë përcaktuar të gjitha objektivat referuar prioriteteve të AMP-së, si dhe për objektivat e parashikuar në regjistrin e riskut nuk janë identifikuar për cdo objektiv risqet e mundshme, për rrjedhojë edhe aktivitetet e menaxhimit të risqeve nuk janë të plota.

Për realizimin e prioriteteve përcaktohen një sërë objektivash për cdo prioritet, e për rrjedhojë për cdo objektiv të planifikuar duhet të vlerësohen risqet përkatëse të brendshme ose të jashtme, masat që duhen marrë për minimizimin e risqeve për realizimin e plotë të objektivit, nga të gjithë strukturat përbërëse të Institucionit.

Procesi i menaxhimit të riskut, zhvillimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, (MFK), kërkon zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Risqet janë të pashmangshme në operacionet e përditshme. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një

efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arësyeshme se objektivat do të arrihen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion (njerëzore e financiare), që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Për një identifikim sa më real të risqeve, mirëpërcaktimi i objektivave që ka çdo strukturë vepruese dhe operuese e kësaj njësie publike, hartës së proceseve të punës dhe gjurmës së auditimit referuar Manualit të MFK, do të ndihmonin këtë institucion në funksionimin më të mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm, referuar kjo edhe gjetjeve të evidentuara gjatë këtij auditimi në disa fusha të veprimtarisë (*të analizuarra e detajuara në vijim*).

-Auditimi i komponentit Aktiviteti i Kontrollit: Veprimtaritë e kontrollit kanë të bëjnë me procedurat dhe politikat e shkruara e të miratuara për të dhënë siguri të arësyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Lidhur me miratimin e aktiviteteve të kontrollit, duke përfshirë dhe procedura e politika të shkruara, të cilat garantojnë në një masë të arësyeshme, se risqet që janë identifikuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut, janë pakësuar në një nivel të pranueshëm, rezultoi se; mungonte harta e proceseve të punës dhe manuali i proceseve të punës sipas drejtorive dhe niveleve të varësisë, mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të riskut, mungesa e gjurmës së auditimit (pasqyrimi i ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces) si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme, me impakt në mosfunksionimin e plotë të kontrollit të brendshëm të AMP-së.

Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces. Megjithatë, gjetjet e konstatuara nga kryerja e auditimit në sistemet e programuara për auditim, tregojnë se aktiviteti i kontrollit të brendshëm, nuk kryhet në vazhdimësi dhe nuk është i plotë në të gjitha hallkat menaxhuese të këtij institucioni. Gjetjet e konstatuara gjatë auditimit në sistemet e programuara, tregojnë se aktiviteti i kontrollit të brendshëm nuk funksionon i plotë e në vazhdimësi dhe i plotë në të gjitha hallkat menaxhuese.

Nga auditimi i procedurave të lëvizjeve të personelit (*përlirime, emërim, lëvizje paralele dhe ristrukturime*), rezultoi se janë konstatuar gjatë periudhës së auditimit emërimet në punë pa kryer më parë procedurat e rekrutimit conform përcaktimeve ligjore në ligjin dhe rregulloren e AMP-së, përgjegjësi e menaxhimit të lartë të institucionit, sipas periudhave.

Nga auditimi mbi hartimin e rregullave të brendshme që rregullojnë sigurinë e aseteve, u konstatua se sipas pikës 30 të udhëzimit nr.30 të MF (datë 27.12.2011), rregjistri i aktiveve administrohet nga shefi i sektorit të financës, rezultuan gjetje lidhur me proceset e inventarizimit, administrimit të aktiveve, pozicionimin e llogarive në pasqyrat financiare të mbylljes vjetore, trajtuar në tematikën përkatëse.

Referuar gjetjeve të konstatuara sipas sisteme/drejtimeve të auditimit rezultoi që duhet të bëhen përmirësime lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm, aktivitetin e kontrollit nga strukturat përkatëse të institucionit.

-Auditimi i komponentit Informimi dhe Komunikimi. Menaxherët e zotërojnë informacion lidhur me përmbushjen e detyrave dhe marrjen e përgjegjësisive për menaxhimin e lartë të njësisë publike.

Struktura e kësaj njësie (*sipas organizimit në qendër dhe në 7 drejtoritë rajonale*) është e informuar në kohë me të gjitha udhëzimet dhe aktet administrative (urdhërat) e nxjerra sipas përkatësisë (të cilat janë të qartë e të saktë sa i përket përputhshmërisë me kërkesat ligjore). Informimi strukturës realizohet nëpërmjet protokollit të institucionit, në të cilin procedura shkresore e autorizuar është me gjurmën përkatëse të njohjes. Gjithashtu përveç procedurës shkresore të shpërndarjes së udhëzimeve dhe urdhrave administrative, informimi dhe komunikimi me strukturën realizohet edhe nëpërmjet takimeve, mbledhjeve, relacioneve, raporteve të ndryshme që i vihen në dispozicion si dhe në rrugë elektronike.

-Auditimi i komponentit Monitorimi dhe raportimi: Sipas nenit 24 “*Monitorimi*” i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të MFK realizohen kryesisht përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Monitorimi i kontrollit të brendshëm duhet të garantojë se të gjitha problemet e identifikuar, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen, por edhe se rezultatet dhe rekomandimet e AB apo vetëvlerësimit merren në konsideratë dhe analizohen nga ana e titullarit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të agjencisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilën është ky institucion. Monitorimi kryhet nëpërmjet raportimeve javore, mujore, 3-mujore dhe vjetore.

Monitorimi nëpërmjet vetëvlerësimit për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga ana e institucionit të AMP- së ishin përgatitur pyetësorët e vetëvlerësimit, plani i ngritjes dhe zhvillimit të sistemeve të MFK, në zbatim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010. Në zbatim të udhëzimit të MF nr.28, datë 15.12.2011 nuk është dërguar Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të MFK. AMP ka hartuar e raportuar pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK dhe planin e veprimit për MFK sipas anekseve 6 dhe 8 të manualit të MFK, miratuar me urdhrin e MF nr.108, datë 17.11.2016 dhe i ka dërguar praktikën pranë MB me shkresën nr.99/1, datë 09.02.2023 dhe me shkresën nr.182/1 datë 06.02.2024.

-Pjesë e këtij auditimi janë edhe Drejtoritë Rajonale të AMP-së, të cilat janë struktura teknike operacionale dhe administrative në nivel vendor. Grupi i auditimit realizoi auditim lidhur me komponentët e MFK si dhe dinamikën e punës së këtyre drejtorive për të cilën është dokumentuar me Aktverifikimi përkatës; në Drejtoritë Rajonale (Tiranë, Elbasan-Korcë, Fier-Berat, Vlorë-Gjirokastrë, Shkodër-Lezhë, Kukës-Dibër)

U evidentuan problematika sa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm të cilët nuk funksionojnë sic duhet. Mungesa të përshkrimeve të punës, regjistrave të riskut, mospërcaktimi në urdhrat e emërimit të territorit që mbulon specialisti hetim/ankesës. Konkretisht:

-Komponenti “*Mjedisi i kontrollit*” rezultoi se nuk kishte përshkrime pune për pozicionet përbërëse të Drejtorisë Rajonale, për rrjedhojë mungonin edhe procedurat standarte për organizimin dhe funksionimin e kësaj drejtorie. Referuar ndarjes strukturore për të cilën drejtoritë janë të përbëra nga dy sektorë me emërtesën *sektori hetimit/ankesave nr.1* dhe *sektori hetimit/ankesave nr.2* ku secili sektor ka nga 2-3 specialistë (sipas përcaktimeve konkrete në organikë), u konstatua se në dosjet personale të punonjësve referuar udhrave te emerimit bazuar në strukturën e miratuar me urdhër nr.117, datë 28.07.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore*” nuk përcaktohej, identifikohet, mbikëqyrja e zonave territoriale për veprimarinë që ata kryejnë, për rrjedhojë kjo situatë bën të paqartë veprimtarinë konkrete dhe ndarjen e përgjegjësisë për secilin punonjës.

-Komponenti “*Menaxhimi i riskut*”. Referuar objektivave u evidentua se nga ana e drejtorisë rajonale pavarësisht se ishin përcaktuar objektivat në planin vjetor të punës, objektiva të cilat janë në përmbushje me objektivat që ka edhe AMP Qëndrore, konstatojmë se nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është hartuar regjistri për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për realizimin e objektivave të vendosura.

-Komponenti “*Aktiviteti i kontrollit*”. Referuar mungesave të procedurave të shkruara për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë Rajonale (përshkrimet e punës, procedurave standarte, mungesa e ndarjes së zonave mbikqyrëse territoriale) me impakt në funksionimin e plotë të aktivitetit të kontrollit, efektivitetin dhe ndarjen e përgjegjësive për secilin punonjës.

Drejtoritë Rajonale e ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambientet e Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit dhe në komisariate, konstatohet se referuar aktivitetit operacional të këtyre strukturave por dhe zonës së mbulimit në komisarite ka mungesë të posteve të punës si rezultat i mungesës së rrjetit elektronik të dedikuar të AMP-së (Intranetit), ky sistem elektronik ekziston vetëm në Drejtoritë Vendore të Policisë. Mungesa e posteve të punës dhe sistemit elektronik të dedikuar referuar edhe shtrirjes së gjërë territoriale sjell vështirësi në veprimtarinë operacionale të drejtorive rajonale me impakt/ndikim në përmbushjen e plotë të funksionit për të cilën janë ngritur dhe funksionon AMP.

U auditua dinamika e administrimit dhe trajtimit të ankesave nga Drejtoritë Rajonale për periudhat audituese, referuar të dhënave të sistemit elektronik për ankesat. Drejtoritë Rajonale trajtonin ankesat e administruara nga vetë ato por edhe ankesat e deleguara nga Drejtoria e Inspektimit dhe ankesave në Drejtorinë Qëndrore të AMP-së, rezultoi se aktivitetin/kohën më të madhe të punës për specialistët e merrte trajtimi i ankesave që sipas statistikave rezultoi se numri më i madh i ankesave ishin të pabazuara dhe të pa provuara si dhe ankesa të ripërsëritura.

Titulli i gjetjes: Mos implementimi në veprimtarinë e AMP-së të disa kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nr.Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Agjencia e Mbikqyrjes Policore
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat menaxhuese për funksionimin e Institucionit AMP, MB.
Baza ligjore	Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit miratuar me urdhrin e MF nr.108 datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar; udhëzimet e MFK.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e AMP-së e miratuar me VKM nr.532/2022, ka procedura të shkruara, por rezulton se në këtë rregullore mungon përshkrimi dhe detyrat sipas organizimit strukturor të AMP-së, mungon mënyra e organizimit të drejtorive në qendër dhe sektorëve në varësi të tyre si dhe mungon organizimi i drejtorive rajonale dhe sektorëve përkatës. -Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, referuar germës (i) të nenit 16, të ligjit 128/2021 për AMP, janë miratuar përshkrimet e punës nëpërmjet procedurave standarde për drejtoritë përbërëse dhe sektorët

e varësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të AMP-së, por rezultoi se për Drejtoritë Rajonale nuk janë hartuar dhe miratuar procedura standarde, përshkrimet e punës dhe rregullat për organizimin, funksionimin dhe raportimin e këtyre strukturave.

-Referuar organizimit dhe hierarkisë së strukturës së miratuar të AMP-së rezultoi se; nuk ka një raport studimi objektiv/të përshtatshëm mbi organizimin referuar veprimtarisë së mbikëqyrjes, detyrave funksionale, numrit të punonjësve, shtrirjes së territorit ku kryhet veprimtaria e Drejtorive në Qendër (Hetimi dhe Inspektimi/Ankesa) në raport me Drejtoritë Rajonale. *Konkretisht*; Drejtoria Qendrore e AMP-së është e përbërë nga 6 drejtori ku ndër të tjera është Drejtoria e Hetimit (e përbërë nga 3 sektorë, gjithsej me 12 punonjës) dhe Drejtoria e Inspektimit dhe ankesave (e përbërë nga 3 sektorë, gjithsej me 16 punonjës), referuar ushtrimit të aktivitetit të Drejtorisë së Hetimit mbulon/mbikëqyr strukturat e veçanta të DPPSH-së dhe vetë DPPSH, ndërsa Drejtoria e Inspektimit, inspekton me program pune Institucionet e DPPSH, trajton edhe ankesa.

Ndërsa Drejtoritë Rajonale kanë në përbërje 2 sektorë të emërtuar, Sektori i hetimit dhe ankesave (1) dhe (2) të përbërë nga disa specialistë 2-3 dhe referuar ushtrimit të aktivitetit të secilës Drejtori Rajonale mbulon/mbikëqyr strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë, Kufi Migracionin, Komisaritetet përkatëse në 2 Qarqe të territorit të RSH (shtrirjen e gjërë territoriale), nga ana e cdo specialisti me atributet e OPGJ, kryhet hetimi edhe trajtimi i ankesave të administruara në këto drejtori por edhe të deleguara nga Drejtoria Qendrore.

-Me urdhër të titullarit nr.350 datë 29.09.2022 në cilësinë e nëpunësit autorizues, është bërë delegimi i disa detyrave për Zv/ Drejtorin dhe Drejtorëve të Drejtorive në qendër. Ky urdhër delegimi në mbështetjen ligjore të përcaktuar rezulton se nuk i referohet Ligjit 10296 /2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, për rrjedhojë as nenit 15 “*Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave*” si dhe në disa nga detyrat e deleguara Drejtori të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse lidhur me nënshkrimin e dokumentacionit për raportimin periodik të treguesve buxhetor, prokurimeve, investimeve, shpenzimeve, rezulton se ky delegim, është në mospërputhje me germën (f) të pikës 4 të nenit 9 të Ligjit 10296 /2010, pasi këto raportime janë detyrë funksionale e hartohen nga nëpunësi zbatues e si i tillë nuk mund edhe të raportohen, nënshkruhen në cilësinë e nëpunësit autorizues.

-Me shkresë nr.2396, datë 26.10.2022 nga Drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues është bërë delegimi i disa detyrave shifes së sektorit të financës, referuar këtij delegimi pika e parë “*Përgatitja e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike*” është një detyrë e cila nuk duhet të delegohet, veprim në mospërputhje me pikë 4 të nenit 12 të Ligjit 10296 /2010 “*Për menxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar.

-Për nëpunësit civil të AMP, përcaktimet e klasave dhe shtesat për kushte e natyrë e vecantë pune janë bërë në lidhjen 2, të VKM-së 321, datë 31.05.2023 *“..për pagat e punonjësve të AMP-së”*, referuar ligjit për nëpunësin civil por edhe ligjit nr. 35/2023 *“Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike”*, AMP është pjesë e administratës publike e si e tillë nëpunësit civil të këtij institucioni duhet të përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*.

-Për periudhën e audituar nga ana e AMP-së Drejtoria e Përgjithshme, janë hartuar dhe miratuar regjistrat e riskut përmbledhës, regjistër në të cilën janë evidentuar kryesisht risqet e Drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse, mungon identifikimi dhe vlerësimi i risqeve nga ana e drejtorive të tjera përbërëse të Drejtorisë Qëndrore, si dhe identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të Drejtorive Rajonale të AMP-së. Regjistrat e miratuar nuk i përmbahen plotësisht formatit të aneksit nr.5 të MFK-së; konkretisht nuk janë përcaktuar të gjitha objektivat referuar prioriteteve të AMP-së, si dhe për objektivat e parashikuar në regjistrin e riskut nuk janë identifikuar për cdo objektiv risqet e mundshme, për rrjedhojë edhe aktivitetet e menaxhimit të risqeve nuk janë të plota.

-Mungonte harta dhe manuali i proceseve të punës për cdo funksion të miratuar në organikën dhe strukturën e AMP-së.

-Mungon kontrolli dhe dokumentimi lidhur me saktësinë e hartimit sipas nivelit strukturor të objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur). Në analizën vjetore e veprimtarisë së AMP-së për vitin 2022-2023 konstatohet se, nuk evidentohen produktet dhe aktivitetet e perealizuara me impakt në produktin përkatës dhe mosrealizimin e objektivave referuar prioriteteve, përgjegjësia e mos përmbushjes.

-Nga auditimi i realizuar lidhur me komponentët e MFK si dhe dinamikën e punës në Drejtoritë Rajonale të AMP-së, të cilat janë struktura teknike operacionale dhe administrative në nivel vendor, u evidentuan mangësi sa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm të cilët nuk funksionojnë sic duhet. Mungesë të përshkrimeve të punës, regjistrave të riskut, mospërcaktimi i zonës mbikqyrëse në urdhrat e emërimit të specialistëve hetim/ankesës, mos ndarje pune specifike për secilin specialist me impakt në vlerësimin e produktit të punës.

-Mungesë të posteve të punës në komisariate si rezultat i mungesës së rrjetit elektronik të dedikuar të AMP-së (Intranetit), ky sistem elektronik ekziston vetëm në Drejtoritë Vendore të Policisë, me impakt/ndikim në veprimtarinë operacionale, përmbushjen e plotë të

	<p>misionit referuar edhe shtrirjes së gjërë territoriale të Drejtorive Rajonale.</p> <p>-Drejtoritë Rajonale trajtonin ankesat e administruara nga vetë ato por edhe ankesat e deleguara nga Drejtoria e inspektimit dhe ankesave në Drejtorinë Qëndrore të AMP-së, rezultoi se aktivitetin/kohën më të madhe të punës për specialistët e merrte trajtimi i ankesave (detyrim ligjor) që sipas statistikave rezultoi se numri më i madh i ankesave ishin të pabazuara dhe të pa provuara si dhe ankesa të ripërsëritura.</p> <p>Kriteri: Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit miratuar me urdhrin e MF nr.108 datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar; udhëzimet e MF nr.16, datë 29.7.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kordinatorit të riskut të njësisë publike.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mos përmbushja e detyrimeve menaxheriale për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv të kontrollit të brendshëm paraqet risk të shtuar për realizimin e objektivave.</p> <p>Shkaku: Menaxhimi i lartë sipas periudhave nuk ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet në zbatim të tij.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mosfunksionim i plotë i kontrollit të brendshëm nga menaxhimi strukturave përbërëse të AMP-së.
Rekomandimi	Menaxhimi i lartë i AMP-së, referuar gjetjeve të konstatuara të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në përputhje me përcaktimet ligjore të komponentëve të MFK-së; hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara; hartimin e objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur); përmirësimin e regjistrit të riskut i cili duhet të jetë i konsoliduar me të gjithë drejtoritë dhe sektorët; rishikimin e strukturës dhe organikës, përfshirjen, konform akteve ligjore e nënligjore për administratën publike, duke mundësuar optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion; me qëllim mundësimin e vendimmarrjeve cilësore, performancë në arritjen e objektivave të AMP-së.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijim
Statusi i rekomandimit	

Opinion: Nga auditimi i sistemit të MFK-së rezultoi, mospërmbushje e detyrimeve menaxheriale për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv të kontrollit të brendshëm.

IV/3. Auditimi i sistemit të buxhetit.

-Planifikimi i nevojave buxhetore, argumentimi i fondeve limit të kërkuara.

Planifikimi i nevojave për fonde buxhetore është bazuar në Ligjin nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetse nr.1380/9, datë 24.03.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Me urdhër të brendshëm nr.692, datë 30.03.2021, është ngritur grupi i punës, për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, (PBA), 2022-2024. Grupi i punës kryesohet nga Zv/ Drejtori i Përgjithshëm, dhe përbëhet nga 11 anëtarë. Grupi i punës në punën e tij ka vepruar në përputhje me politikën, strategjinë, misionin dhe objektivat e AMP-së nga ku ka parashikuar kërkesat për shpenzime operative dhe investime, sektori i financës ka bërë përlllogaritjet e fondit të pagave të personelit bazuar në numërin e punonjësve të strukturës së miratuar. Në përfundim të punës është hartuar relacioni shoqërues për përgatitjen e PBA-së 2022-2024 dhe brenda afatit ligjor është përcjellë në MB. Me shkresën nr.738, prot, datë 06.04.2022, “Dërgohet informacion në lidhje me procesin e PBA-së 2022-2024”, është dërguar Drejtuesit të Programit “Planifikim Menaxhimit”, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Brendshme.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të Drejtorive, sektorëve dhe zyrave, ndërsa për planifikimin e buxhetit vjetor, është marrë si bazë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor para rendës. Nga ana e nëpunësit zbatues të institucionit, shefit të Sektorit të Buxhet Financës, bashkënjitur relacionit janë plotësuar të gjitha pasqyrat shoqëruese “Tip” të projekt buxhetit për programin që menaxhohet nga njësi shpenzuese AMP dhe së bashku me relacionet sqaruese për zërat e shpenzimeve, janë konfirmuar nga drejtuesi i njësisë shpenzuese, (nëpunësi autorizues) dhe i janë dërguar drejtuesit të programit “Planifikim Menaxhimi” dhe “Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar” në MB, me shkresën nr.1521/1 prot, datë 13.08.2021.

Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, është ndjekur e njëjta procedurë pune tashmë e konsoliduar, duke dërguar brenda afateve ligjore informacionin e kërkuar Drejtuesit të Programit Buxhetor “Planifikim Menaxhimit”, me nr.714/1 prot, datë 19.04.2022 dhe me nr.1778 prot, datë 16.08.2022, “Dërgohet informacion në lidhje me procesin e PBA-së 2023-2025”, drejtuar SP të MB dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB.

Edhe për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 është ndjekur e njëjta praktik pune, me urdhër të brendshëm nr.883/1, prot, datë 28.03.2023 është urdhëruar ngritja e grupit të punës me pesmbëdhjet anëtarë, përfshirë këtu edhe shtatë drejtuesit e drejtorive rajonale. Brenda afatit ligjor është përcjellë në MB informacioni për hartimin e buxhetit afat mesëm 2024-2026, me shkresën nr.1120 prot, datë 14.04.2023, dhe nr.2457/1, prot, datë 21.08.2023, “Dërgohet informacion në lidhje me procesin e PBA-së 2024-2026”, drejtuar SP dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Brendshme.

-Respektimi i disiplinës buxhetore në kapituj, artikuj, n/artikuj, evidentimi i shmangieve dhe nxjerrja e përgjegjësive për periudhën në auditim. Ndryshimet e ndodhura në buxhet gjatë vitit dhe argumentimi realizimit të buxhetit, kontrollit, zbatimi dhe rakordimi me Degën e Thesarit, rregullshmëria e mbajtjes së llogarive buxhetore.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat gjatë zbatimit të buxhetit, janë të regjistruara e të rakorduara me degën e buxhetit e Thesarit Tiranë dhe janë të raportuara periodikisht në institucionin qendror, në MB.

Me shkresën nr.10084/4 prot, datë 27.01.2022, të SP të MB është dërguar “Detajimi i buxhetit të vitit 2022-2024 për shpenzimet korente”.Me nr.22922/220 prot, datë 11.02.2022, të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, “Dërgohet detajimi i buxhetit 2022-2024 për shpenzimet kapitale”,llog.231 për 13,115,000 lekë dhe nr.2810/13 prot, datë 21.04.2022 dhe nr.10084/7 prot, datë 22.02.2022 të Ministrisë së Brendshme është dërguar detajimi i buxhetit 2022-2024 për shpenzimet kapitale, në zbatim të aktit normativ nr.3 datë 12.03.2022, për disa ndryshime ne ligjin nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”.Me shkresën nr.601/6 prot, datë 14.02.2022 të SP të MB është dërguar detajimi i fondit të veçant për vitin 2022 për shumën lekë 400,000 lekë.

Për buxhetin e vitit 2022:

Gjatë zbatimit të buxhetit për periudhën përkatëse ka patur shtesa, pakësime si dhe transferime brënda artikullit, 602. Me nr.2810/10 prot, datë 15.04.2022 të SP të MB, në zbatim të Aktit Normativ nr.3 datë 12.03.2022, për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është pakësuar llog.600 për 5,000,000 lekë, llog,601 për 955,000 lekë dhe llog, 602 për 4,000,000 lekë. Me shkresën nr.8257/7 prot, datë, 24.08.2022 të SP të MB është pakësuar llog, 600 për 11,000,000 lekë. Me shkresën nr.11025/4 prot, datë 10.11.2022 të SP të MB është akorduar shtesa për llog, 606 për 1,394,000 lekë.Me shkresën nr.11025/7 prot, datë 22.11.2022 të SP të MB është njoftuar pakësimi i fondeve në llog, 600 për 10,606,000 lekë dhe në llog, 601 për 2,544,000 lekë, dhe për këtë shumë prej 13,150,000 lekë është shtuar llog, 602. Me shkresën nr.12702/7 prot, datë 23.12.2022 është njoftuar pakësimi i fondeve për llog, 600 për 3,200,000 lekë dhe për llog, 602 për 3,000,000 lekë.Me shkresën nr.13539/5 prot, datë 30.12.2022 është njoftuar pakësimi i fondit për llog, 231, (Rikonstruksion/Ndërtim i Godinës së SHÇBA, shtesë Kati) për shumën 1,159,000 lekë. Me shkresën nr.10599/3 prot, datë 07.11.2022 njoftim për transferim fondi për investime, është akorduar shtesë fondi për llog, 231 për shumën 645,000 lekë.Me shkresën nr.13504/3 prot, datë 17.01.2023 është akorduar shtesa për llog, 606 për shumën 1,400,000 lekë, bazuar në VKM nr.898, datë 29.12.2022 “Për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për zbutjen e impaktit të krizës”, referuar VKM janë trajtuar 124 punonjës, (16 punonjës me 20,000 lekë dhe 108 punonjës me 10,000 lekë).

Për vitin 2022 realizimi i zërave të buxhetit të AMP-së është si më poshtë:

Në lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet Për periudh.	Plani ndryshuar	Ralizimi Fakti	Diferenca	%
600	Paga shpz.tjera personeli	170,000,000	-29,806,000	140,194,000	140,168,881	-25,119	100
601	Kont. sig.shoq shënd	28,000,000	-3,499,000	24,501,000	23,357,952	-1,143,048	95
602	Mallra e sherbime	40,000,000	+6,150,000	46,150,000	43,470,380	-2,679,620	94
606	Trans. buxh. familjar	2,000,000	+3,194,000	5,194,000	5,173,638	-20,362	100
230	Shpz.për rritjen e AQP	=	+1,159,000	1,159,000	0	-1,159,000	0
231	Ndërtime konstruk AQT	13,115,000	-514,000	12,601,000	12,261,760	-339,240	97
	Shuma :	253,115,000	-23,316,000	229,799,000	224,432,611	-5,366,389	98

Referuar të dhënave të pasqyruara më sipër konstatohet se shpenzimet buxhetore për vitin 2022 nga 229,799,000 lekë, (Plani fillestar me gjithë ndryshimet e ndodhura gjatë zbatimit të buxhetit) është realizuar në shumën 224,432,611 lekë, me një mosrealizim prej -5,366,389 lekë ose 98%. Analitikisht realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për AMP-në për periudhën e vitit 2022 rezulton si më poshtë;

“Paga dhe shpenzime të tjera personeli”, Llog, 600, Në këtë artikull fondet janë realizuar në shumën prej 140,168,881 lekë ose 100% e planit të miratuar për vitin 2022, me gjithë ndryshimet

e ndodhura gjatë zbatimit të buxhetit për minus 29,806,000 lekë, plani i ndryshuar është në shumën 140,194,000 lekë.

“Sigurimet shoqërore & shëndetësore”, Llog, 601, Në këtë artikull fondet e planifikuara për periudhën janë në shumën prej 24,501,000 lekë, nga të cilat janë realizuar në shumën 23,357,952 lekë ose 95 % e planit, edhe për këtë artikull referuar planit fillestar është bërë pakësimi për 3,499,000 lekë mosrealizimi gjatë kësaj periudhe, në shumën prej 1,143,048 lekë ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të fondeve në artikullin 600.

“Mallra e shërbime të tjera”, Llog, 602, Nga fondet e planifikuara në këtë zë, në shumën prej 46,150,000 lekë, janë realizuar fondet në shumën prej 43,470,380 lekë ose 94% e planit, me një diferencë në vlerë prej 2,679,620 lekë.

Diferenca e mosrealizimit në këtë zë kryesisht ka ardhur si rezultat i tepricave të fondeve nga procedurat e prokurimit (diferenca në çmimet e konstatuara në fazën e vlerësimit të tregut me çmimin e ofruar nga operatorët ekonomik në fazën e vlerësimit të fituesit).

“Transferim për buxhetet familjare dhe individë”, Llog, 606, Fondet e planifikuara në këtë artikull janë në shumën prej 5,194,000 lekë, realizuar në shumën prej 5,173,638 lekë ose 100% e planit.

“Shpenzime për rritjen e aktiveve të patrupëzuara”, Llog, 230, Fondi i miratuar për këtë artikull është për shumën 1,159,000 lekë i parashikuar për mbulimin e shpenzimeve për hartimin e projekt-preventivit për zbatimin e punimeve për përforcimin e objektit ekzistues si dhe për shtesën e katit të godinës së AMP-së, instalimi i rrjeteve dhe sistemeve të TI, elektrike, hidraulike dhe atyre qendrore të ngrohje-ftohjes, konformë kontratës nr.1146/5, datë 04.11.2022 nënshkruar mes Institucionit AMP-së dhe Institutit të Ndërtimit.

Nga AMP është hartuar praktika dokumentare ligjore për likuidim, por duke qënë se fondi është çelur me kod projekti të pasaktë, Dega e Thesarit nuk ka miratuar realizimin e shpenzimit, e për rrjedhojë ky fond rezulton i pa realizuar.

“Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara”, Llog, 231, Fondet e miratuara në këtë artikull në shumën prej 12,601,000 lekë, janë realizuar në shumën prej 12,261,760 lekë, të detajuara si më poshtë:

“Blerje pajisje zyre dhe përgjimi për AMP” në shumën prej 6,751,000 lekë. Procedura e blerjes është realizuar konform VKM-së nr.741, datë 05.11.2014 *“Për përcaktimin e kushteve, kriterëve të përdorimit dhe kontrollit të fondit të posaçëm, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të ShÇBA-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme”* si dhe VKM-së nr.1170, datë 24.12.2020 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”* dhe VKM nr.542, datë 29.9.2021 *“Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”*.

Në vazhden e procedurës ligjore është lidhur dhe zbatuar kontrata me operatorin ekonomik fitues duke konkluduar me likuidimin e detyrimit total prej 6,418,000 lekë.

“Blerje orendi e pajisje zyre” (tavolina, karrige etj) në shumën 5,850,000 lekë, ky fond është realizuar në vlerën prej 5,843,760 lekë. *Realizimi i fondeve, për vitin 2022 është në masën 98%.*

Për buxhetin e vitit 2023:

E njejta praktik pune është ndjekur edhe për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, duke dërguar brënda afateve ligjore informacionin e kërkuar Drejtuesit të Programit Buxhetor “Planifikim Menaxhimit”, me nr.714/1 prot, datë 19.04.2022 dhe me nr.1778 prot, datë 16.08.2022, “Dërgohet informacion në lidhje me procesin e PBA-së 2023-2025”, drejtuar SP të MB dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB.

Për vitin 2023, AMP i është akorduar në fillim të vitit nga MB me shkresën e MB nr.12851/3 prot, datë 21.12.2022, “Për detajimin e buxhetit për vitet 2023-2025” fondet buxhetore në nivel artikulli të cilat janë detajuar nga struktura në nënzëra të buxhetit. Janë akorduar fonde për; llog, 600 në shumën, 225,903,000 lekë, llog, 601 për 37,177,000 llog, 602 për 40,000,000, llog, 230 për 2,601,000 lekë dhe llog, 231 për 72,949,000 lekë.

Gjatë zbatimit të buxhetit të periudhës ushtrimore 2023, buxhetet fillestare të akorduara kanë pësuar edhe ndryshime në shtesa dhe paksim fondesh sipas zërave, të cilat në të gjitha rastet janë të konfirmuara e të argumantuara, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

Me shkresën nr.12851/22 prot, datë 08.02.2023, është dërguar nga MB detajimi i buxhetit të vitit 2023-2025 për shpenzimet kapitale, konkretisht për llog, 230 për shumën 2,601,000 lekë dhe për llog, 231 për 72,949,000 lekë.Me shkresën nr.12851/20 prot, datë 30.01.2023 nga SP në MB është dërguar detajimi i buxhetit për vitet 2023-2025, për shpenzimet korente.Me nr.1006/5 prot, datë 23.02.2023 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023, për 500,000 lekë.

Me shkresën nr.1006/5 datë 23.02.2023 është akorduar shtesë fondi për llog, 606 për shumën 500,000 lekë.

Me kërkesën për rritjen e autorizimit buxhetor nr.1429 prot, datë 15.05.2023 të AMP, të bazuar në VKM nr.888 datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, Vendimit nr.92 datë 09.03.2023 të Komisionit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, “Për financimin e Agjensisë së Mbykëqyrjes Policore, nga fondi i posaçëm për projektin “Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”, dhe kontratës nr.1165, datë 28.03.2023, Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”.

Mbi këtë bazë ligjore është xhiruar nga AAPSK shuma 16,000,000 lekë për “Blerje pajisje zyre dhe përgjimi për AMP”. Nga kjo shumë është përdorur shuma 15,272,400 lekë dhe shuma e pa përdorur prej 727,600 lekë është kthyer në llogarinë e AAPSK me urdhër shpenzimi nr.376 datë 18.12.2023 të AMP.

Me shkresën nr.6165/5 datë 18.07.2023, është miratuar transferim fondi nga llog, 600 pakësim për 1,000,000 lekë, pakësim llog, 601 për 400,000 lekë dhe është shtuar llog, 606 për 1,400,000 lekë.me shkresën nr.1044/1 datë 05.10.2023 është akorduar shtesë fondi për llog, 606 në shumën 400,000 lekë.

Me shkresën nr.8795/4 prot, datë 26.10.2023, “Njoftim për transferim fondi”, është shtuar llog, 230 për 1,175,222 lekë për Studim projektimi për hartimin e preventivit për shtesë kati godina e AMP, është shtuar edhe llog, 231 për shumën 400,000 lekë, për mbykëqyrje punimesh për “Rikonstruksion/Ndërtim i godinës së SHÇBA”, (Shtesë kati).Pakësim për llog, 231 për shumën lekë 1,575,222 lekë, për “Rikonstruksion/Ndërtim i godinës së SHÇBA”, (Shtes kati). Me shkresën nr.11420/1 prot, datë 30.10.2023 të SP në MB është autorizuar transferim fondi për AMP, në llog, 602 për shumën 17,950,000 lekë.Me shkresën nr.9540 prot, datë 27.10.2023 të SP në MB është urdhëruar transferimi i fondit 1,101,700 lekë brenda për brenda llog, 231.Me shkresën nr.17592/1 prot, datë 13.12.2023 është miratuar rishpërndarja e fondeve brënda nënzërave të shpenzimeve në përbërje të artikullit 602, për shumën 1,137,000 lekë.Me shkresën nr.17232/3 prot, datë 12.12.2023 është njoftuar transferim fondi, shtesë në llog, 606 dhe pakësim në llog, 602 për shumën 400,000 lekë. Me shkresën nr.18542/4 datë 28.12.2023 është akorduar pakësim i fondit për shumën

14,839,000 lekë në llog, 231, për zërin “Zhvillim i internetit dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të TI”. Me shkresën nr.18542/5 prot, datë 28.12.2023, “Njoftim për detajim fondi në shpenzimet korente në zbatim të Aktit Normativ nr.6 datë 14.12.2023”, është pakësuar llog, 600 për 37,000,000 lekë, llog, 601 për 5,500,000 lekë dhe llog, 602 për 2,800,000 lekë. në zbatim të VKM nr.795 datë 28.12.2023, “Për shpërbimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS (SCREENING), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, pikës 5 është akorduar shtesë fondi në llog, 600 për shumën 137,930 lekë me shkresën nr.313/1 datë 15.01.2024. Për këtë shumë nuk rakordon fondi i pagave, pra llog, 600 pasi akordimi i kësaj shume është kryer në fillim vitin 15,01.2024, në zbatim të VKM nr.795 datë 28.12.2023, për llogari të shpenzimeve të vitit 2023, referuar VKM-së.

Për vitin 2023 realizimi i zërave të buxhetit të AMP-së është si më poshtë:

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet Për periudh.	Plani ndryshuar	Ralizimi Fakti	Diferenca	%
600	<i>Paga shpz.tjera personeli</i>	225,903,000	-37,862,070	188,040,930	187,164,957	-875,973	99,5
601	<i>Kont. sig.shoq shënd</i>	37,177,000	-5,900,000	31,277,000	31,074,676	-202,324	99,4
602	<i>Mallra e sherbime</i>	40,000,000	+14,750,000	54,750,000	51,104,692	-3,645,308	93
606	<i>Trans. buxh. familjar</i>	2,000,000	+2,700,000	4,700,000	4,693,710	-6,290	100
230	<i>Shpz.për rritje AQP</i>	2,601,000	+1,175,222	3,776,222	3,359,222	-417,000	89
231	<i>Ndërtime konstruk AQT</i>	72,949,000	-14,222	72,934,778	72,432,470	502,308	98
	Shuma :	380,630,000	-25,151,070	355,478,930	349,829,727	-5,649,203	98,3

Shpenzimet me çelje buxhetore për vitin 2023 janë miratuar për shumën prej 380,630,000 lekë, dhe mbas ndryshimeve për shtesë dhe pakësim të fondeve, plani i ndryshuar është për 355,478,930, nga të cilat realizimi në fakt është për shumën 349,829,727 lekë ose 98,3% e planit të ndryshuar. Analitikisht realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për AMP-në për periudhën e vitit 2023 rezulton si më poshtë.

-“*Paga dhe shpenzime të tjera personeli*”, Art, 600, Në këtë artikull fondet janë realizuar në shumën prej 187,164,957 lekë nga 188,040,930 lekë që është plani vjetor i ndryshuar nga plani fillestar, realizimi është në masën 99,5% .

-“*Sigurimet shoqërore & shëndetësore*”, Art, 601 fondet e planifikuara me ndryshimet e bëra për periudhën janë në shumën 31,277,000 lekë, dhe janë realizuar në shumën prej 31,074,676 lekë ose 99,4 % e planit, realizimi i këtij artikulli ndjek realizimin e artikullit 600, pagat.

-“*Mallra e shërbime të tjera*”, Art, 602, Fondet e miratuara në këtë zë (përfshirë ndryshimet gjatë zbatimit të buxhetit), janë në shumën 54,750,000 lekë, janë realizuar në fakt në shumën prej 51,104,692 lekë ose 93% e planit, me një diferencë në vlerë prej 3,645,308 lekë.

Kjo diferencë në mosrealizim rezulton kryesisht nga kontratat e shërbimeve (p.sh shërbime printimi&fotokopjimi, shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, shpenzime për mirëmbajtjen e aparaturave dhe veglave të punës, etj) të nënshkruara dhe të perealizuara plotësisht, pasi janë kontrata me kohështrirje në 2 vite kalendarike, (kontrata marrveshje kuadër).

-“*Transferim për buxhetet familjare dhe individ*”, Art. 606, fondet e planifikuara në këtë artikull janë në shumën prej 4,700,000 lekë, pas ndryshimeve gjatë zbatimit të buxhetit, janë realizuar në shumën 4,693,710 lekë ose 100% e planit, ose me një mosrealizim prej 6,290 lekë.

-“*Shpenzime për rritjen e aktiveve të patrupëzuara*”, llog, 230, për vitin 2023 Institucionit i është miratuar fond në shumën prej 3,776,222 lekë detajuar i cili është realizuar në shumën prej 3,359,222 leke, ose në masën 89%. Diferenca prej 417,000 lekë rezulton si rezultat i tepërive të fondeve nga procedurat e prokurimit (diferenca në çmimet e konstatuara në fazën e vlerësimit të tregut me çmimin e ofruar nga operatorët ekonomik në fazën e vlerësimit të fituesit).

-“Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara”, llog. 231, Fondet e miratuara në këtë artikull në shumën prej 72,934,778 lekë janë realizuar në shumën prej 72,432,470 lekë të detajuara si mëposhtë;

a- Për projektin “Blerje pajisje zyre dhe përgjimi për AMP”, janë planifikuar fonde në shumën prej 31,308,300 lekë, të cilat janë realizuar në shumën 31,308,300 lekë.

b- Për projektin “Rikonstruksion/ndërtim i godinës së AMP (shitesë kati)”, janë planifikuar fonde në shumën prej 24,124,778 lekë, dhe janë shpenzuar në shumën prej 24,124,770 lekë.

c- Për projektin “Blerje orendi e pajisje zyre (kompjutera)”, janë planifikuar fonde në shumën prej 1,101,700 lekë, janë shpenzuar në shumën prej 599,400 lekë. Diferenca prej 502,300 lekë ka rezultuar si tepriçë nga procedurat e prokurimit (diferenca në çmimet e konstatuara në fazën e vlerësimit të tregut me çmimin e ofruar nga operatorët ekonomik në fazën e vlerësimit të fituesit).

d- Krahas shpenzime të cituara më lart, është raportuar periodikisht, edhe zbatimi i Vendimit të KNMKKO me nr.92, datë 09.03.2023 “Për financiamin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nga fondi i posaçëm, për projektin “Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”, ku është nënshkruar kontrata e përbashkët me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara me nr.1165, datë 28.03.2023 “Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”.

Konform kësaj kontrate AMP-së i ka lindur e drejta e përdorimit të fondit të dhuruar nga ky Institucion në shumën prej 16,000,000 lekë.

Për këtë arsye, bazuar në kërkesën e AMP-së, Dega e Thesarit ka miratuar rritjen e autorizuar duke lejuar vijimin e procedurës së blerjes konformë përcaktimeve të kontratës së sipër cituar.

Në përfundim të procedurës është realizuar blerja për vlerën totale prej 15,272,400 lekë dhe fondi tepriçë prej 727,600 lekë është kthyer në llogarinë e financuesit (kjo në zbatim të kushteve të paracaktuara në kontratën e sipërcituar).

- Respektimi i klasifikimit buxhetor në artikuj, nënartikuj, kapituj, evidentimi i shmangieve dhe nxjerrja e përgjegjësi.

Buxhetit i këtij Institucioni, mbahet me evidenca sintetike dhe analitike, të cilat si në planifikim dhe në zbatimin e tij, japin të dhëna mbi strukturën që zënë programet në totalin e buxhetit, strukturën e artikujve dhe nënartikujve në programet përkatëse dhe në total për gjithë Institucionin, dinamika e shpenzimeve të zërave dhe nënzërave të buxhetit gjatë gjithë vitit, shtesat, paksimet e të gjitha lëvizjet që kryhen gjatë vitit buxhetor.

Nga ana e institucionit nuk ka patur tejkalim të shpenzimeve buxhetore në total dhe në nivel artikulli dhe nuk u konstatuan shmangie apo ndryshime destinacioni në përdorimin e fondeve buxhetore.

-Të analizohen ndryshimet e ndodhura në buxhet gjatë vitit dhe të argumentohen fondet e përealizuara në fund të periudhës ushtrimore.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit janë të regjistruara, e të rakorduar me Degët e buxhetit dhe të Thesarit të Rrethit Tiranë.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për paga, mallra e shërbime është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga dega e thesarit. Është hartuar relacion mbi realizimin e buxhetit dhe nevojat për shtesa në zërat e buxhetit të planifikuar me mungesë. Për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetsore, plani i buxhetit është mbështetur në strukturën e Institucionit, pagat përkatëse sipas ligjeve në fuqi në fushën e pagave dhe të sigurimeve shoqërore.

-Rregullshmëria e mbajtjes së llogarive buxhetore. Raportimi i realizimit të buxhetit, kontrolli, zbatimi dhe rakordimi me degën e thesarit.

Ndjekja e realizimit të buxhetit dhe raportimi i tij bëhet nëpërmjet evidencave të realizimit të buxhetit të cilat janë hartuar dhe raportohen periodikisht sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Situacionet janë plotësuar në mbyllje të çdo muaji dhe janë progresive, të konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë.

Në auditimin për procedurat e hartimit, zbatimit të buxhetit për periudhën e audituar u konstatua se, projekt buxheti i vitit 2022, 2023 dhe 2024 është hartuar sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, nenit 20 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr.459 datë 16.08.2013, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendëshme”, paragrafi i II mbi procedurat standarte të shpërndarjes dhe rishpërndarjes të fondeve të buxhetit vjetor, (detajim i fondeve buxhetore).

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe është dërguar në institucionin qendror MB në rrugë elektronike dhe shkresore.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat gjatë zbatimit të buxhetit, janë të regjistruara e të rakorduara me degën e buxhetit dhe të Thesarit Tiranë dhe janë të raportuara periodikisht në institucionin qendror, në MB.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e çelura në planet financiare dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel artikulli, e nën artikulli sipas shërbimeve.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga dega e thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar me fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Analiza e realizimit të buxhetit është bërë mbi bazën e urdhër shpenzimeve të plotësuara, miratuara, kontrolluara, likuiduara dhe të regjistruara në librat e llogarisë në përputhje me klasifikimin buxhetor. (Ditari shpenzimeve)

Konfirmimi i urdhër shpenzimeve është bërë nga nëpunësi zbatues, në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për Buxhetin e gjashtë mujorit të parë të vitit 2024:

Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026, bazuar në ligjin nr.128/2021 “Për Agjensinë e Mbykëqyrjes Policore”, Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5 datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, si dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm nr.2760/1 datë 21.03.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, për Ministrinë e Brendëshme”. Në këtë kuadër është urdhëruar ngritja e grupit të punës me urdhër të brendshëm nr.276 datë 28.03.2023, të përbërë nga 15 antarë, përfshi edhe drejtorit rajonale. Në përfundim të punës nga grupi i punës është hartuar një relacion i hollësishëm dhe me shkresën nr.1120 prot, datë 14.04.2023 i është dërguar SP dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiarë në MB, “Dërgojmë informacion në lidhje me procesin e PBA-së për vitin 2024-2026”, kjo për fazën e parë. Për fazën e dytë informacioni është dërguar me shkresën nr.2457/1 prot, datë 21.08.2023, brenda afateve ligjore.

Me shkresën nr.18408/29 prot, datë 06.02.2024, të SP të MB, “Dërgohet detajimi i buxhetit për vitet 2024-2026, për shpenzimet korente”, llog, 600 për shumën 227,020,000 lekë, llog, 601 për 37,900,000 lekë, llog, 602 për 50,000,000 lekë dhe llog, 606 për 2,000,000 lekë, në total buxheti për shpenzimet korente për 316,920,000 lekë.Me shkresën nr.18408/39 prot, datë 21.02.2024, të SP të MB, “Dërgohet detajimi i buxhetit për vitet 2024-2026, për shpenzimet kapitale”; Për llog, 230 , “Blerje programi për analizim të dhënash për SHÇBA”, për 2,601,000 lekë, për llog, 231, “Blerje paisje zyre dhe përgjimi për SHÇBA”, për 5,850,000 lekë, blerje orendi e paisje zyre për Godinën e re të AMP, për 6,500,000 lekë dhe për llog, 231 “Rinstruksion/Ndërtim i Godinës së SHÇBA, (Shtesë Kati)”, për 11,000,000 lekë.Me nr.18408/40 prot, është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2024, për shumën 650,000 lekë, llog, 606.

Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024, për 6-mujorin e parë kemi këto ndryshime: Me shkresën nr.4034/4 prot, datë 08.05.2024 të SP të MB, është bërë transferim fondi për shumën 4,082,000 lekë shtesë për llog, 606 dhe pakësim llog, 600, kjo në zbatim të Ligjit nr.97/2023, “Për menaxhimin e buxhetit të vitit 2024” të ndryshuar, të Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “Për menaxhimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave nr.5231/1, datë 26.04.2024 “Transferim fondi për vitin 2024”.Me shkresën nr.3488/6 prot, datë 08.05.2024, është njoftuar për transferim fondi në shpenzimet kapitale, për shumën 187,455 lekë, nga “Rinstruksion/Ndërtim i Godinës së SHÇBA, (Shtesë Kati)”, në “Mbykëqyrje punimesh për Rinstruksion/Ndërtim i Godinës së SHÇBA, (Shtesë Kati)”, për 122,075 lekë dhe për Kolaudim punimesh për “Rinstruksion/Ndërtim i Godinës së SHÇBA, (Shtesë Kati)”, për 65,380 lekë.

Bazuar në Ligjin nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe shkresës së Drejtuesit të Programit Buxhetor nr.18408/1, datë 20.12.2023 “Për detajimin e buxhetit për vitet 2024-2026”, është bërë analiza lidhur me përdorimin e fondeve buxhetore, të akorduara dhe realizuara për periudhën Janar-Qershor 2024.

Në mënyrë të përmbledhur, realizimi i shpenzimeve buxhetore, sipas artikujve kryesor për për periudhën Janar-Qershor 2024, rezultojnë si vijon:

Për 6-mujorin e parë të vitit 2024 realizimi i zërave të buxhetit të AMP-së është si më poshtë:

Art	Emërtimi	Plani vjetor	Ndryshimet Për 6-mujor.	Pl. 6-mujorit i ndryshuar	Ralizimi 6-mujorit	Diferenca	%
600	Paga shpz.tjera personeli	227,020,000	-4,082,000	109,418,000	99,342,097	10,075,903	91
601	Kont. sig.shoq shënd	37,900,000	0	19,000,000	16,251,161	2,748,839	86
602	Mallra e sherbime	50,000,000	0	36,062,200	24,646,247	11,415,953	68
606	Trans. buxh. familjar	2,000,000	4,732,000	6,732,000	3,129,848	3,602,152	46
230	Shpz.për rritje AQP	2,601,000	0	0	0		
231	Ndërtime konstruk AQT	23,350,00	0	11,000,000	6,809,153	4,190,847	62
	Shuma :	342,871,000	+650,000	182,212,200	150,178,506	32,033,694	82

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme konstatojmë se:

-Për periudhën Janar-Qershor 2024, janë miratuar për përdorim fonde në shumën prej 182,212,200 lekë, nga të cilat janë realizuar në shumën 150,178,506 lekë ose 82%.

Të analizuara analitikisht sipas artikujve realizimet e fondeve buxhetore për AMP-në për periudhën e 6-mujorit të parë 2024 rezulton si më poshtë:

-“Paga dhe shpenzime të tjera personeli”, llog, 600, Në këtë artikull fondet janë realizuar në shumën prej 99,342,097 lekë ose 91% e planit të miratuar për periudhën në shumën prej 109,418,000 lekë. Mosrealizimi, në shumën prej 10,075,903 lekë, konsiston nga mosplotësimi i strukturës së miratuar me personel, pasi plani është 170 punonjës/ fakti 159 punonjës.

-“Sigurimet shoqërore & shëndetësore”, llog,601, Fondet e planifikuara për periudhën janë në shumën prej 19,000,000 lekë, nga të cilat janë realizuar 16,251,161 lekë ose 86 % e planit.

Diferenca e mosrealizimit gjatë kësaj periudhe, në shumën prej 2,748,839 lekë ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të fondeve në artikullin 600, mosplotësimi i strukturës së miratuar.

- "Mallra e shërbime të tjera", Art, 602, Fondet e planifikuara në këtë zë, janë për shumën 36,062,200 lekë, realizimi është në shumën prej 24,646,247 lekë ose 68% e planit, me një mosrealizim prej 11,415,953 lekë. Mosrealizimit konsiston në;

a- Moslikujtimi i detyrimit të parashikuar ndaj Bashkisë Tiranë për miratimin e lejes për kryerjen e punimeve në godinën e AMP-së. Kjo për faktin se Bashkia Tiranë nuk ka hartuar faturën në lidhje me këtë detyrim, nga ana e AMP-së janë zbatuar procedurat ligjore për marrjen e lejes mbi kryerjen e punimeve në godinë, (Dosja e investimit).

b- Mosrealizimi i shpenzimeve në funksion të veprimtarisë hetimore/informative (në shumën 1,000,000 lekë) të cilat përdoren rast pas rasti konformë urdhërit të Titullarit (*konformë VKM-së nr.741, datë 05.11.2014 "Për përcaktimin e kushteve, kriterëve të përdorimit dhe kontrollit të fondit të posaçëm, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme"*).

c- Gjithashtu rezultojnë me mosrealizime edhe disa nënzëra të llog, 602, realizimi i të cilëve është i kushtëzuar nga realizimi kontratave konform faturave të shërbimit për çdo 3-mujor.

- "Transferim për buxhetet familjare dhe individë", Llog, 606, Fondi i planifikuara për periudhën raportuese është në shumën 6,732,000 lekë (përfshirë dhe fondin e veçantë për 650,000 lekë të miratuar për vitin buxhetor), realizimi është për shumën 3,129,848 lekë ose 46% e planit të periudhës me një diferencë në vlerë prej 3,602,152 lekë (përfshirë fondin e veçantë).

Fondi i mbetur për përdorim është fondi vjetor që do të mbulojë nevojën për shpenzime në këtë artikull për gjithë periudhën e mbetur buxhetore.

- "Shpenzime për rritjen e aktiveve të patrupëzuara" Llog, 230, Për vitin 2024 Institucionit i është miratuar fond në shumën 2,601,000 lekë detajuar për realizimin e projektit "*Blerje programi për analizim të dhënash*". Aktualisht procedura e prokurimit, është në fazën e përgatitjes së dokumenteve standarte të tenderit.

- "Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara", Llog, 231, Fondi i miratuar në këtë artikull është në shumën 23,350,000 lekë, i detajuar si më poshtë;

a- "Rikonstruksion/ndërtim i godinës së AMP (shtesë kati)", në zbatim të kontratës nr.2695, datë 25.08.2023 me operatorin ekonomik fitues nga procedura e tenderit për fondin prej 34,269,000 lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023 në shumën prej 24,124,770 lekë ndërsa vijojnë punimet për zbatimin e plotë të kontratës edhe për vlerën e mbetur për vitin aktual në shumën prej 10,144,222 lekë. Aktualisht janë përfunduar punimet dhe procedura është në proces marrje në dorëzim të punimeve kontraktuale. Fondi i realizuar si 6-mujor është në masën e 6,809,153 leke.

b- "Blerje pajisje zyre dhe përgjimi për A.M.P" në shumën prej 5,850,000 lekë. Procedura e blerjes realizohet bazuar në Ligjin nr.36/2020 "*Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*", VKM-së nr.1170, datë 24.12.2020 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*" si dhe VKM-së nr.542, datë 29.09.2021 "*Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë*".

c- "Blerje orendi e pajisje zyre" për shumën prej 6,500,000 lekë, veprimet janë në proces të hartimit dhe zbatimit të procedurave tenderuese. *Realizimi i fondeve për periudhën Janar-Qershor 2024 është në masën 82%*.

Nga auditimi i sistemit të buxhetit për periudhën e audituar konstatojmë se:

Ndryshimet e ndodhura në buxhet gjatë zbatimit të buxhetit për vitin 2022, 2023 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2024, sa i përket rishpërndarjes së fondeve buxhetore, shtesave dhe paksimeve ose dhe transferimeve në nënartikuj brenda për brenda artikullit, janë të mbështetura me akte shkresore

të instancës eprore si dhe janë të regjistruara dhe të rakorduara me Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Nga auditimi lidhur me planifikimin miratimin dhe zbatimin e buxhetit për të tre vitet 2022, 2023, 2024 u konstatua se:

Lidhur me procedurën teknike të ngritjes së grupit të punës për hartimin e PBA për buxhetin e institucionit të AMP, u konstatua se nga sektori i financës dhe grupi i punës që ngrihet me urdhër të Titullarit të Institucionit, janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për përgatitjen dhe dërgimin në instancat eprore të PBA. Duke u nisur nga analiza e mësipërme e realizimit të buxhetit për periudhën e audituar rezulton se:

Opinion: Në përfundim të auditimit të sistemit të buxhetit vlerësojmë se, menaxhimi dhe stafi i Institucionit ka punuar për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore që normojnë këtë sistem. Grupi punës në parashikimin e buxhetit ka marrë në konsiderat realizimin e buxhetit në vitin paraardhës ashtu siç përcaktohet në ligj. Në lidhje me zbatimin e buxhetit është siguruar funksionimi normal i veprimtarisë së institucionit, përmes ndjekjes kronologjike të shpenzimeve të kryera. Ky veprim si dhe rialokimi i fondeve buxhetore gjatë zbatimit të buxhetit për vitin ushtrimor përkatës ka bërë që realizimi faktik i buxhetit të jetë në masën 95-100% të fondeve të planifikuara, me gjithë ndryshimet e bëra gjatë zbatimit të buxhetit.

➤ ***Mbi auditimin e dokumentacionit lidhur me administrimin/dokumentimin e mallrave e materialeve të përfituara nga donacionet rezultoi:***

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e AMP, për të gjithë periudhën e auditimit, rezultoi se, Institucion i AMP-së, ka përfutur me 5 procedura donacione të ndryshme të cilat konsistojnë kryesisht në fushën e paisjeve elektronike, të cilët në total kapin vlerën 1,747,178 lekë mallra e materiale nga të cilat, (një donacion me vlerë 24,000 lekë i kryer në vitin 2023 dhe 4 donacione të kryera gjatë vitit 2024, që kapin shumën 1,723,178 lekë).

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e AMP, sa i përket procedurës së ndjekur dhe dokumentacionit justifikues të përfutimit të donacioneve rezultoi se, nga 5 praktikat e paraqitura, mallrat e materialet janë bërë hyrje të cilët bashkëngjitur kanë faturën/proces verbalin e dorëzimit të donatorit. Marrja në dorëzim e donacioneve është bërë nga komisioni posaçëm i krijuar me urdhër të titullarit, marrja në dorëzim është konfirmuar e marrë hyrje nga përgjegjësi material/magazineri.

Mallrat dhe materialet e përfituara nga donacionet sipas subjekteve dhurues dhe dokumentimit të procesit janë si vijon:

Për vitin 2023, nga kompania D&E shpk, me akt dhurimi nr.514 prot, datë 22.02.2023, artikujt, jelek copë 25 dhe kapele copë 25 me vlerën 24,000 lekë janë bërë hyrje me fh nr.4 datë 28.02.2023 të magazinës së AMP, përgjegjësi material G.Selfollari, sipas aktit të marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr.202 datë 23.02.2023, “Për krijimin e komisionit të koaludimit dhe marrjes në dorëzim të paisjeve donacion”.

Për vitin 2024, komisioni është ngritur urdhër të titullarit nr.11 datë 05.01.2024, i ndryshuar me urdhër të titullarit nr.123 datë 06.02.2024, “Për krijimin e komisionit të koaludimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2024”. Me akt dhurimi nr.1233 prot, datë 28.03.2024, “Dhurim pajisjesh për Agjensinë e Mbykëqyrjes Policore (AMP), Ministria e Brendshme”, nga Atesheu i ICITAP, në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Tiranë. Paisjet e bëra dhuratë/donacion janë 2 Kompjuter Lap Top, me vlerën sejcili 159,990 lekë dhe në total 2 x 159,990 = 319,980 lekë, bërë hyrje me fh, nr.5 datë 02.04.2024.

-Me fletë hyrjen nr.9 datë 15.05.2024, janë bërë hyrje një aparat celular me çmim 31,900 lekë, një aparat me çmim 42,900 lekë dhe tre adaptor me vlerën 5,370 lekë në total vlera e fh është 80,170 lekë, donacioni është dhuruar nga subjekti “Vodafone Albania”, në zbatim të aktmarrveshjes datë 29.04.2024, për shërbimet e sipërcituara, shërbimi është shoqëruar me faturat faturat elektronike nr.414, 419,416, datë 15.05.2024.

-Me fletë hyrjen nr.10 datë 22.05.2024, janë bërë hyrje 4 (katër) kompjutera me monitor DELL dhe atrecaturat përkatëse me çmim 157,764 lekë/copë si dhe 1(një), kompjuter dhe monitor Lenovo me çmim 342,042 lekë/copë, shuma totale e faturës/fh është 973,098 lekë.

Donacioni është bazuar në kontratën e sponsorizimit nr.1802/1 prot, datë 22.05.2024 të AMP dhe nr.27-24 prot, të kompanisë “Comunication Progres”, Tiranë.

-Me fletë hyrjen nr.11 datë 30.05.2024, janë bërë hyrje 7(Shtatë) Kompjutera Laptop te tipit Laptop Lenovo, me çmim 49,990 lekë/copë, me vlerën totale të donacionit 349,990 lekë. Donacioni është i bazuar në dokumentin e dhurimit me nr.2158 prot, datë 30.05.2024, bërë nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë, “Dhurim Paisjesh për Agjensinë e Mbykëqyrjes Policore (AMP)”, Tiranë.

-Përfitimi në lekë: Me kërkesën për rritjen e autorizimit buxhetor nr.1429 prot, datë 15.05.2023 të AMP, të bazuar në VKM nr.888 datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, Vendimit nr.92 datë 09.03.2023 të Komisionit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, “Për financimin e Agjensisë së Mbykëqyrjes Policore, nga fondi i posaçëm për projektin “Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”, dhe kontratës nr.1165, datë 28.03.2023, Për rritjen e kapaciteteve tekniko-shkencore, për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret”.

Mbi këtë bazë ligjore është xhiruar nga AAPSK shuma 16,000,000 lekë për “Blerje pajisje zyre dhe përgjimi për AMP”. Nga kjo shumë është përdorur shuma 15,272,400 lekë dhe shuma e pa përdorur prej 727,600 lekë është kthyer në llogarinë e AAPSK me urdhër shpenzimi nr.376 datë 18.12.2023 të AMP.

Referuar evidentimit/administrimit të dhurimeve/donacioneve nga partner të ndryshëm akorduar AMP-së, konstatohet se nga ana e strukturës së ngarkuar për marrjen e donacioneve është vepruar në mënyrë korrekte në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-IV/4. Auditimi i procedurave ligjore për prokurimin e fondeve, realizimi i kontratave.

Regjistri parashikimit dhe realizimit të prokurimit. Zbatimi i kërkesave ligjore përprocedurën e prokurimit. Llogaritja e fondit limit, zgjedhja e procedurave të prokurimit sipas fondit limit. Hartimi i dokumentacionit të procedurave prokurimit. Respektimi i afateve gjatë proceduravetë prokurimit, kryerja e procedurave të prokurimit. Realizimi i kontratave, pritja dhe kolaudimi i mallrave dhe shërbimeve.

Sipas planit të buxhetit për periudhën e audituar Maj-Dhjetor 2022, viti 2023 dhe Janar-Qershor 2024 për artikullin 602 “Shpenzime operative” dhe 231 “Rritja e AQT-ve” janë hartuar regjistrat vjetor të parashikimeve të prokurimeve publike dhe të realizimeve. Në auditimin e regjistrat të parashikimit dhe realizimit periodik 4 mujorë përkatës rezulton se, regjistrat janë dërguar me shkresë përcjellëse brenda afatit të përcaktuar. Janë bërë ndryshime në regjistrin e parashikimeve ndryshime të cilat janë të dokumentuara.

Nga auditimi i hartimit të regjistrave të parashikimit dhe realizimit sipas periudhave respektive të audituara u konstatua se hartimi i regjistrave të cilët konfirmohen nga strukturat menaxhuese nuk

i përmbahej plotësisht kërkesave të përcaktuara dhe formateve Tip të Udhëzimit të APP nr.4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin elektronik”. Konkretisht;

-Në regjistrin e parashikimit për vitin kalendarik përfshiheshin edhe procedurat e prokurimit të realizuara në vitin paraardhës të cilët e kishin kohëzgjatjen e realizimit në periudhë 2-3 vjeçare, ndërkohë që në regjistrin e parashikimit duhet të evidentohen vetëm ato procedura të cilat janë parashikuar për tu realizuar gjatë vitit kalendarik/buxhetor për plotësimin e nevojave të institucionit.

-Në regjistrin e realizimit nuk evidentoheshin të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit tip, por regjistroheshin edhe të dhëna të panevojshme si rezultat i regjistrit të parashikimit i cili përmbante procedurat e realizuara në vitin parardhës.

-Në sistemin elektronik të APP-së referuar regjistrave të prokurimeve (parashikim dhe realizim) u konstatua se, për procedurat e prokurimit marrëveshje kuadër nuk pasqyroheshin në sistemin elektronik lidhja e minikontrave, veprim në mospërputhje me pikën 7 të Manualit Teknik të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. konkretisht “Sa i takon krijimit në sistem të njoftimeve të tjera të kontratave që do të nënshkruhen (minikontratat) gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, duhet të krijohen si element/e në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit...”, përgjegjësi e personit përgjegjës për sistemin elektronik të APP-së.

Referuar periudhës në auditim dhe realizimit të procedurave të prokurimit sipas regjistrit të realizimit, rezultoi se;

-Për vitin 2022; janë realizuar 23 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në vlerë totale 6.662.013 lekë, 1 procedurë prokurimi sekrete në vlerë totale të kontraktuar 4.932.000 lekë dhe 2 procedura prokurimi tender të zhvilluara nga AK dhe ASHBP të kontraktuara me vlerë totale 24.036.466 lekë. Procedurat e prokurimit sekrete dhe procedurat e prokurimit tender të zhvilluara nga AK dhe ASHPMB kanë afate zbatimi 2-3 vite, pra i shtrijnë efektet e tyre edhe në vitin 2023 dhe 2024.

-Për vitin 2023, nga ana e AK janë realizuar; 15 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në vlerë totale 3.075.217 lekë, 3 procedura prokurimi sekrete në vlerë totale të kontraktuar 40.637.250 lekë dhe 6 procedura prokurimi tender të zhvilluara nga AK dhe ASHBP të kontraktuara me vlerë totale 37.202.760 lekë.

-Për periudhën Janar - Prill 2024, nga ana e AK janë realizuar; 5 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në vlerë totale 814.700 lekë, 1 procedura prokurimi sekrete në vlerë totale të kontraktuar 5.949.000 lekë dhe 1 procedura prokurimi tender të zhvilluara nga ASHBP të kontraktuara me vlerë totale 1.666.666 lekë. Procedurat e prokurimit u audituan nga dokumentacioni i printuar dhe administruar në dosjet përkatëse sistemi i APP-së arkiva nuk logohej si rezultat i sistemeve elektronike mbrojtëse të AMP-së.

-Procedurat e prokurimit publik me blerje vlera të vogla.

Nga ana e AK për periudhën e auditimit janë miratuar urdhërat për ngritjen e njësisë së prokurimit, urdhri i personit përgjegjës së sistemit elektronik të APP-së.

Me urdhër të nëpunësit autorizues, është ngritur komisioni i prokurimeve me vlera të vogla, mbështetur në pikën 2 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 “Për procedurat e prokurimit publik me vlera të vogla” i ndryshuar.

Nga ana e strukturave përkatëse të AMP-së, është paraqitur kërkesë nevoja për mallra dhe shërbime të ndryshme. Njësia e prokurimit ka argumentuar fondin limit me tre operatorë ekonomik duke mbajtur procesverbalin për secilin OE me çmimet e mallrave apo shërbimeve të kërkuara, mbi bazën e këtij dokumentacioni është nxjerrë UP për blerjen me vlera të vogla ku është përcaktuar sasia dhe natyra e blerjes së bashku me ftesën për ofertë për mallra dhe shërbime duke përcaktuar kriteret e përgjithshme e të veçanta si dhe i ka publikuar në sistem.

Është dërguar ftesa për ofertë pesë OE duke argumentuar ftesën e tyre si operatorë ekonomik të cilët operojnë në treg me kontrata të kësaj natyre, ka vijuar procedura për vlerësimin e OE deri në shpalljen fitues të OE në sistemin elektronik të APP-së, në zbatim të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 “Për procedurat e prokurimit publik me vlera të vogla” i ndryshuar.

-Për dokumentacionin e prokurimeve me vlera të vogla nuk ekzistojnë dosje të veçanta për secilën por kanë të administruar gjithë dokumentacionin e plotë të procedurës së prokurimit, pasi e gjithë praktika e prokurimeve me vlera të vogla i bashkangjitet si dokumentacion justifikues urdhër shpenzimeve të bankës për operatorëve ekonomik fitues. Referuar auditimit me përzgjedhje të dokumentacionit të bankës për bjerjet e vogla, bashkelidhur urdhër shpenzimit, është fatura tatimore, fletëhyrja, kërkesa e bërë për nevojaat e procedurës, përlllogaritja e fondit limit, urdhri i prokurimit, ftesa për ofertë së bashku me specifikimet teknike sipas natyrës së mallrave apo shërbimit, praktika e plotë e prokurimit e printuar nga sistemi elektronik, shpallja e fituesit, dokumentacioni vertetues i OE i cili dorëzohet në sekretarinë e institucionit, procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave ose shërbimeve dhe një listë inventari për gjithë procedurën e prokurimit.

-Për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve të prokuruar, titullari i AK ka përcaktuar komisionet përkatëse sipas llojit të procedurës prej 3 punonjësish, të cilët pas verifikimeve kanë mbajtur proces-verbale të përkatëse. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve të furnizuara nga operatori ekonomik fitues sipas proces verbaleve kanë qenë në përputhje me sasinë cilësinë dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

-Për procedurat e prokurimit të zhvilluara nga ASHBP, marrëveshje kuadër-Furnizim me lëndë djegëse gazoil + benzinë, blerje goma, bateri, riparim mjete transporti, shërbim printimi, etj, referuar autorizimeve të dërguara është lidhur kontrata sipas përcaktimeve të bëra në dokumentacionin bashkëlidhur. Nga ana e AMP-së është bërë dhe dërguar njoftimi për lidhjen e kontratës në APP, është përcaktuar ekipi i menaxhimit të kontratës të cilët kanë ndjekur zbatimin e tyre si dhe është bërë raportimi perfundimtar për zbatimin e kontratës.

-Procedurë “Procedurë e hapur- Punë”, me objekt: “Rikonstruksion/Përforcim i godinës dhe shtesë kati i godinës së AMP-së”, me fond limit: 37,610,073 lekë (vlera pa TVSH), me numër reference REF-74355-07-05-2023

<i>Të dhëna për procedurën e prokurimit.</i>	<i>Njësia e Hartimit të Dokumentave .</i>	<i>Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.</i>
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>
Urdhër prokurimi nr.1939/1, datë 29.06.2023. Fondi limit pa T.V.SH 37.610.073 lekë. Njësia Prokurimit .1939/1, datë 29.06.2023 Urdhëri i KVO nr.538 prot., datë 05.07.2023, Lloji i procedurës:“E hapur -Punë Firma fituese: “2N” L31615017L.	-Gëzim Sala, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, person përgjegjës -Irakli Ndoni, Agjencia Shtetërore e prokurimeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme, -Elda Uku, Jurist, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në AMP,	-Dritan Dorda, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm - Pranvera Hajdini, Shef Sektori i Buxhet&Financës -Inxhinier Mishel Mejdani, Specialist i fushës, nga Policia e Shtetit

<p>Data e lidhjes së kontratës 2695 prot, datë 25.08.2023. Vlera e kontratës:29.000.000 lekë pa tvsh dhe 34.800.000 lekë me TVSH. Autoriteti Kontraktues:AMP</p>	<p>-Enio Kumaraku, Specialist fushe, Inxhinier Ndërtimit, pranë Policisë së Shtetit -Jetmir Gjoni, Specialist fushe, për rrjetet dhe sistemet e TI-së, në Sektorin e TI-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së.</p>	<p>-Armand Reka, Specialist në Sektorin e TI-së, -Sterjo Golloshi, Shef Sektori i Inspektimit,</p>
--	---	--

Referuar investimit të realizuar për Rikonstruksion/Përforcim i godinës dhe shtesë kati i godinës së AMP-së”, nga ana e Amp-së nëpërmjet kontraktimit për bashkëpunim të bërë me Institutin e Ndërtimit me Nr.1165/5 datë 04.11.2022 përfaqësuar nga Titullarët e tyre.

Objekt i kontratës; Hartimi i project preventimit të zbatimit për përforcimin e objektit ekzistues si dhe për shtesë kati të godinës së re të AMP-së, instalimi i rrjeteve dhe sistemeve TI, elektrike, hidraulike dhe atyre qëndrore të ngohje-ftohje. Çmimi i kontratës 1.219.279 leke me tvsh.

Nga ana e Institutit të ndërtimit është hartuar projekti së bashku me preventivat përkatës dhe është bërë marrja në dorëzim e dosjeve dhe dokumentet përkatëse me anë të procesvebalit nr.2480/1 datë 19.12.2022 të nënshkruar nga përfaqësuesit e AMP-së. Me urdhër shpenzimin nr.331, datë 06.11.2023 me vlerë 1.175.222 lekë është bërë likuidimi nga artikulli 230 “Projekte”. Instituti i Ndërtimit në akt ekspertizën e dërguar, ka vlerësuar se Qëndrueshmëria e strukturës e cila merr në konsideratë shtimi në katit dhe struktura e re për shtimin e katit e preventivuar vlera totale e preventivuar është 44.515.685,18 lekë me tvsh.

-Referuar dokumentacionit të hartuar nga instituti i ndërtimit, preventivat përkatës rezulton se nga ana e AMP-së është proceduar për të kryer procedurën e prokurimit të investimit e preventivuar me vlerën 37.610.073 lekë pa tvsh.

Gjatë procedurës së prokurimit, janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(të ndryshuar).

Me Urdhër të Titullarit të AK-së në bazë të nenit 41, gërma a, pika 1, neni 42 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 77 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik” (të ndryshuar), është ngritur urdhëri i prokurimit me nr.1939/1 datë 29.06.2023, ku është përcaktuar lloji i procedurës “E hapur” (punë), me mjete elektronike, në këtë urdhër është përcaktuar edhe njësia e prokurimit e përbërë nga 5 anëtarë (3 punonjës të AMP-së, 1 Inxhinier punonjës i DPPSH dhe 1 punonjës i ASHPP.

Njësia e prokurimit ka përgatitur përgatitur dokumentacionin e tenderit sipas dokumentave standarte të tenderit dhe ka përcaktuar kriteret për kualifikim të dokumentuara në dosjen fizike të procedurës së prokurimit me procesverbal nr.1939/2 datë 05.07.2023

Me urdhër të Titullarit të AK nr.538 datë 05.07.2023 është ngritur KVO e përbërë nga 5 anëtarë (4 punonjës të AMP-së, 1 Inxhinier punonjës i DPPSH)

Janë respektuar afatet kohore për dorëzimin e ofertave të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kanë paraqitur ofertat operatorët ekonomikë si më poshtë:

1- “2N” shpk numër NIPT-i L31615017L.

Vlera e ofruar 29.000.000 lekë (Pa TVSH).

2-“Ergi“ sh.p.k numër NIPT-i K02727229P.

Vlera e ofruar 32.258.911 (pa TVSH).

3-“Aida Konstruksion &6D- Plan“ numër NIPT-i M03116403L &L62717405H

Vlera e ofruar 27.792.595,38 lekë (pa TVSH).

4-“ASI-2A CO & 2Z konstruksion“ numër NIPTI-i K53002402C &J63229466K.

Vlera e ofruar 30.010.651,4 lekë (pa TVSH).

5-“Desaret“sh.p.k me numër NIPT-i K01816001J

Vlera e ofruar 35.347.379,98 lekë (pa TVSH).

6-“BE-IS“ numër NIPTI-i K71412003A.

Vlera e ofruar 36.207.957 lekë (pa TVSH).

7-“Hastoci “ numër NIPTI-i J62028009B

Vlera e ofruar 34.500.801,98 lekë (pa TVSH).

8-“Martini Konstruksion &Real-Estate“ numër NIPTI-i K81314023A

Vlera e ofruar 34.467.825,92 lekë (pa TVSH).

9-“INA“ numër NIPTI-i J60814009Ë.

Vlera e ofruar 29.179.397 lekë (pa TVSH).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me procesverbalin nr.1 prot, datë 29.07.2023, ka bërë evidentimin dhe shqyrtimin e dokumenteve ligjore administrative dhe kualifikuese të shoqërive konkurruese brenda afatit të përcaktuar në nenit 82 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik”(të ndryshuar).

KVO-ja ka kualifikuar operatorët të cilët përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

1- “2N” shpk numër NIPT-i L31615017L.

2-“Ergi“ sh.p.k numër NIPT-i K02727229P.

3-“Desaret“sh.p.k me numër NIPT-i K01816001J

4-“BE-IS“ numër NIPTI-i K71412003A.

5-“Hastoci “ numër NIPTI-i J62028009B

6-“Martini Konstruksion &Real-Estate“ numër NIPTI-i K81314023A

Ndërsa operatorët ekonomik të skualifikuar janë : “Aida Konstruksion &6D- Plan“ numër NIPT-i M03116403L &L62717405H ; “ASI-2A CO & 2Z konstruksion“ numër NIPTI-i K53002402C &J63229466K ; “INA“ numër NIPTI-i J60814009Ë, si rezultat i mangësive të konstatuara në 2.3.3 kriteret e vecanta të kualifikimit, mangësi dokumentacioni këto mangësi: mugesë e listpagesa të këruara për punonjësit periudha Janar-Prill; mungesë e deklarimeve të sigurimeve shoqërore të muajit qershor, mospakim të kontributeve shoqërore e shëndetësore.

Është bërë “Njoftim Fituesi Paraprak” me formularin, i cili është dërguar për publikim në buletin e APP-së. Është bërë respektimi i afateve kohore 7 ditore të ankimit pas klasifikimit të KVO, për operatorët ekonomik pjesmarrës kjo e përcaktuar në LPP (nenin 110, pika 1) & VKM (nenin 97, pika 2/b).

Operatori ekonomik fitues është paraqitur pranë AK-së dhe nga KVO është mbajtur procesverbali datë 07.08.2023 për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në përfundim të saj rezultoi se i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik në formë të shkruar(origjinal dhe fotokopje e noterizuar) është i njëjtë me atë të paraqitur në tender.

Ky kualifikim për operatorin ekonomik fitues ”2N” shpk është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me raportin përmbledhës me nr.2593/1 prot, datë 16.08.2023.

Pas publikimit në buletin të “Njoftim Fituesi Përfundimtar” për operatorin ekonomik fitues të kësaj procedure prokurimi, Titullari i AK dhe operatori ekonomik i shpallur fitues kanë lidhur kontratën nr.2695 prot., datë 25.08.2023 me vlerë 34.269.000 lekë me tvsh. Lidhja e kontratës është bërë brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për

miratimin e rregullave të Prokurimit publik”(të ndryshuar), bashkëngjitur është sigurimi i kontratës në vlerën 3.426.900 lekë datë 14.08.2023, 10% e vlerës së kontratës.

-Referuar dokumentacionit në dosjen e procedurës së prokurimit rezultoi se, ato ishin të administruara të nënshkruara dhe të inventarizuara, por konstatohet se nuk kishin një numër protokollit në vijimësi, pra për procedurat e prokurimit në librin e protokollit duhet të vijoj me numrin e protokollit të urdhrit të prokurimit e deri në përfundim të procedurës të ketë një numër protokollit me fraksion, kjo për efekt të mirëadministrimit dhe dokumentimit hap pas hapi të procedurave prokuruese.

-Mbi zbatimin e kontratës

Për likuidimin e investimit fondet buxhetore sipas periudhave kalendarike; fondi i miratuar (me ndryshime) për vitin 2023 është në shumën 24,124,778 lekë, i cili është realizuar në vlerën prej 24,124,770 lekë, ndërsa fondi i miratuar (me ndryshime) për vitin 2024 është në shumën 10,812,545 lekë i realizuar deri në 30/06/2024 në vlerën prej 6,809,153 lekë.

- Bazuar në kontratën nr.2695, datë 25.08.2023 “Përforcim i godinës dhe shtesë kati i godinës së AMP-së” nënshkruar me operatorin ekonomik fitues “2N” sh.p.k (i cili ka rezultuar fitues nga procedurat e tenderimit) për vlerën totale prej 34,269,000 lekë e shtrirë në periudhën 25/08/2023 deri me 24/04/2024, janë likuiduar detyrimet e paraqitura në situacionet përkatëse deri me datë 30/06/2024 në total , si më poshtë;

Me urdhër shpenzimin nr.350, datë 21/11/2023 është likuiduar detyrimi prej 7,285,295 lekë (pa përfshirë garancinë teknike në vlerën 383,437 lekë. Dokumentacioni bashkëngjitur praktikës së likuidimit: situacioni nr.1, datë 10/11/2023, relacioni teknik i mbikëqyresit të punimeve për periudhën 28/08 – 10/11/2023, fatura tatimore nr.97, datë 15/11/2023.

-Me urdhër shpenzimin nr.388, datë 26/12/2023 është likuiduar detyrimi prej 15,633,236 lekë (pa përfshirë garancinë teknike në vlerën 822,802 lekë. Dokumentacioni bashkëngjitur praktikës së likuidimit: situacioni nr.2, datë 18/12/2023, relacioni teknik i mbikëqyrësit të punimeve për periudhën 10/11 – 18/12/2023 dhe fatura tatimore nr.108, datë 18/12/2023.

-Me urdhër shpenzimin nr.197, datë 24/06/2024 është likuiduar detyrimi prej 6,468,695lekë (pa përfshirë garancinë teknike në vlerën 340,458 lekë. Dokumentacioni bashkëngjitur praktikës së likuidimit: situacioni nr.3, datë 22/05/2024, relacioni teknik i mbikëqyrësit të punimeve për periudhën 18/12/2023 – 22/05/2024, fatura tatimore nr.40, datë 23/05/2024.

Nga auditimi mbi menaxhimin e investimit nga Ekipi i Menaxhimit i përbërë nga 3 punonjës (z.Dorda, z. Laçi, z.Sala) të AMP-së rezultoi se, ky ekip nuk ka specialist të fushës (ing), për rrjedhojë edhe menaxhimi i kontratës nga ky ekip ka qenë në bashkëpunim të ngushtë me mbikëqyrësin e punimeve, sa i përket realizimit të përgjegjësisë që duhet të ketë EMK-ja, anëtarët e EMK-së kishin administruar një me dokumentacion të relatuar (e-maile) gjatë gjithë procesit të investimit me mbikëqyrësin dhe zhvilluesin lidhur me problematikat e konstatuara në kohë gjatë investimit, dokumentacion mbi mbikëqyrjen, ndjekjen dhe ecurinë e investimit sipas kërkesave të pikës 7 të nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, konkretisht; *Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.* Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës; etj.

-Mbikqyrje punimesh konform kontratës nr.2696, date 25.08.2023 ne vlere totale prej 522,075 leke e shtrire ne 2 vite (2023-2024). Kontretisht parashikuar dhe realizuar 400,000 leke me urdhër shpenzimin nr.389, date 26.12.2023 dhe vlera prej 122,075 leke parashikuar per tu realizuar ne vitin 2024.

-Kolaudim punimesh konform kontratës nr.1732/2, date 16.05.2024 ne vlere totale prej 50,523 leke (viti 2024).

Gjatë periudhës së auditimit në institucion investimi kishte përfunduar ish-in në process kolaudimi dhe likuidimit përfundimtar të investimit dhe marrjen provizore në dorëzim.

-Për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, referuar regjistrin të realizimit u konstatua se për periudhën e audituar 2022, 2023 dhe 6-mujori 2024 janë realizuar 5 procedura sekrete me fond total 51.518.250 lekë, shërbim për mirëmbajtje sistemeve të sigurisë së IT dhe blerje materia përgjimi.

Audituesi M.H auditoi procedurën sekrete me objekt “Rritja e kapaciteteve tekniko shkencore për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambiantal dhe vëzhgimit sekret”. Për relizimin e këtij prokurimi fondet janë akorduar nga AAPSK nëpërmjet kontratës nr.1165 datë 28.03.2023 me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional, për projektin e AMP-së.

Për realizimin e kësaj procedure prokurimi janë ndjekur kërkesat ligjore të ligjit 36/2020 “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” të VKM-së 1170/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, lidhur me këtë procedurë është marrë miratimi nga AKSIK dhe procedura është e klasifikuar “Sekret”.

Në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata me nr.2218/datë 24.07.2023 me OE fitues me vlerën 15.272.400 lekë me tvsh.

Nga auditimi i dokumentacionit të bankës rezultoi se me urdhër shpenzimin nr.300 datë 10.10.2023 është bërë likuidimi i OE fitues në vlerën 15.272.400 lekë, bashkëlidhur fatura tatimore, fletëhyrja, procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave .

-Nga auditimi i kësaj procedure lidhur referuar komponentit të aktivitetit të kontrollit, të ligjit të MFK-së rezultoi se; Kërkesa e paraqitur për nevojën e këtyre mallrave, projekti, duhet të ishte e mirëargumentuar dhe e konkretizuar me nevojën reale, sasitë konkrete të domosdoshme dhe argumentet përkatëse. Argumentimi përse këto mallra duhet të klasifikohen si procedura sekrete në përputhje me listën e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror për dokumentacionin e AMP-së të përcaktuara në Vendimin nr.-L datë 17.11.2021 seksioni D; Nr.1-67.

-Në testimin e tregut nuk dokumentohet qartë nëse dërgimi i listës së mallrave për ofertë është e shoqëruar me specifikimet teknike të hartuar nga specialistët e fushës. Si dhe nuk ish-in administruar në dosje shkresat e dërguara me protokoll për marrje oferte e si rezultat edhe ardhja e ofertave me protokollin zyrtar të institucionit, veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit të MFK-së, përgjegjësi e komisioneve përkatëse.

Titulli i gjetjes: Mangësi në hartimin e regjistrave te parashikimit, realizimit dhe procedurave prokuruese.

Nr. Gjetje 3	
Subjekti i audituar	Agjencia e Mbikqyrjes Policore
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat menaxhuese për funksionimin e Institucionit AMP, MB.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, Vkm 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Udhëzimi i APP nr.4

	<p>datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin elektronik”. i ndryshuar, pikën 7 të Manualit Teknik të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. ligjit 36/2020 “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” të VKM-së 1170/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”; komponenti aktivitetit të kontrollit, të ligjit të MFK-së.</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga auditimi i hartimit të regjistrave të parashikimit dhe realizimit sipas periudhave respektive të audituara u konstatua se hartimi i regjistrave të cilët konfirmohen nga strukturat menaxhuese nuk i përmbahej plotësisht kërkesave të përcaktuara dhe formateve Tip të Udhëzimit të APP nr.4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin elektronik”. Konkretisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në regjistrin e parashikimit për vitin kalendarik përfshiheshin edhe procedurat e prokurimit të realizuara në vitin paraardhës të cilët e kishin kohëzgjatjen e realizimit në periudhë 2-3 vjeçare, ndërkohë që në regjistrin e parashikimit duhet të evidentohen vetëm ato procedura të cilat janë parashikuar për tu realizuar gjatë vitit kalendarik/buxhetor për plotësimin e nevojave të institucionit. -Në regjistrin e realizimit nuk evidentoheshin të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit tip, por regjistroheshin edhe të dhëna të panevojshme si rezultat i regjistrit të parashikimit i cili përmbante procedurat e realizuara në vitin paraardhës. -Në sistemin elektronik të APP-së referuar regjistrave të prokurimeve (parashikim dhe realizim) u konstatua se, për procedurat e prokurimit marrëveshje kuadër nuk pasqyroheshin në sistemin elektronik lidhja e minikontrave të marrëveshjes kuadër, veprim në mospërputhje me pikën 7 të Manualit Teknik të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. konkretisht “Sa i takon krijimit në sistem të njoftimeve të tjera të kontratave që do të nënshkruhen (minikontratat) gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, duhet të krijohen si element/e në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit...”, përgjegjësi e përsosur përgjegjës për sistemin elektronik të APP-së. -Për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, me objekt “Rritja e kapaciteteve tekniko shkencore për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambiental dhe vëzhgimit sekret” me fond limit 13.324.668 lekë pa tvsh, rezultoi se; Kërkesa e paraqitur për nevojën e këtyre mallrave, projekti, duhet të ishte e mirëargumentuar dhe e konkretizuar me nevojën reale, sasitë konkrete të domosdoshme dhe argumentet përkatëse. Argumentimi

	<p>përse këto mallra duhet të klasifikohen si procedura sekrete në përputhje me listën e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror për dokumentacionin e AMP-së të përcaktuara në Vendimin nr.-L datë 17.11.2021 seksioni D; Nr.1-67.</p> <p>-Në testimin e tregut nuk dokumentohet qartë nëse dërgimi i listës së mallrave për ofertë është e shoqëruar me specifikimet teknike të hartuar nga specialistët e fushës. Si dhe nuk ishin administruar në dosje shkresat e dërguara me protokoll për marrje oferte e si rezultat edhe ardhja e ofertave me protokollin zyrtar të institucionit, veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit të MFK-së.</p> <p>-Referuar dokumentacionit në dosjen e procedurës së prokurimit Rikonstruksion/Përforsim i godinës rezultoi se, ato ishin të administruara të nënshkruara dhe të inventarizuara, por konstatohet se nuk kishin një numër protokoll në vijimësi, pra për procedurat e prokurimit në librin e protokollit duhet të vijoj me numrin e protokollit të urdhrat të prokurimit e deri në përfundim të procedurës protokoll/fraksion, kjo për efekt të mirëadministrimit dhe dokumentimit hap pas hapi të procedurave prokuruese, gjurmës së auditimit sipas komponentit e aktivitetit të kontrollit.</p> <p>Kriteri: Ligji 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, Vkm 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Udhëzimi i APP nr.4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrat të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrat të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin elektronik”. i ndryshuar, pikën 7 të Manualit Teknik të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. ligjit 36/2020 “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” të VKM-së 1170/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”; komponenti aktivitetit të kontrollit, të ligjit të MFK-së.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosplotësim i saktë i kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit public dhe të mbrojtjes dhe sigurisë.</p> <p>Shkaku: Mosfunksionim i plotë i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm nga personi përgjegjës për prokurimin public, njësitë e argumentimit te fondit limit, njesit e prokurimit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mosfunksionim i plotë i kontrollit të brendshëm, mosplotësim i saktë i kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik dhe të mbrojtjes dhe sigurisë.
Rekomandimi	Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet përcaktimeve me procedure standarte, të të gjitha fazave dhe veprimet konkrete që duhet të ndiqen për realizimin e procedurave prokuruese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (nisur nga kërkesë/nevoja për shërbim ose

	<p>mallra dhe deri në marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave), referuar akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen dhe sigurinë dhe akteve ligjore e nënligjore për mirëpërdorimin dhe mirëadministrimin e fondeve buxhetore.</p> <p>-Drejtori i Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e regjistrave të prokurimeve në zbatim të plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e APP-së nr.4 datë 18.06.2021, të azhurnohet regjistri në sistemin elektronik të APP-së duke pasqyruar minikontratat e lidhura për procedurat marrëveshje kuadër.</p> <p>-Për të gjitha procedurat prokuruese, dokumentacioni përkatës për realizimin e procedurës ti referohet një numri protokoll (urdhrit të prokurimit) dhe të vijohet me të njëjtin protokoll me fraksion deri në përfundim dhe arkivimin e dosjes së prokurimit.</p>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijim
Statusi i rekomandimit	

Opinion: Në përfundim të auditimit të kësaj fushe vlerësojmë se, mungon funksionim i plotë i kontrollit të brendshëm me impakt në mosplotësim të saktë të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik dhe sigurisë.

-IV/5. Auditimi i procedurave për menaxhimin e burimeve njerzore.

Auditimi i strukturës e organikës së institucionit, respektimi i kërkesave ligjore dhe rregullores për emërimet e personelit të ri dhe transferimeve brenda sistemit, përputhshmëria funksionit për periudhën e audituar. Rregullshmëria e dosjes së personelit dhe vlerësimi i përfomancës së personelit. Ndjekja dhe zbatimi i procedurave për masat disiplinore nga procesi i fillimit të ecurisë disiplinore deri në marrjen e vendimit përkatës.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) është një strukturë unike dhe e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor (e organizuar në drejtori dhe sektorë). Kjo njësi drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka funksionuar për të gjithë periudhën e auditimit.

AMP e kryen veprimtarinë bazuar në kërkesat e ligjit nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, i cili është miratuar në datë 20.12.2021 dhe ka hyrë në fuqi në datën 10.02.2022.

Struktura e AMP-së, për zbatimin e kërkesave specifike të ligjit të ri, të përcaktuara në nenet 8-82, sipas të cilave ka hartuar dhe është miratuar me VKM nr.532, datë 29.07.2022 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e AMP-së”. Gjithashtu edhe sa i përket kërkesës ligjore (nenit 70 pika 3 të ligjit të ri) është miratuar me VKM nr.487, datë 21.07.2022 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të AMP”, i ndryshuar me VKM nr.321, datë 31.05.2023.

Konkretisht struktura e AMP-së është e organizuar në këtë mënyrë; (1 Drejtor i Përgjithshëm, 1 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, 3 punonjës Kabinet), 6 Drejtori dhe 17 Sektorë në varësi të drejtorive përkatëse (Drejtoria e Hetimit me 12 punonjës, Drejtoria e Forcës së Posacme Operacionale me 29 punonjës, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së personelit me 13 punonjës, Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave me 16 punonjës, Drejtoria e vlerësimit kalimtar/periodik me 16 punonjës dhe Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbështetëse me 17 punonjës). Gjithashtu kemi 7 Drejtori Rajonale, struktura e të cilave është (1 Drejtor për secilën drejtori dhe në total 13 sektorë në gjithë drejtoritë rajonale), konkretisht kemi (15 punonjës në Drejtorinë Rajonale

Tiranë, 7 punonjës në Drejtorinë Rajonale Durrës-Kavajë, 8 punonjës në Drejtorinë Rajonale Shkodër-Lezhë, 8 punonjës në Drejtorinë Rajonale Kukës-Dibër, 8 punonjës në Drejtorinë Rajonale Elbasan-Korçë, 8 punonjës në Drejtorinë Rajonale Fier-Berat, 8 punonjës në Drejtorinë Rajonale Vlorë-Gjirokastrë).

Struktura e AMP-së për periudhën Maj-Dhjetor 2022 është e përcaktuar me urdhër nr.31, datë 30.01.2020 “*Për miratimin e strukturës dhe përbërjes organike të SHÇBA*”, organikë me 157 funksione të miratuara e cila është ndryshuar me VKM nr.117, datë 28.07.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së AMP*” me 170 funksione, efektet e të cilës hynë në fuqi në Janar 2023. Kjo organikë e re është shtuar me 13 funksione dhe me strukturë të re (*shtuar Drejtoria e forcës së posaçme operacionale/Spektori mjeteve shkencore dhe depërtimit*) ndryshim i cili është si rezultat i zgjerimit të objektit të veprimtarisë së AMP-së, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.12/2018 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, GR dhe SHÇBA në MB*”, i ndryshuar, me qëllim për ta kthyer shërbimin në një agjenci mbikqyrëse sipas standardeve të EPAC-ut.

Nisur nga ndryshimet strukturore dhe organizative të përshkruara më sipër, si dhe procesit të implementimit të organikës së re, e cila hyn në fuqi menjëherë dhe shtrin efektet financiare në Janar 2023, auditimi për periudhën Maj 2022 deri në Dhjetor 2022 u krye duke u bazuar në procedurat e hartuara nga institucioni bazuar në ligjin nr.70/2014 dhe organikën e miratuar me urdhër të MB nr.31, datë 30.01.2020. Për këtë periudhë organika e AMP rezulton me 157 punonjës (*96 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 61 punonjës në 7 Drejtoritë Rajonale vartëse*) nga të cilët 75 punonjës personel me gradë dhe 82 punonjës civil të cilët janë të ndarë në 77 punonjës me statusin e punonjësve me kontratë sipas kodit të punës dhe 5 punonjës me statusin e nëpunësit civil. Duke filluar nga Janari 2023 deri në Qershor 2024 (periudhë auditimi), hyn në veprim urdhri nr.117, datë 28.07.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AMP-së*”, me numër punonjësish gjithsej 170 (*108 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 62 punonjës në Drejtoritë Rajonale Vendore*). Me urdhrin nr.189, datë 15.11.2022 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.117, datë 28.07.2022, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AMP-së”*”, kemi ndryshim në strukturë me shtimin dhe pakësimin e një pozicioni “ndihmës specialist”. Konkretisht shtohet një pozicion ndihmës specialist në organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të AMP (Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm) dhe shkurtohet një pozicion ndihmës specialist tek (Spektori i forcës së posaçme operacionale). Në fund të muajit Qershor 2024 rezultojmë me mosplotësim organike prej 13 punonjësish, ku (*5 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 8 punonjës në Drejtoritë Rajonale*).

Nga vlerësimi i kërkesave specifike të miratuara në ligj të krahasuara me ato të miratuara në rregulloren e brendshme rezulton se, në rregulloren e brendshme janë përfshirë dhe miratuar të gjitha kërkesat e përcaktuara e të miratuara në ligjin organik, kërkesa të cilat kanë të bëjnë me, (*Specifikimet e stemës dhe simboleve të Agjencisë; Rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimeve dhe trajtimin të ankesave; Procedurat e ekzaminimit poligrafik; Armatimin, mjetet dhe pajisjet që përdor Agjencia; Rregullat dhe procedurat e hetimit disiplinor, afatet, si dhe procedurat e ankimimit; Rregullat e normat e etikës; Shkeljet disiplinore si dhe rregullat e procedurat që ndiqen gjatë hetimit disiplinor, përfshirë procesin e ankimimit; Procedurat e konkurrimit e pranimeve dhe emërimit në detyrë dhe kriteret e vlerësimit të punës; Trajtimin financiar të punonjësve të transferuar përkohësisht jashtë vendbanimit dhe procedurat e lejes pa të drejtë page etj).*

Për të gjithë periudhën e auditimit lëvizjet e personelit (*transferime/lirime*) kanë qënë të shpeshta

përfshirë këtu edhe caktimet në detyrë të personelit sipas organikës së re. Të gjitha lëvizjet e personelit (*lirimet dhe transferimet e brendshme*) janë bërë me urdhër të titullarit të institucionit. Personeli i larguar nga shërbimi është dokumentuar me urdhër të titullarit (*Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit*), në të cilin është përcaktuar saktë si motivacioni dhe afati i ndërprerjes financiare.

Nga vlerësimi i të dhënave mbi lëvizjet e personelit gjatë periudhës rezulton se, organika nga 170 funksione të miratuara deri në fund të muajit Qershor 2024, është e plotësuar me 157 funksione (punonjës), pa u plotësuar me 13 funksione.

U audituan me përzgjedhje 8 dosje personeli, konkretisht; (Sh.Z, G.S, A.H, E.B, A.T, J.E, M.H dhe A,B). Nga auditimi i kompletimit me dokumente dhe administrimit të dosjeve të personelit rezultoi se zyra e burimeve njerëzore e AMP-së administron dosje origjinale të punonjësve të punësuar sipas kompetencës. Dosjet e personelit përmbajnë dokumentet përkatëse të çdo punonjësi (kërkesa për punë, arsimimi, kopja e diplomës, kualifikime të ndryshme, përvoja e punës, aktet dhe urdhërat e emërimit, vlerësimet e punës, masat disiplinore).

-Referuar lëvizjeve të personelit, emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve për periudhën e audituar, lëvizje të cilat mbaheshin edhe në databazën e personelit (e cila duhet përditësuar në vazhdimësi) bazuar në strukturën e re të miratuar, u evidentua se nga ana e ish titullarit të institucionit janë emëruar 15 punonjës pa proces konkurimi, (2 punonjës gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2022, 13 punonjës në vitin 2023, gjatë periudhës së auditimit për 5 nga punonjësit e emëruar pa konkurim, nga ana e institucioni është vepruar duke u kryer procedura e konkurrimit për ta legjitimuar emërimin konformë akteve ligjore e nënligjore. *Bashkëlidhur pasqyrën përkatëse.*

Emërimi i punonjësve pa kryer procedurat e konkurrimit, pa nënshkruar kontratën e punës është në mospërputhje me nenet 51-57 “Emërimi dhe ecuria në karrierë” të Ligjit 128/2021 “Për AMP” dhe me nenet 67-85, Pjesa 5, Kreu I, “Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë” të VKM nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP”, me impakt/ndikim negativ në buxhetin e shtetit, pasi referuar pikës (g) të nenit 85 të VKM-së nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP” është përcaktuar se periudha e qëndrimit në punë në AMP është 5 vite, ky përcaktim bën që lëvizjet e punonjësve largimet e tyre të mos shoqërohen me efekte financiare shtesë dhe si rrjedhojë të ketë edhe një qëndrueshmëri në punë, pasi institucioni investon nëpërmjet shkollimit/trajnimeve etj, përgjegjësi e Ish Titullarit të AMP-së.

-*Auditimi i saktësisë së trajtimit të punonjësve sipas nivelit të pagave dhe shtesave mbi pagë (mbikohë pune, vështirësi shëndeti, kompensimit të privacioneve dhe humbjeve që shkaktohen për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit dhe shpërblime). Dokumentacioni mbështetës (listëprezencave, urdhrave, etj) të pagesave sipas llojeve (në fushën e pagave), deklarimit dhe derdhjes në afat në organet e tatimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, etj.*

Përpilimi dhe administrimi i listëpagesave të pagave dhe trajtimeve me shtesa të tjera të personelit është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikës 69 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Për periudhën e auditimit llogaritja e pagës së punonjësit është bazuar në pagën për funksion për personelin e posaçëm dhe pagës së grupit për personelin civil si dhe shtesat mbi pagë për natyrë të veçantë pune, sipas urdhrit të emërimit apo lëvizjes së personelit në funksionet organike, në

përputhje me pagat e miratuara në VKM nr.176, datë 08.03.2017 Për disa ndryshime në vendimin nr.149, datë 18.02.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të SHCBA në MB”, për periudhën Maj-Dhjetor 2022, VKM nr.487, datë 21.07.2022 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të AMP-së”, për periudhën Janar-Prill 2023, VKM nr.321, datë 31.05.2023 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të AMP-së” për periudhën në vazhdim.

Punonjësit mbështetës janë trajtuar me VKM nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” dhe VKM nr.326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”. Llogaritjet e pagës mujore dhe të ardhurave të tjera të përfituara bashkëlidhur kanë dokumentacionin urdhërues mbështetës i administruar (kopje) me listëpagesat e të shoqëruara edhe me listëprezencën. Dokumentacioni i konfirmuar nga struktura përgjegjëse.

-Bashkëlidhur listpagesave, dokumentacioni justifikues urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të hartuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore për lëvizjet, transferimet, emërimet dhe largimet, rezultoi se, në urdhrat e emërimeve të punonjësve të AMP-së, nuk evidentoheshin saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsia në punë, me impakt në saktësinë e elementëve financiar të pagës, veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit si dhe detyrat funksionale sipas përshkrimeve të punës për burimet njerëzore.

Titulli i gjetjes: Emërimi i punonjësve në punë pa kryer procedurat e konkurimit edhe pranimit, mangësi në hartimin e urdhrave të emërimit, transferimit.

Nr.Gjetjes 4	
Subjekti i audituar	Agjencia e Mbikqyrjes Policore
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat menaxhuese për funksionimin e Institucionit AMP, MB.
Baza ligjore	Ligji 128/2021 “Për AMP” nenet 51-57 “Emërimi dhe ecuria në karrierë” dhe nenet 67-85, Pjesa 5, Kreu I, “Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë” të VKM nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit, Komponenti Aktiviteti i Kontrollit.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Referuar lëvizjeve të personelit, emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve për periudhën e audituar, lëvizje të cilat mbaheshin edhe në databazën e personelit (e cila duhet përditësuar në vazhdimësi) bazuar në strukturën e re të miratuar, u evidentua se nga ana e ish titullarit të institucionit janë emëruar 15 punonjës pa proces konkurimi, (2 punonjës gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2022, 13 punonjës në vitin 2023) për 5 nga punonjësit e emëruar pa konkurim, nga ana e institucioni është vepruar duke u kryer procedurat e konkurimit për ta legjitimuar emërimin konformë akteve ligjore e nënligjore të AMP-së. Emërimi i punonjësve pa kryer procedurat e konkurimit, pa nënshkruar kontratën e punës është në mospërputhje me nenet 51-57 “Emërimi dhe ecuria në karrierë” të Ligjit 128/2021 “Për AMP” dhe me nenet 67-85,

	<p>Pjesa 5, Kreu I, “<i>Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë</i>” të VKM nr.532/2022 “<i>Për organizimin dhe funksionimin e AMP</i>”, me impakt/ndikim negativ në buxhetin e shtetit, pasi referuar pikës (g) të nenit 85 të VKM-së nr.532/2022, është përcaktuar se periudha e qëndrimit në punë në AMP është 5 vite, ky përcaktim bën që lëvizjet e punonjësve largimet e tyre të mos shoqërohen me efekte financiare shtesë dhe si rrjedhojë të ketë edhe një qëndrueshmëri në punë, pasi institucioni investon nëpërmjet shkollimit/trajnimeve etj, përgjegjësi e Ish Titullarit të AMP-së.</p> <p>-Bashkëlidhur listpagesave, dokumentacioni justifikues urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të hartuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore për lëvizjet, transferimet, emërimet dhe largimet, rezultoi se, në urdhrat e emërimeve të punonjësve të AMP-së, nuk evidentoheshin saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsia në punë, me impakt në saktësinë e elementëve financiar të pagës, <i>veprime në mospërputhje me komponentin aktiviteti i kontrollit si dhe detyrat funksionale sipas përshkrimeve të punës për burimet njerëzore.</i></p> <p>Kriteri: Ligji 128/2021 “<i>Për AMP</i>” nenet 51-57 “<i>Emërimi dhe ecuria në karrierë</i>” dhe nenet 67-85, Pjesa 5, Kreu I, “<i>Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë</i>” të VKM nr.532/2022 “<i>Për organizimin dhe funksionimin e AMP</i>”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” i ndryshuar; Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit, Komponenti Aktiviteti i Kontrollit.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mos përmbushja e detyrimeve ligjore menaxheriale për procedurat e pranimit, konkurrimit dhe emërimit, me impakt/ndikim negativ në buxhetin e shtetit.</p> <p>Shkaku: Menaxhimi i lartë i AMP-së ka vepruar në mospërputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara Ligji 128/2021 “<i>Për AMP</i>” nenet 51-57 “<i>Emërimi dhe ecuria në karrierë</i>” dhe nenet 67-85, Pjesa 5, Kreu I, “<i>Procedurat për pranimin dhe emërimin në detyrë</i>” të VKM nr.532/2022 “<i>Për organizimin dhe funksionimin e AMP</i>”.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mos përmbushja e detyrimeve ligjore menaxheriale nga ish Titullari për procedurat e pranimit, konkurrimit dhe emërimit, me impakt/ndikim negativ në buxhetin e shtetit.
Rekomandimi	<p>Menaxhimi i lartë i institucionit, për pranimet dhe emërimet në punë të punonjësve të AMP-së të veprojnë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të ligjit 128/2021 “<i>Për AMP</i>” dhe VKM nr.532/2022 “<i>Për organizimin dhe funksionimin e AMP</i>”, referuar kriterëve të përcaktuara për funksionin dhe përshkrimin e punës.</p> <p>-Sektori i Burimeve Njerëzore në hartimin e urdhrave për lëvizjet, transferimet, emërimet të evidentojë saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsinë në punë.</p>

	-Sektori i Burimeve Njerëzore në hartimin e urdhrave për lëvizjet, transferimet, emërimet të evidentojë saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsinë në punë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijim
Statusi i rekomandimit	

Auditimi i dokumentacionit për pagesat me pagë e shtesa në pagë të personelit u bë me përzgjedhje për pagat e 7 muajve, e konkretisht muajit Gusht, Nëntor 2022 (*periudhë e cila ka lidhje me implementimin e organikës së re të njësisë të miratuar me urdhër nr.117, datë 28.07.2022*) muajt Mars, Korrik, Dhjetor 2023 si dhe pagat e muajve Shkurt, Prill 2024.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në të dhënat për realizimin e buxhetit të artikullit 600 “Paga” dhe dokumentimin nëpërmjet akteve të rakordimit vjetor të shpenzimeve me thesarin si dhe ditarin e llogarisë së shpenzimeve, rezulton se institucioni për periudhën vitin 2022 ka shpenzuar në total nga artikulli 600 shumën 140,168,881lekë; për vitin 2023 shumën 187.164.957 lekë dhe për 6/mujorin 2024 shumën 99.342.097 lekë.

Në auditimin me përzgjedhje të pagave evidentojmë se, marrdhëniet e institucionit për trajtimin me pagë të punonjësve janë me 6 bankat e nivelit të dytë në të cilat personeli ka llogaritë personale. Për çdo muaj personeli është likuiduar me pagën dhe shtesat në pagë neto bazuar në llogaritjen e pagës së punonjësit sipas funksionit organik si dhe të shtesave e cila është e shoqëruar edhe me listëprezencën në punë të punonjësit e cila është e plotësuar me të dhënat e arsyes apo mosarsyes në punë të punonjësit (*me leje të zakonshme, mungon, me raport mjekësor, etj*).

Dokumentacioni për sistemin e pagave në këtë njësi shpenzuese është i mbajtur dhe prodhohet në format elektronik. Listëpagesa ose pasqyrat e pagave të personelit është e rakorduar me përmbledhësen mujore dhe urdhër shpenzimit e kalimit të pagave në thesar e bankë, të cilat janë të konfirmuara nga personeli menaxhues i AMP, thesari dhe punonjësi bankës dhe më vullën e institucioneve.

Nga vlerësimi i listëpagesave të punonjësve për muajt e përzgjedhur në auditim rezulton se, llogaritja mujore e pagës së punonjësit është bërë sipas urdhrave të caktimit në detyrë si dhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për pagat.

Listëpagesat e dërguara në bankë, rakordojnë me listëpagesat e llogaritjes së pagave dhe me urdhërshpenzimet përkatëse dhe janë nënshkruar nga nëpunësi zbatues dhe miratuar nga nëpunësi autorizues, janë të vulosura me vullën e institucionit të thesarit dhe me vullën e bankës së nivelit të dytë në të cilën punonjësit kanë llogaritë bankare. Shuma neto e pagave në përmbledhësen e listëpagesës së bankës përputhej me vlerën e urdhërshpenzimeve sipas bankave dhe me vlerat neto të listëpagesave të llogaritjes së pagave së secilit punonjës.

Referuar organizimit strukturor, sipas të cilës AMP është e organizuar në nivel qendror dhe në Drejtori Rajonale e menaxhohet nga sektori burimeve njerëzore në AMP evidentojmë se, listëprezencën në punë e punonjësve është hartuar në një pasqyrë mujore për të gjithë personelin e AMP dhe është e konfirmuar vetëm nga Drejtori Përgjithshëm i AMP, bashkëlidhur listëprezencën në punë e personelit nga drejtuesit e strukturave për personelin në varësi .

-Në drejtim të trajtimit të punonjësve për vështirësi shëndeti, kompensimit të privacioneve dhe humbjeve që shkaktohen për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit, largësi dhe shpërblime rezulton se,

Institucioni për periudhën Maj-Dhjetor 2022, vitin 2023 dhe 6/mujorin 2024 nuk ka pagesa të trajtimit të personelit me mbikohë pune për orë jashtë orarit zyrtar të punës.

-Trajtimi me dëmshmëri shëndeti, është kryer në zbatim të VKM nr.690, datë 09.12.2012 “Për një ndryshim dhe shtesa në VKM nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”. Trajtimi punonjësve me shtesë për dëmshmëri është kryer me urdhër të titullarit pasi është bërë më parë miratimi i trajtimit të funksioneve që përfitojnë dëmshmëri nga Ministria e Shëndetësisë. Për periudhën Maj-Dhjetor 2022-2023-6/mujori 2024 të audituar, janë shpenzuar në total 1,402,783 lekë (425,013 lekë në vitin 2022 për 10 punonjës, 578,087 lekë në vitin 2023 për 11 punonjës dhe 399,683 lekë/muaj për 6/mujorin 2024 për 13 punonjës). Trajtimi financiar është i rregullt sipas shkallës I/a dhe II/f me dokumentacion të plotë justifikues.

-Trajtimi i punonjësve me leje të zakonshme, është bërë në zbatim të rregullores së AMP, miratuar me VKM nr.532, datë 29.07.2022. Për periudhën Maj-Dhjetor 2022, 2023 dhe 6/mujorin 2024 është hartuar grafiku i lejeve të zakonshme për punonjësit nga ana e strukturave (drejtori, njësi, sektorë e zyra) dhe një kopje është dërguar në sektorin e burimeve njerëzore i cili ka përgatitur urdhrin e titullarit të institucionit, bashkëngjitur grafiku sipas periudhave dhe funksioneve. Për çdo muaj është ndjekur zbatimi i planifikimit të lejeve për të cilën në çdo rast është miratuar me urdhër të titullarit të institucionit. Për punonjësit të cilët nuk kishin kryer lejen sipas planifikimit ishte bërë anulimi për ta kryer në një periudhë tjetër. Nuk janë kryer pagesa për punonjësit që nuk kanë kryer lejen vjetore.

-Trajtimi punonjësve me ndihma ekonomike. Për periudhën Maj-Dhjetor 2022-2023 dhe 6/mujorin 2024 nga artikulli 606, në zbatim të pikës 7, të VKM nr.493, datë 06.07.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” janë shpenzuar në total 1,134,530 lekë për 18 punonjës. Për periudhën Maj-Dhjetor 2022, janë trajtuar me ndihma ekonomike 2 punonjës në shumën 144,280 lekë, për raste vdekje të familjarëve të punonjësit të cilët kanë përfituar ndihmë në masën 30,000 lekë. Për vitin 2023, janë trajtuar me ndihma ekonomike 13 punonjës në shumën 575,000 lekë, për 6/mujorin 2024 janë trajtuar me ndihma ekonomike 3 punonjës në shumën 415,250 lekë. Ndihma ekonomike është dhënë me urdhër të titullarit i justifikuar edhe me dokumentacionin përkatës.

-Trajtimi personelit me “Shpërblime”. AMP për periudhën Maj-Dhjetor 2022, vitin 2023 dhe 6/mujorin 2024 ka shpenzuar në total fondin 2,476,293 lekë, nga i cili 601,672 lekë janë shpenzuar në periudhën Maj-Dhjetor 2022 për shpërblim të 10 punonjësve me motivacion për rezultate konkrete të arritura (dokumentuar me urdhër të titullarit për çdo punonjës). Shuma 672,930 lekë është shpenzuar në vitin 2023 për shpërblim të 23 punonjësve dhe shuma 1,201,691 lekë është shpenzuar për 6/mujorin 2024, shpërblim për 10 punonjës.

Në të gjitha rastet e trajtimit të personelit me ndihmë ekonomike dhe me shpërblim, dokumentacioni bashkëlidhur është i plotë dhe justifikon veprimin e kryer të pagesës mbi bazën e fondeve të akorduara e të miratuara.

-Auditimi i trajtimit të bashkëshorteve me pagë. Për periudhën objekt auditimi (Maj-Dhjetor 2022-2023 dhe 6/mujorin 2024), është trajtuar me pagë bashkëshorti 1 bashkëshorte e punonjësit. Në periudhën Maj-Dhjetor 2022 bashkëshortja ka përfituar pagën në vlerën 262,000 lekë, për vitin 2023 ka përfituar pagën në vlerën 456,000 lekë dhe për 6/mujorin 2024 ka përfituar pagën në vlerën 240,000 lekë. Trajtimi me pagë bashkëshortësh, është kryer në zbatim të nenit 77 të ligjit nr.128/2021 për AMP dhe të VKM nr.722, datë 13.12.2023. Dokumentacioni në dosje është i plotë për bashkëshorten e punonjësit të AMP.

-Trajtimi i punonjësve me largësi. Punonjësit e AMP, për rastet kur emërohen e caktohen në detyrë

jashtë vendbanimit përfitojnë shtesë page në zbatim të pikës 1 të VKM nr.722, datë 13.12.2023 “Për disa të drejta të punonjësve të AMP-së”. Bazuar në këtë kërkesë të VKM, për periudhën Maj-Dhjetor 2022, vitin 2023 dhe 6/mujorin 2024, institucioni në urdhërat e caktimit në detyrë të punonjësve ka përcaktuar edhe trajtimin me shtesë për largësi, vlerë e cila është përfituar nga punonjësit në masën e llogaritur sipas largësisë së vendbanimit e konkretisht; për vitin 2022 janë shpenzuar 1,665,410 lekë për shtesë page për largësi 21 punonjës, në vitin 2023 janë shpenzuar 2,336,548 lekë për 32 punonjës dhe për 6/mujorin 2024 janë trajtuar 15 punonjës në shumën 1,526,818 lekë.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me largësi, përfitimi largësisë është bërë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe administrohet në dosjen e punonjësit dokumentacioni justifikues (*vërtetimet e lëshuara nga njësia administrative për vendbanimin të cilat shprehen mbi vendbanimin e familjes së punonjësit dhe mbi vendbanimin e vetë punonjësit të trajtuar me largësi, certifikata familjare e lëshuar në datën e fillimit të trajtimit me largësi dhe urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm mbi trajtimin e punonjësit me largësi nga vendbanimi*). Njëkohësisht llogaritja e pagesës së largësisë është bërë në përputhje me pikën 1 të VKM nr.722 datë 13.12.2023, “Për disa të drejta të punonjësve të AMP” sipas të cilit, “Punonjësi i SHÇBA në MPB, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/saj, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit,), si dhe të VKM nr.532 datë 29.07.2022, “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e AMP-së”.

-*Trajtimi punonjësve me reformë (pagesë kalimtare)*. Për periudhën e auditimit (Maj-Dhjetor 2022, vitin 2023 dhe 6/mujorin 2024), në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare”, VKM nr.793, datë 24.09.2010 “Për zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare”, dhe Aktit Normativ të KM nr.5, datë 10.11.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare...”, janë trajtuar me pagë kalimtare (reformë). Për periudhën Maj-Dhjetor 2022 janë trajtuar 6 punonjës në vlerën 1,685,943 lekë, për vitin 2023 janë trajtuar me pagesë reforme 10 punonjës në shumën 3,257,710 lekë, ndërsa për 6/mujorin 2024 janë trajtuar me pagesë reforme 12 punonjës në shumën 2,215,962 lekë.

Për të gjitha rastet e trajtimit të punonjësve me pagën për reformë, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar pagesa me dy paga mujore dhe në vazhdim pas 2 muajsh trajtimi është bërë me 50% të pagës neto dhe është përcaktuar periudha kohore e trajtimit të punonjësve sipas vjetërsisë së shërbimit në përputhje me nenin 12, pika 1,2 dhe 3 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009.

-*Auditimi i ndalesave, deklarimit dhe derdhjes në afat në organet e tatimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, etj.*Listëpagesat, në pjesën e ndalesave, kanë pasqyruar ndalesat mujore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare si dhe tatimin mbi të ardhurat personale që paguhen nga punëmarrësit. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare, që paguhen nga punëmarrësi, është bërë e saktë, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. (*Për llogaritja e pagesës së sigurimeve shëndetësore është bërë konform kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.113/2021 Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.*

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale (*pa përfshirë kompensimet në lekë të uniformës e trajtuar në vijim*), është bërë e saktë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Tatimi mbi të ardhurat e llogaritur për punëmarrësin, është derdhur në organet tatimore përkatëse brenda afatit ligjor në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të

ardhurat”, i ndryshuar, ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, si dhe aktit normativ nr.05, datë 10.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009”.

-Në auditimin e procedurës së ndjekur për trajtimin e personelit me kompensim në lekë për uniformën në masën e një page mujore bruto në vit rezultoi se,

Institucioni me fondet buxhetore të planifikuara e të akorduara në vitin 2022, 2023 dhe 2024 në artikullin 602, ka trajtuar personelin me një pagë mujore bruto, në zbatim të nenit 74 të ligjit nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore”; nenit 105, pika 8 e VKM nr.532, datë 29.07.2022 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e AMP-së” ; pikës 6 të VKM nr.776, datë 19.11.2014 “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MB” dhe VKM nr.722, date 13.12.2023 “Për disa të drejta të punonjësve të AMP-së”.

Për vitin 2022, 2023 dhe 2024 është nxjerrë në fillim të çdo viti urdhëri i titullarit “Për kompensimin në vlerë lekë të veshjes civile”. PAGESA është bërë me lista të miratuara në formë grafiku. Për këtë periudhë (Maj-Dhjetor 2022, v.2023 dhe 6/mujori 2024) janë trajtuar 405 punonjës me një pagë bruto, sa masa e një page mujore e vendit të punës për kompesim uniforme të gjithë punonjësit në total për 42,266,525 lekë, e cila u është kaluar punonjësve në llogarinë bankare, (9,458,796 lekë për 108 punonjës në periudhën Maj-Dhjetor 2022, vlera 17,010,551 lekë për 154 punonjës në vitin 2023 dhe vlera 15,797,178 lekë për 143 punonjës në 6/mujorin 2024).

- Auditimi i trajtimit të punonjësve me shpenzime për udhëtim e dieta, evidencat mbështetëse të kontrollit të brendshëm lidhur me kryerjen e shërbimit në destinacionin e autorizuar.

Për periudhën në auditim (Maj-Dhjetor2022, viti 2023 dhe 6/mujori 2024), punonjësit e institucionit kanë kryer shërbime jashtë vendbanimit të tyre. PAGESAT e urdhër shërbimeve janë bërë në zbatim të VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre” e ndryshuar.

Për këtë periudhë nga fondet buxhetore të akorduara në artikullin 602 për shpenzime udhëtim e dieta, institucioni për periudhën Maj-Dhjetor 2022 ka shpenzuar në total 2,283,220 lekë duke likuiduar punonjësit për 142 raste shërbimesh dhe për vitin 2023 ka shpenzuar shumën 3,774,640 lekë duke likuiduar punonjësit për 485 raste shërbimesh, gjithashtu për 6/mujorin 2024 ka shpenzuar shumën 1,407,500 duke likuiduar punonjësit për 274 raste shërbimesh. Auditimi i dokumentacionit të dietave u krye me përzgjedhje të rastësishme. Shërbimet e kryera nga punonjësit jashtë vendit. Për periudhën e auditimit (Maj-Dhjetor2022, viti 2023 dhe 6/mujori 2024), punonjësit e institucionit kanë kryer shërbime jashtë vendit. Shpenzimet e shërbimeve janë kryer nëpërmjet arkës së institucionit në zbatim të VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë kryer në Euro, të cilat janë konvertuar në Lek dhe pagesat janë realizuar nëpërmjet arkës së institucionit. Nga auditimi dokumentacionit rezulton se, në total janë shpenzuar për udhëtime jashtë vendit 668,495 lekë, për 12 raste (285,206 lekë në periudhën Maj-Dhjetor 2022 për 7 raste, 24,464 lekë në vitin 2023 për 2 raste dhe 358,825 lekë në 6/mujorin 2024 për 3 raste). Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se shërbimi është kryer mbi bazën e urdhrit të Ministrit të Brendshëm “Për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të punonjësve të AMP” ku janë përcaktuar shteti, data e nisjes dhe e kthimit në institucion, punonjësi që do të kryejë shërbimin. Bashkangjitur urdhër shërbimit të konfirmuar nga nëpunësi udhëtues, nëpunësi zbatues e nëpunësi autorizues janë dhe dokumentat të tjera mbështetëse të cilat janë të hartuara konform akteve ligjore në fuqi.

Opinion: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për pranimet, emërimet, transferimet, lirimet vlerësojmë se, nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore që normojnë këtë proces, mangësi në hartimin e urdhrave të emërimit, transferimit.

-IV.6. Auditimi i sistemit të pagesave nëpërmjet thesarit dhe bankës.

Auditimi i transaksioneve me bankën (thesarin), rregullariteti i veprimeve me bankën, dokumentacioni justifikues i veprimeve, regjistrimi në ditarët e llogarisë kontabël.

Auditimi i kontrollit paraprak të dokumentacionit që kalon në financë për likuidim (sistemi i kontrollit para likuidimit). Auditimi i lidhur me likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve dhe evidentimi i efekteve financiare për vonesat e krijuara në likuidim (nëse ka) adresimi i përgjegjësive përkatëse.

Nga auditimi rezultoi se, për periudhën e kohës objekt auditimi, njësia shpenzuese (AMP) ka kryer rregullisht regjistrimin dhe dokumentimin e veprimeve kontabile në ditarin e bankës. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dokumentacioni është kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe sistematike në ditarin e bankës. Konfermat e bankës janë kuadruar për çdo muaj dhe janë nënshkruar e vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë. Rregjistrimi në ditarin e bankës është kryer me numër rendor veprimi pa fraksione.

-Për periudhën Maj- Dhjetor 2022, me 248 urdhër-shpenzime (fillon me USH nr.120 datë 04.05.2022- mbaron me Ush nr.368 datë 30.12.2022), janë likujduar 157.469 mijë lekë, sipas artikujve buxhetor të ndara në: 600-në shumën 91.439 mijë lekë, 601-në shumën 15.258 mijë lekë, 602-në shumën 34.534 mijë lekë dhe 606-në shumën 3.976 mijë lekë, 231- në shumën 12.262 mijë lekë.

-Për vitin 2023, me 409 urdhër-shpenzime (fillon me USH nr.01 datë 04.01.2023- mbaron me Ush nr.409 datë 15.01.2024), janë likujduar 349.830 mijë lekë, sipas artikujve buxhetor të ndara në: 600-në shumën 187.165 mijë lekë, 601-në shumën 31.075 mijë lekë, 602-në shumën 51.105 mijë lekë dhe 606-në shumën 4.694 mijë lekë, 230 Projekte AQT në shumën 3.359 mijë lekë dhe 231-në shumën 72,433 mijë lekë.

-Për periudhën Janar-Qershor të vitit 2024, me 198 urdhër-shpenzime fillon me (USH nr.1 datë 03.01.2024- mbaron me Ush nr.198 datë 27.06.2024) janë likujduar 150.178 mijë lekë sipas artikujve buxhetor të ndara në: 600-në shumën 99.342 mijë lekë, 601-në shumën 16.251 mijë lekë, 602-në shumën 24.646 mijë lekë dhe 606 -në shumën 3.130 mijë lekë, 231- në shumën 6.809 mijë lekë.

Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikuese.

Likuidimi i faturave të shpenzimeve operative (energjisë elektrike, posta, uji, telefonisë fikse) është bërë pas marrjes së konfirmimit nga sektori i shërbimeve mbështetëse, faturat e postës janë konfirmuar nga protokollin, faturat e energjisë dhe ujit konfirmohen nga specialisti mbështetës.

Në likujdimet e bankës, sipas peshës specifike të shpenzimeve, janë pagat e shtesat (sigurimet shoqërore), investimi i AMP-së, shërbimet operative, shpenzimet e tjera kryesisht për prokurime me vlera të vogla dhe shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve.

-Mbi likujdimet e vendimeve gjyqësore

Për periudhën Maj 2022 deri me 30 Qershor 2024, janë likuajduar 2 vendim e gjyqesore, per vlerën totale (kohështrirje Maj-Dhjetor 2022);

-Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.217, datë 06.02.2020, në favor të kreditorit ish punonjës AMP-se znj. Anila Trimi, është likuajduar gjatë vitit 2022 në shumën 1,864,348 leke (638,116 leke ne periudhën janar-prill 2022 dhe 1,226,232 leke ne periudhën maj-dhjetor 2022).

-Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.795, datë 23.09.2020, në favor te kreditorit punonjës AMP-se z.Vasil Kalluci në shumën prej 280,987 lekë. Para likuidimit të vendimeve gjyqësore të konsiderohet pika 60 të Udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

-IV/7. Auditimi administrimit të aktiveve.

-Auditimi i pasqyrave financiare për fund vitin 2022 dhe 2023 si: bilancit, pasqyrës së shpenzimeve dhe të ardhurave, pasqyrës së lëvizjes së aktiveve të qëndrueshme, amortizimit, pasqyrave ndihmëse, librave ndihmës të kontabilitetit dhe dhënia e opinionit për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Auditimi mbi regjistrimin e ndërtesave në hipotekë, administrimi i tyre, dhe marrja në evidencë kontabile e ndërtimeve apo rikonstrukcioneve. Mbajtja e regjistrit të aktiveve. Inventarizimi i pasurisë dhe nxjerrjet nga përdorimi. Auditimi i dokumentimit të lëvizjes së mallrave e materialeve.

Agjencia e Mbykëqyrjes Policore për vitin ushtrimor 2022 ka hartuar e raportuar bilancin e veprimtarisë të shoqëruar me pasqyrat financiare, kopje të të cilave i ka dërguar shkresërisht si në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr.495/2 prot, datë 15.03.2023 dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB, me shkresën nr.495/1 prot, datë 15.03.2023.

Me lëndë: “*Dërgohen pasqyrat financiare, të vitit ushtrimor 2022*”.

Edhe për vitin ushtrimor 2023 është mbyllur bilanci financiar brenda afatit ligjor dhe kopje të tij është dërguar shkresërisht në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr.1074 prot, datë 18.03.2024 dhe në Ministrinë e Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetse, me shkrsën nr.1075 prot, datë 18.03.2023, me lëndë; “*Dërgohen pasqyrat financiare, të vitit ushtrimor 2023*”.

Pasqyrat financiare janë hartuar nga Shefi i Financës dhe njëkohësisht Shefi i Sektorit Buxhet-Financës zj.P. Hajdini, e cila plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Hartimi i bilancit dhe pasqyrave financiare që e shoqërojnë për vitet 2022 dhe 2023 është bazuar në kërkesat e ligjit nr.25/2018, “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”, në Ligjin nr.128/2022, “*Për Agjencinë e Mbykëqyrjes Policore*”, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësit e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 “*Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale si dhe të njësive që varen prej tyre*”.

Bilanci vjetor 2022 dhe 2023, është hartuar në afat dhe i shoqëruar me relacionin shpjegues (sqarime) të pozicioneve financiare sipas formatit 5, “*Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*”. Aktivitet dhe pasivet janë të paraqitura sipas strukturës së llogarive, me vlerë neto pas llogaritjes dhe zbritjes nga vlera historike e amortizimit të akumuluar dhe amortizimit vjetor të llogaritur në % referuar pikës 36 të UMF nr.8, datë 09.03.2018. Aktivitet sipas llogarive kontabile paraqiten për shumat neto, ndërsa në pasqyrën financiare të lëvizjes vjetore të aktiveve (formati 7/a “*Pasqyra e shtesave dhe pakësimeve të*

aktiveve”) paraqiten me vlerën historike të tyre sipas kërkesave të udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018. Veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore, janë të regjistruara në librat e kontabilitetit (ditarët analitikë) të mbajtura sipas planit kontabël.

Në auditimin për funksionimin e sistemit të kontabilitetit, rakordimin e vlerave të paraqitura sipas strukturës së llogarive me ato të pasqyrave financiare që shoqërojnë llogarinë vjetore 2022 dhe 2023 (pasqyra e të ardhurave/shpenzimeve, pasqyra e lëvizjes së aktiveve, pasqyra e amortizimit të tyre) si dhe rakordimit të llogarive me inventarët kontabël dhe fizik, sipas strukturës (pozicionit financiar) rezulton si më poshtë:

Referca Llogari	E M E R T I M I	Ushtrimi mbyllur 31.12.2023	Ushtrimi mbyllur 31.12.2022	Ushtrimi paraardhës 31.12.2021
A	A K T I V E T	229,512,317	165,225,656	155,425,228
	I=Aktivët afat shkurtra	25,116,098	19,570,565	18,231,032
	1-Mjetet monetare dhe ekujalentët e tyre	=	=	=
531	Mjete monetare në arkë	=	=	=
520	Disonibilitete në Thesar	=	=	=
	2-Gjendje Inventari Qarkullues	3,384,637	3,051,487	2,019,441
31	Materiale	=	=	=
32	Inventari i imët	3,384,637	3,051,487	2,019,441
	3-Llogari të arkëtueshme	21,731,461	16,519,078	16,211,591
411	Kliente e llogari të ngjashme	=	1,334,751	=
423,429	Personeli, paradhënie, defiçite gjoba	20,010,329	13,631,480	14,559,573
468	Debitorë të ndryshëm	1,191,994	1,323,275	582,969
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	529,138	229,572	1,069,049
	II=Aktive Afatgjata	204,396,219	145,655,091	137,194,196
	a-Aktive Afatgjata jo materiale	12,937,032	12,770,414	17,501,219
203	Koncensione, Pate, Liçenca e të ngjashme	12,937,032	12,770,414	17,501,219
	b-Aktive Afatgjata materiale	191,459,187	132,884,677	119,692,977
212	Ndërtesa e Konstruksione	83,076,206	61,633,091	64,876,938
215	Mjete Transporti	27,111,433	23,557,887	15,423,311
218	Inventar Ekonomik	81,271,548	47,693,699	39,392,728
	c-Investime	=	=	=
230	Për Aktivët Afat gjata jo materiale	=	=	=
231	Për Aktivët Afat gjata materiale	=	=	=
B	P A S I V E T (Detyrimet)	22,937,700	16,519,078	16,988,802
	I=Detyrimet/Pasivet afatshkurtra:	22,937,700	16,519,078	16,988,802
	a-Llogari të pagueshme	21,745,706	15,195,803	16,405,833
401,408	Furnitorë e llogari të lidhura me to.	=	=	=
42	Detyrime ndaj personelit	13,056,467	9,254,714	7,672,548
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,564,848	975,894	3,118,691
435	Sigurime Shoqërore	4,822,770	3,020,421	3,346,377
436	Sigurime Shëndetsore	566,244	380,451	421,957
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	1,206,239	=	777,211
467	Kreditorë të ndryshëm	=	1,334,751	=
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	529,138	229,572	1,069,049
	II-Të tjera Pasive afatshkurtra	1,191,994	1,323,275	582,969
475	Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse	1,191,994	1,323,275	582,969
C	AKTIVET NETO/FONDET(A-B)	206,574,617	148,706,578	138,436,426
D	Fondi Konsoliduar:	206574,617	148,706,578	138,436,426
101	Teprica (Fondi akumuluar) Defiçit akumuluar			
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore			

105	Teprica e Granteve Kapitale të Brendshme	207,780,856	146,859,406	139,213,637
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim	-1,206,239	1,847,171	-777,211
E	Totali i Pasiveve (B+C)	229,512,317	165,225,656	155,425,228

Referuar të dhënave të mbydhjes së vitit ushtrimor 2022 dhe 2023 situata paraqitet si më poshtë: Totali i aktivitetit të bilancit në fund vitin 2022 paraqitet në shumën 165,225,656 lekë (aktive afatëgjata materiale 145,655,091 dhe aktive afatë shkurtra 19,570,565), dhe në fund të 2023 me shumën 229,512,317 lekë, shumë e cila përbëhet nga 25,116,098 lekë “Aktive afat shkurtra” dhe 204,396,219 lekë “Aktive Afat Gjata” (llogaritë e klasës 2). Në krahasim me aktivet gjendje në fund vitin 2021, rezulton se në mbyllje të viti ushtrimor 2022 kemi shtesë të aktiveve në shumën 9,800,428 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2023 kemi një shtesë prej 74,087,089 lekë në krahasim me vitin 2021.

Analiza, dinamika dhe vlerat e aktiveve të cilat sipas klasifikimit dhe llogarive koresponduese (në aktiv të bilancit klasat 3,4 dhe 2) të analizuar rezultojnë si më poshtë:

Grupi i aktiveve afat shkurtra: Aktivet afat shkurtra përbëhen nga “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre”, nga “Gjendja e inventari qarkullues” dhe nga “Gjendja e Llogarive të arkëtueshme”.

1-Zëri “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” rezulton me gjendje zero për vitin 2021, 2022 dhe për vitin 2023, u konstatua se gjendja që rezulton në fund të vitit në arkë zerohet, derdhet në bankë. “Aktivet qarkulluese” (klasa 3), për shumën 3,051,487 lekë në fund të 2022 dhe 3,384,637 lekë në fund të vitit 2023 dhe “Llogaritë e arkëtueshme” (klasa 4), për shumën 16,519,078 lekë në fund të vitit 2022 dhe 21,731,461 lekë në fund të vitit 2023, të analizuar në vijimë sipas llogarive analitike si më poshtë vijon:

2-Gjendje Inventari Qarkullues.

-Llogaria 31 dhe 32 Klasa 3 “Inventar i imët dhe materiale”, Gjendja e inventarit qarkullues, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerën 3,051,487 lekë, nga 2,019,441 lekë në 31.12.2021 me një ndryshim (shtesë) për 1,032,046 lekë, dhe në fund të vitit 2023 rezulton me shumën 3,384,637 lekë ose më shumë se në 2021 për 1,365,196 e cila përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit të imët gjendje në institucion në fund vitin 2022 dhe 2023. Ky ndryshim përfaqëson blerjet gjatë vitit ushtrimor të realizuar për artikujt e inventarit të imët, minus nxjerrjet jashtë përdorimit.

Kjo shtesë përfaqëson vetëm lëvizjen debitore të llogarisë 32 “Inventari i imët”, pasi llogaria,31 “Materiale” rezulton me gjendje zero në fund të vitit 2021, 2022 dhe në fund të vitit 2023.

3-Llogari të Arkëtueshme. Në klasën 4, “Llogari të arkëtueshme” ku përfshihen llogaritë:

-Llogaria 411 “Klient e llogari të ngjashme”, llogari e cila në fund të vitit 2021 është me gjendje zero në fund të vitit 2022 rezulton me gjendje 1,334,751 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimin ndaj Institutit të Ndërtimit për 1,175,222 lekë dhe 159,529 lekë, detyrim i krijuar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë për zj. A Trimi, dhe në mbyllje të vitit 2023 është zero.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në Pasiv të bilancit;Llogari koresponduese e llogarisë 411 “Klient e llogari të ngjashme”, paraqitet në shumën prej 1,334,751 lekë. Kjo shumë përfaqëson detyrimin e krijuar në vitin 2022 ndaj Institutit të Ndërtimit në vlerën 1,175,222 lekë, për mbulimin e shpenzimit “Hartimi i projekt preventiv për shtesë kati godine AMP”. Likujdimi i detyrimit nuk është realizuar për faktin se në sistemin e Thesarit është çelur fondi i nevojshëm por me kod të gabuar. Për këtë arsye Dega e Thesarit nuk ka kryer likujdimin e shumës në fjalë, duke rezultuar me fond të parealizuar dhe detyrim të krijuar rishtazi që mbartet në vitin në vazhdim.

Ndërsa diferenca prej 159,529 lekë është detyrimi ndaj kreditorit zj.A Trimi (krijuar me vendim gjyqësor të formës së prerë).

-Llogaria 423/429 "Personeli, paradhënie, deficiëte dhe gjoba", në fund të vitit 2021 është me gjendje 14,559,573, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 rezulton me vlerën 13,631,480 lekë, dhe në fund të vitit 2023 rezulton me 20,010,329 lekë, po të shikojmë evolucionin e kësaj llogarie shohim se ka një ndryshim të madh në vitin 2023 në krahasim me vitin 2021, ka një rritje prej 5,450,756 lekë, dhe në krahasim me 2022 rritja është për 6,378,849 lekë. Kjo rritje kosiston në ndryshimin e strukturës së AMP si dhe rritjen e pagave në vitin 2022 dhe 2023.

Ky pasqyrim i kësaj llogarie është i gabuar pasi këto shuma që janë pasqyruar në këtë llogari duhet të pasqyrohen në llogarin 4342, "*Operacione me shtetin (Të drejta)*", pasi përfaqsojnë detyrimet e institucionit ndaj punonjësve për pagat e muajit Dhjetor, tatim page, sigurime shoqërore dhe shëndetsore, kundrapartia e saj në pasiv të bilancit janë shumat e llogarive, 42 "*Detyrime ndaj Personelit*" e cila përfaqson pagat e punonjësve të muajit Dhjetor, për 9,254,714 për vitin 2022 dhe 13,056,467 për vitin 2023, llog, 431 "*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*", 975,894 lekë për 2022 dhe 1,564,848 për 2023, llog, 435 "*Sigurime Shoqërore*", për 3,020,421 lekë për 2022 dhe 4,822,770 për 2023, dhe llog, 436 "*Sigurime Shëndetsore*", për 380,451 në vitin 2022 dhe 566,244 lekë në vitin 2023, llogari këto në pasiv të bilancit.

-Llog.4342, "Operacione me Shtetin (të drejta)", në aktiv të bilancit me llogari korosponduese llogarinë, 4341, "*Operacione me Shtetin (detyrime)*", në pasiv të bilancit kontabël përfaqson detyrime e institucionit ndaj OE për shërbimet e ofruara për faturat e muajit Dhjetor, të cilat përbëhen nga; për vitin 2022 shuma 229,572 lekë, (*Energji elektrike 197,572 lekë, fatura e ujit për 5,952 lekë, shpenzime telefonie për 15,115 lekë, korrier për 6,047 lekë dhe për shpenzime taxave për 5,294 lekë*). Për vitin 2023 për shumën 529,138 lekë, (*Energji elektrike 180,028 lekë, fatura e ujit për 4,116 lekë, shpenzime telefonie për 14,580 lekë, korrier për 9,220 lekë, shërbime bankare 300 lekë, për shpenzime taxave për 5,294 lekë, shpenzime për internet për 15,600 lekë dhe shpenzime për tërheqjen e limit të arkës për shumën 300,000 lekë*).

Ky pozicionim i këtyre llogarive është i gabuar, pasi duhet që vlera kreditore e llogarisë 4341, "*Operacione me Shtetin (detyrime)*", në pasiv të bilancit duhet të jetë e barabart me gjendjen debitorë të llogarisë 468 "*Debitor të ndryshëm*", dhe shumën e llogarisë 423,429 "*Personeli, paradhënie, deficiëte dhe gjoba*", në aktiv të bilancit, pasi përfaqsojnë të ardhura të cilët do të vilen nga punonjësit debitor dhe do të derdhen në buxhet.

-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në fund të vitit 2022 me gjendje zero dhe në mbyllje të vitit 2023 rezulton me gjendje për shumën 1,206,239 lekë. Kjo shumë prej 1,206,239 lekë, përfaqson 5% të vlerës së punimeve si garanci punimesh e OE që po realizon punimet e ndërtimit për shtesën e katit të godinës së AMP (projekt i shtrirë në vitin 2023-2024).

-Llog.468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2021 është 582,969 lekë, në fund të vitit 2022 me vlerën 1,323,275 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me vlerën 1,191,994 lekë. Kjo vlerë përfaqëson debitorët e krijuar nga auditimi i ushtruar nga Drejtoria e Auditit, gjatë viteve 2016-2022 ku është konstatuar se është përfituar, në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, shuma prej 1,421,313 lekë, nga të cilat deri në fund të vitit 2022 janë arkëtuar 98,038 lekë, pjesërisht nëpërmjet bankës dhe mbajtjes në pagën mujore (konfirmuar me shkrim nga vetë debitori). U konstatua se të gjithë debitorët janë vënë në dijeni për detyrimin që u ka lindur ndaj institucionit AMP-së dhe nuk kanë shprehur vullnet të lirë për likuidim, po ndiqen rrugët gjyqësore. Përfitues të shumës janë 12 punonjës dhe ishpunonjës të SHÇBA/AMP, që e kanë përfituar si trajtim me pagë në kundërshtim me aktet ligjore, kompensim me pagesë për orët e kryera jashtë orarit zyrtar të punës, dieta brënda dhe jashtë vendit për vitin 2013, jo në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht punonjësit përfitues dhe shumat e përfituara janë:

1-Altin Morina, ish punonjes, debitor në vlerën 47,405 lekë. Përfiturar në vitin 2011 si kompensim për orë jashtë orarit zyrtar. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë arkëtim.

2-Ardi Venetiku, ish punonjes, debitor në vlerën 64,456 lekë. Përfiturar në vitin 2011 si kompensim për orë jashtë orarit zyrtar. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë arkëtim.

3-Oltion Recci, ish punonjes, debitor në vlerën 52,146 lekë. Përfiturar në vitin 2011 si kompensim për orë jashtë orarit zyrtar. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë arkëtim.

4-Vladimir Rumnici ish punonjes, debitor në vlerën 58,555 lekë. Përfiturar në vitin 2015 si pagesë kalimtare ndërkohë është në marrdhënie pune në SHISH. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë arkëtim.

5-Veap Aga ish punonjes, debitor në vlerën 20,592 lekë. Përfiturar në vitin 2012 për dieta jashtë vendit. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë për arkëtim.

6-Klodiana Zebi ish punonjes, debitor në vlerën 5,500 lekë. Përfiturar në vitin 2012 për dieta jashtë vendit. Është njoftuar për shlyerje detyrimi në formë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit, aktualisht pa shpresë për arkëtim.

7-Fadil Zenelaj ish punonjes, debitor në vlerën 41,281 lekë. Përfiturar në vitin 2012 për dieta brenda vendit. Ka shlyer detyrimin në vitin 2023.

8-Ariada Girengir, ish punonjes debitor për vlerën 221,484 lekë. Deklaruar debitor me urdhër titullari për zhdëmtim (*humbje pajisje*). Është njoftuar për shlyerje detyrimi në mënyrë vullnetare, duke qënë se ka refuzuar është ndjekur procedura ligjore në shkallët e gjyqësorit. Me shpresë për arkëtim.

9-Klevis Qose ish punonjes, debitor për vlerën 71,550 lekë. Deklaruar debitor me urdhër titullari për zhdëmtim (*humbje arme*). Ka likujtuar detyrimin në formë vullnetare gjatë vitit 2022.

10-Arben Caka, deklaruar debitor për trajtim me pagë në kundërshtim me ligjin. Ka pranuar detyrimin, të cilin e ka shlyer në formë vullnetare gjatë vitit 2022.

11-Albert Ismaili, në zbatim të raportit të Auditit, është deklaruar debitor për trajtimin me pagë në kundërshtim me ligjin si dhe dëmtim/humbje të vlerave materiale në ngarkim, për vlerën totale 607,856 lekë. Është njoftuar dhe nuk është përgjigjur për likujdim vullnetar të detyrimit. Vjelja e detyrimit po ndiqet duke respektuar procedurën ligjore në shkallët e gjyqësorit. Me shpresë për arkëtim.

12-Albert Ismaili, në zbatim të raportit të Auditit, është deklaruar debitor për trajtimin me pagë në kundërshtim me ligjin, për vlerën 204,000 lekë. Është njoftuar personi, nuk ka pranuar likujdimin vullnetar të detyrimit. Për vjeljen e detyrimit po ndiqen rrugët gjyqësore. Me shpresë për arkëtim.

Shuma e kësaj llogarie korospondon me llogarin 475, “Të ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse”, e pozicionuar në pasiv të bilancit kontabël. Pozicionimi është i gabuar duhet të pozicionohej në llogarin 4341, “Operacione me shtetin (*detyrime*)”, në kredi po në pasiv të bilancit.

B-Grupi i aktiveve afat gjata materiale (AOT), janë të klasifikuara dhe kontabilizuara në klasën dy të bilancit kontabël, “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara” dhe në total janë me vlerën 191,459,187 lekë në fund të vitit 2023, në vitin 2022 kanë qënë 132,884,677 lekë dhe në vitin 2021 ka patur vlerën 119,692,977 lekë vlerë neto të pasqyruara si më poshtë:

Në fund të vitit 2023 Në vitin 2022 Në fund të 2021

21	2.Aktive Afatgjata materiale	191,459,187	132,884,677	119,692,977
----	-------------------------------------	--------------------	--------------------	--------------------

212	Ndërtesa e Konstruksione	83,076,206	61,633,091	64,876,938
215	Mjete transporti	27,111,433	23,557,887	15,423,311
218	Inventar ekonomik	81,271,548	47,693,699	39,392,728

Nisur nga të dhënat e mësipërme (të raportuara në bilancin 2022 dhe 2023), AQT në krahasim me fund vitin 2021 janë shtuar në vitin 2022 për 13,191,700 lekë dhe për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 janë shtuar për 58,574,510 lekë. Rritja kosiston në tre zërat e aktiveve që disponon institucioni i AMP.

Në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione”, nuk ka rritje të aktiveve por ka pakësim vetëm për amortizimin e llogaritur për 3,243,847 lekë, ndërsa në 2023 në krahasim me 2022 ka një shtesë për 21,443,115 lekë, kjo shtesë ka ardhur, si rezultat i kalimit të shumës së likujduar me dy situacione të OE ‘2N’ shpk, i cili ka rezultuar fitues për investimin “Përforcim i godinës dhe shtesë kati i godinës së AMP, sipas kontratës nr.2695 datë 25.08.2023”, si dhe duke zbritur shumën e amortizimit të përlllogaritur për shumën 3,081,655 lekë. Kjo shumë e likujdimit të dy situacioneve nuk duhet të kishte kaluar në llogarin 212 por duhet të ishte pasqyruar në llogarin 231 “Shpenzime për investime”, pasi situacionet janë pjesore dhe duhet të pasqyroheshin në llogarin 231, vetëm atëhere pasi të përfundojë investimi dhe të merret në dorëzim objekti atëhere duhet të pasqyrohet në llogarinë 212, shtesë të AQT.

Llog, 215 “Mjete transporti”, ka rritje në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 për 8,134,576 lekë dhe në 2023 në krahasim me 2022 për 3,553,546 lekë, kjo shtesë ka ardhur, si rezultat i transferimit në vitin 2022 i dy mjeteve nga AAPSK, dhe një mjeti nga DPPSH, dhe në vitin 2023 i transferimit të dy mjeteve nga AAPSK, si dhe i përlllogarijes së amortizimit. Në vitin 2024 AMP ka marr edhe dy mjete nga AAPSK, trajtuar hollësisht në pikën VIII, llogaria materiale shërbimi transportit.

Llog, 218 “Inventar ekonomik”, ka rritje në 2023 në krahasim me 2022 për 33,577,849 lekë, kjo shtesë ka ardhur si rezultat i blerjeve gjatë vitit si dhe duke zbritur nxjerrjet jashtë përdorimit.

Nga auditimi i mbylljes pasqyrave financiare/bilancit për vitin ushtrimor 2022 dhe 2023, u konstatua se përgjithsisht pasqyrohet me vërtetsi situata financiare e institucionit të AMP. Nga auditimi u konstatuan disa mangësi në pozicionimin e llogarive financiare në bilancin kontabël por pa cënuar vërtetsinë e shifrave që bartin pasqyrat financiare.

Konkretisht; -llogaria 423,429, “Personeli, paradhënie, defiqite gjoba”, për shumën 20,010,329 lekë dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” për shumën 1,191,994 lekë në debi, (në aktiv të bilancit) duhet të jenë të barabarta me kundra parti në pasiv të bilancit në kredi të llogarisë 4341, “Operacione me shtetin, (detyrime)”, pasi këto shuma përfaqsojnë detyrimet të cilët pasi të vilen derdhen në buxhetin e shtetit. Në fakt pazicionimi i shumës 20,010,329 lekë në llogarin 423,429, është i gabuar pasi kjo shumë duhet të pasqyrohej tek llogaria 4342, “Operacione me shtetitn (të drejta)”, pasi kjo shumë përfaqson detyrimet e institucionit për pagat e punonjësve për muajin Dhjetor, dhe që është e barabartë me shumën në pasiv të bilancit të llogarive 42, “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim e taksa”, 435 “Sigurimet shoqërore”, dhe 436, “Sigurimet shëndetsore”.

-Llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”, në pasiv të bilancit e cila është pasqyruar me vlerën kreditore për 229,572 lekë në vitin 2022 dhe 529,138 lekë në vitin 2023, pozicionimi është i gabuar pasi këto vlera duhet të pasqyroheshin po në pasiv të bilancit, por në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi shumat analitike që këto përfaqsojnë janë detyrimet e institucionit kundrejt OE për faturat e pa paguara të muajit Dhjetor.

-Gjendja debitore e llogarisë 423,429 “*Personeli, paradhënie, defiçite gjoba*”, plus llogarinë 468 “*Debitor të ndryshëm*”, në aktiv të bilancit duhet të jënë të barabarta me gjendjen kreditore të llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”, në pasiv të bilancit. Në fakt në debi të llogarisë 423,429 është pasqyruar gabimishtë shuma 20,010,329 lekë, e cila i përket llogarisë 4342 “*Operacione me shtetitn (të drejta)*”, trajtuar më sipër. Pozicionuar gabim edhe shuma 1,191,994 lekë në pasiv të bilancit në kredi të llogarisë 475 “*Të ardhura për t’u regjistruar*”, pasi kjo shumë duhet të pozicionohet në kredi të llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”.

-Të klasifikohen sipas planit kontabël llogarit e materialeve dhe inventarit të imët, llogaria 31 “*Materiale*” dhe 32 “*Inventari*”. U konstatua se llogaria e materialeve për shërbimin e armatimit administrohet vetëm në sasi dhe jo në vlerë, kjo në mospërputhje me ligjin për kontabilitetin, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik*”, trajtuar në rubrikën shërbimi i armatimit.

-Likujdimi i situacioneve pjesore të investimit për shtesë kati në godinën e AMP janë pasqyruar në bilancin kontabël në llogarin 212, (*Ndërtesa e Konstruksione*), kontabilizim i gabuar, duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 231, (*Investime, Për aktivet afatëgjata materiale*), dhe me përfundimin e investimit, me akt-marrjen në dorëzim të objektit, atëherë kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 212 (*Ndërtesa e Konstruksione*) për vlerën e plotë të investimit shtohet kjo llogari dhe mbyllet llogaria 231 për vlerën e plotë të investimit.

Gjetje: Mospozicionim korrekt sipas standarteve kombëtare të kontabilitetit të miratuara i disa llogarive financiare në mbyllje të bilancit të vitit 2022 dhe 2023.

Nr. Gjetjes 5	
Subjekti i audituar	Agjensia e Mbikëqyrjes Policore.
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat Menaxheriale të AMP, Ministria e Brendshme.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.25/2018, “ <i>Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare</i> ”, Ligji nr.128/2022, “ <i>Për Agjencinë e Mbykëqyrjes Policore</i> ”, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018, “ <i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësit e qeverisjes së përgjithshme</i> ”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga auditimi i mbylljes pasqyrave financiare/bilancit për vitin ushtrimor 2022 dhe 2023, u konstatua se situata financiare e institucionit të AMP pasqyrohet me vërtetësi. Nga auditimi u konstatuan disa mangësi në pozicionimin e llogarive financiare në bilancin kontabël por pa cënuar vërtetësinë e shifrave që bartin pasqyrat financiare, konkretisht: -Llogaria 423,429, “ <i>Personeli, paradhënie, defiçite gjoba</i> ”, në vitin 2023 rezulton me shumën 20,010,329 lekë, pozicionimi i kësaj shume në këtë llogari është bërë i gabuar, pasi kjo vlerë përfaqëson detyrimet e institucionit për pagat e punonjësve për muajin Dhjetor dhe duhet që në pasqyrën e aktivitetit të paraqitet në llogarinë 4342, “ <i>Operacione me shtetitn (të drejta)</i> ”, që është e barabartë me shumën në pasiv të bilancit të llogarive 42, “ <i>Detyrime ndaj personelit</i> ”, 431 “ <i>Detyrime ndaj shtetit për tatim e taksa</i> ”, 435 “ <i>Sigurimet shoqërore</i> ”, dhe 436 “ <i>Sigurimet shëndetsore</i> ”.

	<p>-Llogaria 468 “<i>Debitor të ndryshëm</i>” me shumën 1,191,994 lekë, kjo shumë është pozicionuar gabim në pasiv të bilancit në llogarinë 475 “<i>Të ardhura për t’u regjistruar</i>”, ndërkohë kjo shumë duhet të pozicionohej në kredi të llogarisë 4341 “<i>Operacione me shtetin (detyrime)</i>”.</p> <p>-Gjendja debitore e llogarisë 423,429 “<i>Personeli, paradhënie, defiçite gjoba</i>”, plus llogarinë 468 “<i>Debitor të ndryshëm</i>”, në aktiv të bilancit duhet të jënë të barabarta me gjendjen kreditore të llogarisë 4341 “<i>Operacione me shtetin (detyrime)</i>”, në pasiv të bilancit.</p> <p>Llogaria 4341, “<i>Operacione me shtetin (detyrime)</i>”, në pasiv të bilancit ka pasqyruar për vitin 2022 vlera 229,572 lekë dhe për vitin 2023 vlera 529,138 lekë këto vlera duhet të pasqyroheshin po në pasiv të bilancit, por në kredi të llogarisë 467 “<i>Kreditorë të ndryshëm</i>”, sepse shumat analitike që përfaqësojnë janë detyrimet e institucionit kundrejt OE për faturat e pa paguara të muajit Dhjetor.</p> <p>-Nuk ishin klasifikuar sipas planit kontabël llogaritë 31 “<i>Materiale</i>” dhe 32 “<i>Inventari i imët</i>”.</p> <p>-Likujdimi i situacioneve pjesore të investimit për shtesë kati në godinën e AMP janë pasqyruar në bilancin kontabël në llogarin 212, (<i>Ndërtesa e Konstruksione</i>), kontabilizim i gabuar, duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 231, (<i>Investime, Për aktivet afat gjata materiale</i>), deri në përfundim të investimit, me akt marrjen në dorëzim të objektit.</p> <p>Kriteri: Ligji nr.25/2018, “<i>Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare</i>”, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018, “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësit e qeverisjes së përgjithshme</i>”, i ndryshuar,</p> <p>Ndikimi/Efekti: Impakti i këtij veprimi është se nuk pasqyrohen saktë në bilancin vjetor të Institucionit vlerat e llogarive financiare sipas klasifikimit kontabël të tyre, dhe pozicioneve përkatëse në pasqyrat financiare.</p> <p>Shkaku: Mosfunksionim sa dhe si duhet i kontrollit të brendshëm nga strukturat përgjegjëse për dokumentimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe hartimin e pasqyrave financiare.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I Mesëm
Konkluzioni	Mosfunksionim në nivelin e duhur i kontrollit të brendshëm, në organizimin dhe mbylljen e llogarisë vjetore.
Rekomandimi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori i financës, të marrin masat e duhura për sistemimin, pozicionimin dhe kontabilizimin e veprimeve në llogaritë përkatëse në bilancin kontabël të vitit 2024, duke zbatuar planin kontabël dhe standardet të miratura të kontabilitetit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimsi dhe në bilancin e fund vitit 2024 të pozicionohen vlerat përkatëse në postet sipas klasifikimit kontabël për mbylljen e pasqyrave financiare.

Statusi i rekomandimit	
------------------------	--

Mbajtja e regjistrit të aktiveve.

U auditua mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet dhe u konstatua se nga ana e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse ishte hapur regjistri i aktiveve për asetet dhe për objektet ndërtimore pronë e institucionit AMP-së në të cilin është regjistruar: Numri dokumentit dhe data e hyrjes së aktivit, përshkrimi i aktivit (lloji i aktivit), vlera fillestare e aktivit, data e hyrjes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën e aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, amortizimi vjetor, vlera e akumuluar e amortizimit të aktivit, vlera e mbetur e aktivit dhe personi përgjegjës material. Në këtë regjistër jepen të dhënat e kërkuara sipas kapitullit III, pika 30, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Totali aktiveve dhe pasiveve të pasqyrës financiare në mbyllje të veprimtarisë më 31.12.2023 është 229,512,317 lekë, në mbyllje të vitit 2022 me 31.12.2022, është 165,225,655 lekë nga 155,425,228 lekë që ka qënë në 31.12.2021, shumat janë të barabarta me shumat e aktivit dhe pasivit të bilancit për periudhat respektive.

-Auditimi i inventarëve të aktiveve të Qëndrueshme e Qarkulluese.

Në zbatim të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe udhëzimit të MB nr.226 datë 08.05.2015, “Për përcaktimin e përgjegjësisë në menaxhimin e aktiveve”, është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë për të dyja periudhat 2022 dhe 2023.

Në auditimin e dokumentacionit për kryerjen e inventarizimeve periodike e vjetore të pasurisë, metodave të vlerësimit dhe kryerjes së inventarëve si dhe masat e marra për ruajtjen e aktiveve rezultoi se, për fund vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023 me urdhër të titullarit nr.563, datë 13.12.2022, është urdhëruar ngritja e komisionit “Për inventarizimin fizik të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, si dhe me urdhër nr.78 datë 23.01.2022, është urdhëruar ngritja e komisionit “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të aktiveve”, dhe me urdhër nr.73 datë 21.04.2022, është urdhëruar “Për ngritjen e komisionit të azgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese për vitin 2021”, komisioni është konformë parashikimit ligjor me pesë anëtarë.

Dhe për vitin 2023 me urdhërin nr.792 datë 13.11.2023, është urdhëruar ngritja e komisioneve përkatëse, “Për inventarizimin fizik të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, si dhe me urdhër të brendshëm të titullarit të njësisë nr.159 datë 24.10.2023 është urdhëruar ngritja e komisionit “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”.

- Auditimi i dokumentacionit kontabël dhe procesit të inventarizimit fizik të aktiveve të institucionit për vitin 2022 dhe 2023; Nga ana e sektorit të financës dokumentacioni i kontabilitetit, regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj), mbaheshin në format elektronik (exel), për të cilat nuk kishte gjurmë të nënshkrimit dhe arkivimit në sekretarinë e institucionit, me impakt në mosvlerësimin e rrishtit për humbjen e të dhënave dhe gjurmimin e veprime të kryera në mënyrë kronologjike dhe sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Dokumentacioni i administruar nga specialistja e financës e ngarkuar për mbajtjen e inventarëve, vlerave monetare dhe kontabilizimin e veprimeve, nuk paraqet siguri të arsyeshme pasi ky dokumentacion mbahej në format elektronik (exel), i cili nuk ishte i printuar e i nënshkruar dhe as i arkivuar për periudhat e audituara, me impakt në regjistrimin e veprimeve kronologjike dhe

sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë etj.

-Mungonte gjurma e rakordimit periodik midis specialistit të financës dhe magazinierit në partitarët aktiveve.

-Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, nuk është dokumentuar dhe rakorduar saktësisht, sektori i financës nuk ka kryer përpara procesit të inventarizimit fizik, rakordimin dhe dokumentimin me procesverbal të llogarive të aktiveve materiale, me gjendjen në magazinë dhe librave kontabël të financës. Komisionet e inventarizimit fizik për asetet në administrim nga institucioni ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve duke dokumentuar procesin e inventarizimit bazuar në fletë inventarët kontabël të llogarisë të nxjerra e nënshkruara nga specialisti i financës.

-Komisioni i inventarizimit për vitin 2023 kishte konstatuar në 9 raste me PV, teprica dhe mungesa të aktiveve si dhe parregullsi në administrimin dhe dokumentimin e aktiveve në përdorim të punonjësve në Drejtoritë Rajonale por këto nuk dokumentoheshin me proces verbal rakordimi përfundimtar, ku të pasqyrohej gjendja mes inventarve fizik dhe gjendjes kontabël, për rrjedhojë nuk saktësohet sistemimi i aktiveve që kanë në përdorim punonjësit, ku të kryheshin dhe të kontabilizoheshin diferencat eventuale (nëse ka).

Në raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik nuk kanë rezultuar diferenca dhe teprica, për rrjedhojë sistemimi konstatimeve të mësipërme rezulton të jetë bërë extra kontabël.

-Me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 *“Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”*, janë nxjerrë nga përdorimi 2 (Dy) Motoçikleta të cilët nuk figuronin në inventarët e institucionit, pamvarsisht se ishin pronë e institucionit.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* përgjegjësi e nëpunësit zbatues dhe sektorit të financës.

Konkretisht; Komisionet e inventarizimit (të përcaktuara në urdhërin e titullarit) për asetet në administrim nga institucioni ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve duke dokumentuar procesin e inventarizimit bazuar në fletë inventarët kontabël të llogarisë të nxjerra e nënshkruara nga specialisti i financës sipas librave analitik të llogarisë materiale.

Inventarizimi është kryer për llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” 214 “Instalime, pajisje e instrumente”, 215 “Mjete transporti”, 218 “Inventar ekonomik”, 31 “Materiale dhe 32 “Inventari i imët”.

Komisionet e inventarizimit në përfundim të procesit kanë përpiluar të plotë dokumentacionin e kryerjes së procesit të inventarëve fizik duke i nënshkruar fletë inventarët si nga komisioni dhe nga përgjegjësit material.

Në përfundim të procesit është hartuar për titullarin e kësaj njësie edhe relacioni përkatës sipas shërbimeve për rezultatet e inventarizimit. Me shkresën nr.83 prot, datë 11.01.2023, lënda “Raport mbi inventarizimin fizik të aktiveve, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Rajonale të AMP-së”, drejtuar Drejtorit të përgjithshëm të AMP-së, komisioni i inventarizimit ka informuar titullarin mbi gjendjen e aktiveve ku në kolonën statusi aktual ka sugjeruar aktivet që nuk janë në gjendje pune dhe ka rekomanduar ngritjen e një komisioni për vlerësimin e tyre.

Nga auditimi i inventarëve dhe procesit të inventarizimit u konstatua se: Nuk kishte një rakordim të mirëfillt nga specialisti i financës midis gjendjes konabile dhe gjendjes faktike/fizike, ku të kryheshin dhe të kontabilizoheshin diferencat eventuale. Komisioni i inventarizimit kishte konstatuar në 9 raste teprica dhe mungesa të aktiveve si dhe parregullsi në administrimin dhe dokumentimin e aktiveve në përdorim të punonjësve në drejtorit rajonale. Për këto problematika komisioni i inventarizimit kishte mbajtur proces verbalet përkatëse: Procesverbal, nr.1 datë

30.11.2023 në drejtorinë rajonale të Tiranës (për mospasqyrim të kompjuterit, monitorit tipi Fujitsu P510, çmim 74,279 lekë, pasi nuk i është pasqyruar në kartel punonjësit S.Caka).PV nr.2 datë 03.12.2023 drejtoria rajonale Durrës-Kavajë, (Materiale të cilët rezultuan tepër, një Kasafort, veprime që duhet të verifikohen nga magazina dhe sektori i financës, për një kompjuter HP 4CEO 172T71 çmimi 60,700 lekë pasi është dorëzuar nga punonjësi A.Caushaj, vula zyrtare një copë dhe vulë Sekretarie një copë me çmim 1,800 lekë/copa, nuk janë në përdorim nga punonjësi R.Zeqiri).PV nr.4 datë 04.12.2023, drejtoria rajonale Vlorë-Gjirokastrë, (Një kompjuter me çmim 78,388 lekë pasi nuk është në përdorim nga punonjësi S.Ndreu).PV nr.5 datë 06.12.2023, drejtoria rajonale Elbasan-Korçë, veprime që duhet të verifikohen nga magazina dhe sektori i financës për aktivin; (Grirse letre copë një çmimi 5,020 lekë, kompjuter Dell N/S-KRCYJ3 copë 1 (një) çmimi 76,900 lekë, dhe monitor Dell N/S-JCRJ5C3 copë 1 (një) çmimi 15,900 lekë, pasi këto materiale nuk janë në përdorim nga punonjësi R.Haskaj. PV nr.8 datë 14&15.12.2023, mbajtur në Drejtorinë e përgjithshme ku konstatohet se; Materiale të cilët sipas verifikimit rezultojnë tepër, portret një copë. Gjatë inventarizimit u evidentuan edhe materiale që rezultojnë edhe në librat kontabël edhe fizikisht, por gjatë transferimit të punonjësve nuk janë kryer procedurat e marrjes dhe dhënies në dorëzim të materialeve, në këtë pv janë 8 artikuj.Edhe në pv nr.9 datë 18.12.2023, janë konstatua pasaktësi për 4 artikuj.

Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 81,82,83,84,85 gërma, a,b,c dhe pika 86, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”, janë nxjerr nga përdorimi 2 (Dy) Motoçikleta, tipi Skuter Loncin me nr.shasie LLPTCKP45B1616177 dhe LLPTCKA04BA187004, pa targa. U konstatua se motoçikletat të cilët janë dërguar për miratim në Ministri për nxjerrjen nga përdorimi si aktive të dëmtuara dhe të pa përdorshme, këto aktive nuk figuronin në inventarët e institucionit, këto aktive ishin blerë nga institucioni, por nga verifikimi i inventarve këto nuk figuronin në kontabilitet. Dy motoçikletat janë shkarkuar nga kontabiliteti me fd, nr.3 datë 15.11.2023

Titulli i Gjetjes. Mangësi e administrimit të dokumentacionit kontabël dhe të procesit të inventarizimit fizik dhe rakordimit të gjendjes së aktiveve për vitin 2022 dhe 2023.

Nr. Gjetjes 6	
Subjekti i audituar	Agjensia e Mbikëqyrjes Policore.
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat menaxhuese për funksionimin e Institucionit AMP dhe Ministria e Brendshme.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi MF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga ana e sektorit të financës administrimi i dokumentacionit kontabël, regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj), mbaheshin në format elektronik (excel), për të cilat nuk kishte gjurmë të nënshkrimit dhe arkivimit në sekretarinë e institucionit, me impakt në mosvlerësimin e rrishtit për humbjen e të dhënave dhe

gjurmimin e veprime të kryera në mënyrë kronologjike dhe sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Dokumentacioni i administruar nga specialistja e financës e ngarkuar për mbajtjen e inventarëve, vlerave monetare dhe kontabilizimin e veprimeve, nuk paraqet siguri të arsyeshme pasi ky dokumentacion mbahej në format elektronik (excel), i cili nuk ishte i printuar e i nënshkruar dhe as i arkivuar për periudhat e audituara, me impakt në regjistrimin e veprimeve kronologjike dhe sistematike të marra nga dokumentet vërtetuese, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë etj.

-Mungonte gjurma e rakordimit periodik midis specialistit të financës dhe magazinierit në partitarët aktiveve.

-Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, nuk është dokumentuar dhe rakorduar saktësisht, sektori i financës nuk ka kryer përpara procesit të inventarizimit fizik, rakordimin dhe dokumentimin me procesverbal të llogarive të aktiveve materiale, me gjendjen në magazinë dhe librave kontabël të financës. Komisionet e inventarizimit fizik për asetet në administrim nga institucioni ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve duke dokumentuar procesin e inventarizimit bazuar në fletë inventarët kontabël të llogarisë të nxjerra e nënshkruara nga specialisti i financës.

-Komisioni i inventarizimit për vitin 2023 kishte konstatuar në 9 raste me PV, teprica dhe mungesa të aktiveve si dhe parregullsi në administrimin dhe dokumentimin e aktiveve në përdorim të punonjësve në Drejtoritë Rajonale por këto nuk dokumentoheshin me proces verbal rakordimi përfundimtar, ku të pasqyrohej gjendja mes inventarve fizik dhe gjendjes kontabël, për rrjedhojë nuk saktësohet sistemimi i aktiveve që kanë në përdorim punonjësit, ku të kryheshin dhe të kontabilizoheshin diferencat eventuale (nëse ka).

Në raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik nuk kanë rezultuar diferenca dhe teprica, për rrjedhojë sistemimi konstatimeve të mësipërme rezulton të jetë bërë extra kontabël.

-Me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”, janë nxjerrë nga përdorimi 2 (Dy) Motoçikleta të cilët nuk figuronin në inventarët e institucionit, pamvarsisht se ishin pronë e institucionit.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” përgjegjësi e nëpunësit zbatues dhe sektorit të financës.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimi MF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, (pikat 13, 34-50 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, si dhe kërkesat e kreut IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”.

Ndikimi/Efekti: Mosdokumentim i saktë i aktiveve të institucionit, mosnjohje e situatës lidhur me gjendjen dhe efektivitetin e aktiveve.

	Shkaku: Mosfungsioni sa dhe si duhet i strukturave menaxhuese të Institucionit, në veçanti specialistët e financës/menaxhuesit të aktiveve si dhe komisioni i inventarizimit të aktiveve.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë
Konkluzioni	Mosfungsioni sa dhe si duhet i kontrollit të brendshëm, mospërcaktimi i sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, si dhe përgjegjësi konkrete të komisionit të ngarkuar me urdhër të brendshëm për të kryer inventarizimin e aktiveve.
Rekomandimi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori financës të dokumentojë dhe administrojë librat kontabël të aktiveve në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore të kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik. Procesi i inventarizimit fizik dhe dokumentimi i tij të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	

Opinion: Në përfundim të auditimit të procedurave dokumentare të hartuara nga njësi për administrimin e aktiveve të institucionit evidentojmë se, edhe pse institucioni në krahasim me periudhat e mëparshme ka punuar dhe ka një përmirësim të procesit, masat e marra për menaxhimin e aktiveve nuk kanë qënë të mjaftueshme dhe sistemi kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar si duhet në zbatim të kërkesave ligjore që lidhen me dokumentimin, sistemin e inventarizimit të aktiveve në pronësi të AMP.

Mbi nxjerrjet nga përdorimi të aktiveve:

-Me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”, janë nxjerr nga përdorimi 2 (Dy) Motocikleta, tipi Skuter Loncin me nr.shasie LLPTCKP45B1616177 dhe LLPTCKA04BA187004, pa targa.Nga auditimi u konstatua se, dy motoçikletat të cilët janë dërguar për miratim nga Ministri për nxjerrjen nga përdorimi si aktive të dëmtuara dhe të pa përdorshme, këto aktive nuk figuronin në inventarët e institucionit, pamvarsisht ishin blerë nga institucioni, por nga verifikimi i inventarve këto nuk figuronin në kontabilitet.Dy motoçikletat janë shkarkuar nga kontabiliteti me fd, nr.3 datë 15.11.2023.Gjithashtu po me këtë urdhër të Ministrit të Brendshëm janë nxjerr nga përdorimi edhe 2 (Dy) automjete, një VVolkswagen tipi Pasat me nr.shasie ËVÉZZZ3CZ8P034390, me targë XAA2293, dhe mjeti Foristrad marka Mitsubishi, tipi Pajero me nr, shasie JMB0NV440XJ001921 me targa POLICIA 1559.Mbas miratimit të nxjerrjes nga përdorimi është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP me nr.774 datë 03.11.2023.Komisioni i ngritur ka vepruar në përputhje me udhëzimin nr.3464 datë 22.04.2014, “Për përcaktimin e koeficientve të matëshëm në % si diferencë që përfshin peshën e xhamave, pjesëve plastike të kroskotit, sediljeve, tapiceris, gomave, parakolpit stopa fener etj, që për shkak të natyrës nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve”.Skarapi i përfutuar nga nxjerrja nga përdorimi

është 2793 kg,(Motoçikletat 121 kg, Pasati 1209 kg dhe Foristrada 1463 kg), skrapi është bërë hyrje me fh, nr.67 datë 15.11.2023. Skrapi është bërë dalje pa pagesë QFMT-së me fd, nr.1 datë 19.01.2024, bashkënjitur edhe miratimi i SP të MB me shkresën nr.18672/1 prot, datë 18.01.2024, “Për transferimin pa pagesë të një sasive skrapi”.

-Me nr.973 prot, datë 11.03.2024, AMP i ka dërguar Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Sherbimeve Mbështetse, “Kërkesën për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve të AMP”.konkretishtë automjetet janë:

1-Automjeti i markës Mitsubishi, tipi pajero 2,5 foristradë targa Policia 1555.

2- Automjeti i markës Mitsubishi, tipi pajero 2,5 foristradë targa Policia 1604.

3- Automjeti i markës Mitsubishi, tipi pajero 2,5 foristradë targa Policia 1610.

4- Automjeti i markës Mitsubishi, tipi pinin foristradë targa Policia 1579.

5- Automjeti i markës Land Rover, tipi Defender 2,5 foristradë targa TR 4212.

6- Automjeti i markës Seat, tipi IBIZA 1390 cc Lloji veturë targa AA 031 EA.

Nga auditimi i praktikës së dërguar u konstatua se bashkënjitur me shkresën përcjellse janë pasqyruar edhe të dhënat analitike për çdo mjet të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit, këto mjete që nga momenti që janë plotësuar dokumentet për nxjerrje nga përdorimi nuk janë funksionale, nuk furnizohen me karburant dhe ishin në pritje për miratimin nga MB për nxjerrje nga përdorimi.

Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm nr.73 datë 21.04.2022, “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të aktiveve të qendrueshme dhe qarkulluese, për vitin 2021”, është ngritur komisioni i përbërë nga A. Curi kryetar, L. Shehu, K. Dani, M. Peçi dhe A. Reka anëtarë.Komisioni i asgjësimit mbështetur në relacionin e komisionit të vlerësimit dhe të proces verbalit të vlerësimit të aseteve, asgjësoi në prani të të gjithë anëtarve të komisionit me mënyrën , shkatërrim djegje tjetërsim të aktiveve e paisjeve të ndryshme të teknologjisë informatike, gjithësej 91 artikuj për vlerën totale 5,671,766 lekë.E njejta procedurë është ndjekur edhe për vitin 2023 ku janë azgjësuar në raste për shumën 4,486,660 lekë dhe 6,729,600 lekë.

IV/8. Auditimi i organizimit dhe funksionimit të llogarive të sektorit material në shërbimet e Transportit, Armatimit.

Auditimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm/procedurave të shkruara që normojnë shërbimin material. Rregullshmëria në plotësimin e dokumentave të llogarisë sipas kërkesave të përcaktuara dhe veçorive të mbajtjes së llogarisë për shërbimet. Hapja e librave të llogarisë materiale, sipas përbërjes së tyre, plotësimi i kërkesave për mbajtjen e tyre, kontrolli i rregullshmërisë së regjistrimit të dokumentacionit përkatës në to, kuadrimi i tyre si dhe mbajtja e të dhënave nga njeri vit në tjetrin.

Auditimi mbi plotësimin e fletë-udhëtimeve, hapja e librit të punës së mjeteve, librezat e tyre, kartelat e gomave dhe regjistrimet përkatëse në to.

Hapja e librit të shpërndarjes së armatimit në efektiv, librit të numrave e gërmave të armëve dhe kuadrimi i tyre me librin e llogarisë materiale të armatimit.

-IV-8/1 Në shërbimin e Autotransportit.

Organizimi dhe funksionimi i shërbimit të transportit bazohej në, bazuar në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr.112 datë 18.04.2014, “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shoferve sipas Njësive Shpenzuese në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe të disa rregullave të përdorimit të mjeteve”,Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”, me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin

kapital të automjeteve”, është urdhëruar kalimi i mjeteve në inventar të Qendrës së Shfrytëzimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, (QSHAMT), të kalojnë në inventar të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA).Urdhëri i Ministrit të Brendshëm është shoqëruar dhe me inventarin e mjeteve që do të kalojnë në inventar të SHÇBA, numëri është 27 mjete (15 autovetura dhe 12 F/Strada), pra numëri limit i mjeteve është 27. Me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.80 datë 14.06.2023 “Për shtimin e limitit organik të mjeteve në Agjensinë e Mbikëqyrjes Policore”, numëri i automjeteve në inventar të AMP bëhet 31 (Tridhjet e një) automjete.

Nga auditimi i dokumentacionit të administrimit dhe shfrytëzimit të mjeteve u konstatua se nga ana e AMP nuk është kryer pranë DRTRR Tiranë ndryshimi i pronësisë/certifikatave të pronësisë së automjeteve, nga QSHAMT në pronësi të AMP, kjo për arsye se automjetet janë dorëzuar nga QSHAMT në Dhjetor 2021, pesë muaj nga dalja e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin kapital të automjeteve”, çka do të thotë se ndryshimi i pronësisë është kërkuar përtej afatit 30 ditorë, që parashikon neni 93 pika 1 e kodit rrugor të RSH, dhe sipas pikës 4 të këtij neni penaliteti me gjobë shkon nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë, ku për 27 mjete ky penalitet shkon në 540,000 lekë penalitet të cilin AMP nuk mund ta paguaj.

Inventari i mjeteve për periudhën nën auditim nuk ka qenë konstant, por ka patur lëvizje për shtesa dhe pakësime të numrit të mjeteve si më poshtë:

Për vitin 2022 ka patur këto lëvizje:

Me fletë hyrje nr.19 datë 14.07.2022 nga AMP është marr në inventar sipas vendimit nr.57 datë 21.06.2022, të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si dhe urdhërit të përbashkët për kalimin kapital të automjeteve nr.2007 prot, datë 06.07.2022 të AAPSK dhe nr.1467 prot, datë 07.07.2022 të AMP, mjetet që kanë kaluar në inventar të AMP janë; Volkswagen me targë AA794SO me vlerë 800,000 lekë dhe Mercedes Benz me targë AA010VS me vlerë 1,300,000 lekë.Me nr.1591 prot, datë 18.07.2022 është dërguar akt-konfirmimi për marrjen në inventar të mjeteve si dhe numëri i fletë hyrjes.

Me Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr.144 datë 29.07.2022 është urdhëruar kalimi kapital i një automjeti të tipit Ford Custrom, me targë MB 724 AA, nga DPPSH tek AMP.Mjeti është bërë hyrje me fh nr.22 datë 03.08.2022, dhe akt-konfirmimi është dërguar në QFMT me nr.1719 prot, datë 05.08.2022.

Për vitin 2023 institucioni i AMP, sipas vendimit nr.100 datë 24.04.2023, të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si dhe urdhërit të përbashkët për kalimin kapital pa pagesë të automjeteve nr.1521 prot, datë 05.05.2023 të AAPSK dhe nr.1361 prot, datë 08.05.2023 të AMP.Mjetet që kanë kaluar në inventar të AMP janë, Audi A6 me targë AA 472 OI me vlerë 400,000 lekë dhe Audi A4 me targë AA 853 PJ me vlerë 600,000 lekë. Automjetet janë bërë hyrje në AMP me fh nr.11 datë 30.05.2023.

Për vitin 2024 institucioni ka marr me kontratë Qiraje për pasuri të luajtshme (Automjete) nga AAPSK dy automjete.Me kontratën nr.2298 prot, datë 12.06.2024, të nënshkruar nga qiradhënësi Kryeadministrator i AAPSK dhe nga qiramarrësi Drejtor i Përgjithshëm i AMP, dy automjete të sekuestruara, automjetin BMVV me targë 03 866 EE dhe VVolkswagen Tiguan me targë 016111 IH.Kontrata e qira dhënies është me afat 1 (Një) vjeçar duke filluar nga 10.06.2024 deri më datën 09.06.2025, me të drejtë rinovimi.

Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.159 datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktive të tjera”, janë nxjerr nga përdorimi 2 (Dy) Motoçikleta, tipi Skuter Loncin me nr.shasie LLPTCKP45B1616177 dhe LLPTCKA04BA187004, pa targa.Nga auditimi

u konstatua se, dy motoçikletat të cilët janë dërguar për miratim nga Ministri për nxjerrjen nga përdorimi si aktive të dëmtuara dhe të pa përdorshme, nuk figuronin në inventarët e institucionit, këto aktive ishin blerë nga institucioni, por nga verifikimi i inventarve këto nuk figuronin në kontabilitet. Dy motoçikletat janë shkarkuar nga kontabiliteti me fd, nr.3 datë 15.11.2023.

Gjithashtu po me këtë Urdhër të Ministrit të Brendshëm janë nxjerr nga përdorimi edhe 2 (Dy) automjete, një VVolkswagen tipi Pasat me nr.shasie ËVËZZZ3CZ8P034390, me targë XAA2293, dhe mjeti Foristrad marka Mitsubishi, tipi Pajero me nr, shasie JMB0NV440XJ001921 me targa POLICIA 1559. Mbas miratimit të nxjerrjes nga përdorimi është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP me nr.774 datë 03.11.2023. Komisioni i ngritur ka vepruar në përputhje me udhëzimin nr.3464 datë 22.04.2014, “Për përcaktimin e koeficientve të matëshëm në % si diferencë që përfshin peshën e xhamave, pjesëve plastike të kroskotit, sediljeve, tapiceris, gomave, parakolpiti stopa fener etj, që për shkak të natyrës nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve”. Skrapa i përfutur nga nxjerrja nga përdorimi është 2793 kg, (Motoçikletat 121 kg, Pasati 1209 kg dhe Foristrada 1463 kg), skrapa është bërë hyrje me fh, nr.67 datë 15.11.2023. Skrapa është bërë dalje pa pagesë QFMT-së me fd, nr.1 datë 19.01.2024, bashkënjitur edhe miratimi i SP të MB me shkresën nr.18672/1 prot, datë 18.01.2024, “Për transferimin pa pagesë të një sasive skrapa”. Përdorimi i automjeteve në AMP mbështetet në “Rregulloren për Menaxhimin e mjeteve të Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhërin nr.415 datë 13.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH. Bazuar në nenin 28 pika 9 të rregullores, fletë udhëtimi plotësohet për çdo lëvizje të mjetit, nënshkruhet nga personi që e merr në dispozicion dhe mbyllet nga përdoruesi i mjetit.

Nga auditimi i dosjes së mjetit rezultoi:

Në dosjen e mjetit administroheshin; libreza e mjetit, kartelat e gomave të mjetit, kartela e ndërrimit të baterive, pagesat e siguracioneve dhe të taksave të paguara, urdhërat e transferimeve, ose të dhënies në përdorim të mjetit etj.

Nga auditimi i kartelave të gomave dhe baterive rezultoi se:

Kartelat e gomave ishin të hapura për çdo automjet në përdorim dhe për çdo gomë të automjetit, konformë kërkesave në nenin 26 pika 5, 6 të “Rregullores për Menaxhimin e mjeteve të Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhërin nr.415 datë 13.04.2022 të DPPSH. Zëvendësimi i gomave në përgjithsi bëhej për shkak të plotësimit të afatit për zëvendësimin e tyre, në bazë kilometrave të përshkruar (40,000 km + 20%), por mund të ndodhë që për shkak të shërbimeve operacionale të cilët kryen në terrene rurale zëvendësimi mund të bëhet bazuar në proces verbalin që mbahet në rastet e dëmtimit të gomës në këto terrene. Të dhënat e mësipërme janë të regjistruara në kartelat e hapura për çdo automjet dhe për çdo gomë gjë e cila mundëson ndjekjen dhe kontrollin e afatit të përdorimit për çdo automjet dhe për çdo gomë.

Kartelat e baterive, ndërrimi i baterive ishte bërë mbi bazën e urdhërve veprimi të lëshuar nga specialisti i sektorit të logjistikës. Zëvendësimi i tyre ishte bërë pasi kishin plotësuar afatet e përdorimit (24 muaj).

Nga auditimi i librezave të riparimit të mjeteve rezultoi se:

Libreza e mjetit model 22 pasqyronte emërtimin e mjetit, tipin, vitin e prodhimit, targën dhe vlerën fillestare të mjetit. Në brendësi libreza pasqyron lëvizjet e mjetit transferimet, Km e përshkruar sipas viteve, shpenzimet për riparimet e kryera sipas viteve, inventarin e paisjeve që ka mjeti. U konstatua se libreza ishte e azhornuar rregullisht.

Nga auditimi mbi plotësimin e fletë udhëtimeve rezultoi se:

Fletët e udhëtimit ishin të plotësuar sipas formatit standart të miratuar formularit 7/e, ishin të nënshkruara nga përdoruesi i mjetit për çdo rast lëvizje, ishin përlllogaritur dhe konfirmuar nga

Specialisti i Transportit dhe Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetse. Regjistrimi i kilometrave në fletë udhëtimit ishte sipas leximit të tahometrit.

Autorizimi i lëshuar për lëvizjen e mjetit:

Bashkëngjitur fletë udhëtimit kishte autorizim për lëvizje të mjetit miratuar nga titullarit i AMP, për lëvizjet e mjeteve në drejtorinë qendrore si dhe për lëvizjet e mjeteve të drejtorive rajonale kur këto lëvizje ishin jashtë qarkut që ato mbulojnë dhe autorizimin e lëvizjes së mjeteve në drejtorit rajonale të firmosur nga drejtori rajonal për lëvizje mjetesh deri në pesë ditë, brenda juridiksionit që mbulojnë këto drejtori rajonale.

Në drejtim të shpenzimeve të kryera me automjetet për konsumin e karburantit dhe justifikimin e tij pasqyrohet në fletëudhëtimet e mjeteve të cilët janë mbajtur e administruar nga struktura e AMP, e cila ka kryer edhe kontrollin e lëvizjeve të mjeteve, bazuar në sasi të e karburantit të furnizuar nga OE “Kastarati” nëpërmjet kartave elektronike të çdo mjeti.

Nga auditimi fletëudhëtimit të mjeteve rezulton se, për çdo lëvizje mjeti të regjistruar në fletëudhëtim nga përdoruesi mjetit është e rakorduar me autorizimin përkatës të lëvizjes të lëshuar sipas rastit nga drejtuesi njësisë. Sasia e karburantit që automjetet janë furnizuar në subjektin “Kastrati” për çdo fund muaji është dërguar elektronikisht në AMP dokument i cili ka sasinë mujore që mjetet janë furnizuar, sasi e cila është e rakorduar me furnizimin e çdo mjeti dhe justifikon konsumin sipas Km të përshkruara. Fletë udhëtimit e mjetit janë të konfirmuara e kontrolluara nga specialist shërbimit dhe drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetse në AMP. Furnizimi i mjeteve me karburant kryej me plan shpërndarje mujore, ndërsa për operacionet speciale të forcës operacionale akordohej shtesë plani. Për rastet e operacioneve të veçanta speciale mobilizimi i mjetve jo në inventar të AMP, aplikohet furnizimi i këtyre mjeteve, nëpërmjet kartës GOLD.

Normat e konsumit të karburantit të mjetve që aplikon AMP janë të bazuar në urdhërat e Ministrisë të Brendshme ndër vite për tipe të ndryshme mjetesh, si urdhëri nr.590 datë 01.11.2016 “Për miratimin e normës së konsumit të karburantit të një automjeti”, L.Rover Defender, vendimit nr.5601/3 prot, datë 15.09.2021 “Për miratimin e normave të konsumit të karburantit të disa mjeteve të transportit për disa njësi shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Brendshme”, vendimin nr.6720 datë 22.09.2020 të Komisionit të ngritur në MB, vendimin nr.5601/1 prot, datë 15.09.2021 të MB, vendimit nr.9780/1 prot datë 27.09.2022 dhe vendimit nr.18534/2 prot, datë 29.12.2023 të MB, “Për miratimin e normave të konsumit të karburantit të disa mjeteve të transportit për disa njësi shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Brendshme” .

Nga mjetet në inventar të AMP konstatohet se të gjithë mjetet janë të paisur me tahometër, nga i cili bëhet dhe azhurnimi i Km të përshkruar për efekt të përlllogaritjes së karburantit, automjetet janë të regjistruar në DRTRR Tiranë, në pronësi të QSHAMT, me çertifikat pronësie të pa ndryshuar. Të gjithë automjetet kanë kryer kontrollin teknik, me taksa dhe siguracion të paguar.

Furnizimi kryhet nëpërmjet sistemit të shpërndarjes së karburantit në mënyrë elektronike nga OE “Kastrati” shpk të shoqëruar për çdo rast me dokumente manuale që vijnë përmes postës si dhe të printuara nga sistemi, me të cilat vërtetohej sasia e karburantit të dhënë, specifikuar sipas llojit të tij. Sasia e karburantit, me të cilin furnizohet AMP, konfirmohet me fletë hyrje përkatëse.

Furnizimi i kartës për çdo mjet kryhet nga magazinieri, sipas planit mujor të shpërndarjes, të përgatitur nga Drejtoria Financës dhe Shërbimeve Mbështetse dhe me miratimin e Drejtuesit të njësisë shpenzuese, furnizimi kryhet nëpërmjet sistem-aplikacionit. Në fund të çdo muaji gjendja e karburantit zerohet, kthehet në magazinë elektronikisht, dhe në fillim të muajit bëhet veprimi i kundërt.

Nga auditimi rezultoi se ka përrputhje të plotë të të dhënave në lidhje me: planifikimin, furnizimin, gjendjen në fillim, ndryshimet (shtesa e pakësim) dhe gjendjen në fund të periudhës. Nuk ishin evidentuar probleme gjatë furnizimit të mjeteve në pikat e furnizimit me karburant të OE.

Konstatohet se llogaria elektronike pasqyron në mënyrë të saktë gjendjen në fillim të muajit, ndryshimet (shtesa e pakësim) gjatë muajit dhe gjendjen në fund të muajit. Nga auditimi rezulton se për këtë njësi shpenzuese nuk ka raste të raporteve të dyshimta apo të transaksioneve të shoqëruara me e-mail dhe foto për mospërrputhje targe me kartën e përdorur. Magazinieri kryen hyrje daljet e karburantit në llogarinë elektronike, duke i mbështetur dhe me dokumente të printuara dhe të nënshkruara. Për periudhën objekt auditimi janë furnizuar me karburant mesatarisht 26 mjete. Kjo njësi shpenzuese ka në përdorim 7 karta GOLD (5 karta për naftë dhe 2 karta për benzinë), kartat Gold përdoren vetëm për mjetet që nuk janë në inventar të AMP-së, por mobilizohen për operacionet speciale të karakterit sekret të forcës operationale, bazuar VKM nr.242, datë 20.04.2022, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 96 datë 08.06.2022 dhe në urdhërin nr.196 datë 06.07.2022 të Drejtorit të përgjithshëm të AMP, “Për miratimin e procedurave standarte të përdorimit të kartës elektronike GOLD”.

Nga auditimi u konstatua se kishte kartelë furnizimi për çdo mjet, ku pasqyroheshin furnizimet e bëra gjatë muajit, të plotësuar me nënshkrimet e furnizuesit (përgjegjësit material) dhe marrësit mallit (drejtuesi i mjetit). Në fund të muajit hartohej përmbledhësja e konsumit të karburantit. Furnizimi me karburant i AMP-së kryhej nga OE, ‘Kastrati’ bazuar në kontratën, marrveshje kuadër të lidhur mes OE dhe AMP, për benzinën kontrata me nr.279/3 datë 01.03.2022, dhe për naftën/gazoilin me nr.279/4 datë 01.03.2022.

Me datën 01.05.2022, institucioni ka patur gjendje 4075 litra naftë dhe 4770 litra benzinë, në fund të vitit 2022 ka patur 15470 litra naftë dhe 2686 litra benzinë, në fund të vitit 2023, ka patur 41683 litra naftë dhe 8650 litra benzinë dhe me datën 30.06.2024 kishte gjendje 29680 litra naftë dhe 11356 litra benzinë.

Riparimi i mjeteve kryhej nga operatori ekonomik “ALSTEZO” sha, bazuar në kontratën nr.783/1 datë 23.03.2023 të lidhur mes palëve me objekt, “Riparim mirëmbajtje e mjeteve të transportit të AMP”.

Titulli i gjetjes: AMP për mjetet në inventar nuk kishte bërë ndryshimin e çertifikatës së pronësisë së automjeteve, nga QSHAMT në pronësi të AMP.

Nr. Gjetjes 7	
Subjekti i audituar	Agjensia e Mbikëqyrjes Policore.
Njësit/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat Menaxhuese të AMP, MB.
Përmbledhja e bazës ligjore	Kodi Rrugor i RSH, neni 93, pika 1,4, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin kapital të automjeteve”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të administrimit dhe shfrytëzimit të mjeteve u konstatua se nga ana e AMP nuk është kryer pranë DRTRR Tiranë ndryshimi i pronësis/çertifikatave të pronësisë së automjeteve, nga QSHAMT në pronësi të AMP, kjo për arsye se automjetet janë dorëzuar nga QSHAMT në Dhjetor 2021, pesë muaj nga dalja e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin kapital të automjeteve”, çka do të thotë se ndryshimi i pronësisë

	<p>është kërkuar përtej afatit 30 ditorë, që parashikon neni 93 pika 1 e kodit rrugor të RSH, dhe sipas pikës 4 të këtij neni penaliteti me gjobë shkon nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë, ku për 27 mjete ky penalitet shkon në 540,000 lekë penalitet të cilin AMP nuk mund ta paguaj.</p> <p>Kriteri: Kodi Rrugor i RSH, neni 93, pika 1,4, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr.264 datë 28.06.2021, “Për kalimin kapital të automjeteve”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e situatës lidhur me administrimin e mjeteve, mosdokumentimi i pronësisë.</p> <p>Shkaku: Mosvlerësimi sa dhe si duhet i kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin dhe përdorimin e mjeteve në inventar të AMP.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I Mesëm
Konkluzioni	Mosfunksionim i plotë i kontrollit të brendshëm, në organizimin dhe menaxhimin e shërbimit të transportit.
Rekomandimi	Menaxhimi i lartë i AMP-së, Drejtoria e financës dhe e shërbimeve mbështetëse, të marrë masat e nevojshme procedurale, duke shmangur penalitetet për ndryshimin e çertifikatës së pronësisë së mjeteve që ka inventar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	menjëherë
Statusi i rekomandimit	

IV/8/2. -Në shërbimin e armatimit

Agjencia për Mbykëqyrjen Policore funksionon bazuar në ligjin nr.128 datë 20.12.2021, “Për Agjencinë e Mbykëqyrjes Policore”. Bazuar në këtë ligj kreu i VII, Të Drejtat dhe Detyrimet, neni 36, Mbajtja e armës, mjeteve dhe paisjeve, citohet se;

1.Punonjësit, që gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, mbajnë armë zjarri personale, mjete dhe pajisje të tjera në funksion të veprimtarisë së Agjencisë. 2. Punonjësi i Agjencisë përdor armatimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve. 3. Armatimi, mjetet dhe pajisjet që përdor Agjencia përcaktohen në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Referuar rregullores së brendshme të funksionimit të kësaj strukture, kreu i IV, Armët, Mjetet dhe Pajisjet, neni 49, Përcaktimi i armëve, mjeteve dhe pajisjeve, citohet se punonjësit që gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, mbajnë; armë zjarri, armë e shkurtër e zjarrit, municion për armën e shkurtër të zjarrit sipas kalibrave përkatës, me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit, si dhe mjete e pajisje të tjera në funksion të punës. Në zbatim të ligjit është dhe Urdhëri Ministrit nr.300, datë 06.10.2014 “Për procedurat e paisjes së personelit me armë zjarri si dhe mënyrën e administrimit dhe përdorimit të tyre”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar rezulton se nga struktura e miratuar prej 170 punonjësish, kanë të drejtën e mbajtjes së armës 146 punonjës, të cilët gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

Është kryer inventarizimi i përvitshëm në shërbimin e armatimit, kështu për vitin 2023 inventarizimi i shërbimit të armatimit është kryer nga komisioni prej tre anëtarësh të ngritur me urdhër të titullarit nr.20 datë 09.01.2024.

Në zbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 84, gërma ‘b’ për krahasimin e gjendjes faktike në magazinë bazuar në librat e llogarisë:

Armatimi ishte inventarizuar bazuar në inventarin e printuar mbi gjendjen e armatimit në efektiva, duke bërë verifikimin fizik të armëve, numërave të tyre, tipit, si dhe aksesorve të tjerë, bazuar në librin e llogarisë së armatimit model 28 për gjendjen e magazinës dhe në librin Model 37 për shpërndarjen e armatimit në efektiva.

AMP ka në inventarë gjithësej 80 (Tetëdhjet) armë brezi të llojeve të ndryshme, të cilët janë të shpërndara si më poshtë:

-Pistoletë Tip TT, 7.62 mm, Model 54 cpoë 1 (Një) që është gjendje në Depo.

-Pistoletë Tip Makarov, 9x18 mm, Model 59 cpoë 20 (Njëzet) nga të cilët: gjendje në Depon e institucionit janë 14 (Katërmëdhjet) copë, në efektiva janë 6 (Gjashtë) copë.

-Pistoletë tip Bereta 9x19, 92 FS, janë gjithësej 5 (Pesë) copë, nga këto në efektiva janë 3 (Tre) copë dhe në Depo janë 2 (Dy) copë.

-Pistoletë tip Bereta 9x19, Strom PX4, janë gjithësej 13 (Tremdhjet) copë, nga këto në efektiva janë 11(Njëmbdhjet) copë dhe në Depo janë 2 (Dy) copë.

-Pistoletë tip Zastava nr.710077, copë 1 (Një) gjendje në efektiva.

-Pistoletë (9x19mm) kombësi të ndryshme CZB7161K, copë 1 (Një) gjendje në Depo.

-Pistoletë (9x19mm) GLOCK GEN4, gjithësej 39 (Tridhjet e nëntë), nga këto janë në efektiva 34 (Tridhejtekatër) copë dhe janë në Depo 5 (Pesë) copë.

Në shërbimin e armatimit, dokumentimi dhe administrimi i llogarisë së armatimit, municionit dhe paisjeve speciale administrohet nga Shefi i Sektorit të Shërbimeve Logjistike dhe Burimeve Njerëzore z. I. Laçi.

Nga auditimi i vlerësimit të dokumentacionit të lëvizjes së armëve e municionit si dhe azhurnimit të librave të llogarisë së armatimit evidentojmë se; AMP bazuar në librin e llogarisë Mod.37 të regjistrimit të numrave e gërmës së armëve në administrim të institucionit rezulton se, ka në administrim vetëm armë brezi gjithësej 80 armë të tipeve e llojeve të ndryshme si; Pistoleta 9x19 mm, Pistoleta TT, Makarov, Bereta dhe Zastava.Ky numër armësh në organikën e AMP është i rakorduar me librat e llogarisë materiale për shumën e përgjithëshme në regjistrat Model 28 dhe 35 si dhe me gjendjen e armëve në magazinën e institucionit dhe ato të shpërndara në efektiva libri Model 37. Librat e llogarisë së armatimit dhe municioneve/paisjeve janë të sekretuar e të administruar saktë për të gjitha lëvizjet e armëve.

Në pikën 7 të urdhërit të MB nr.300, datë 06.10.2014 “Për procedurat e paisjes së SHÇBA me armë zjarri ...”, është e përcaktuar që, furnizimi me armë i kësaj njësie realizohet nga QFMT në DP të Policisë së Shtetit.

Nga auditimi i ditareve të llogarisë së armatimit sa i përket, regjistrimit të armëve dhe rakordimit me strukturat që kanë në administrim armët rezulton se, deri në fund të muajit Korrik 2024, nga 80 armë që ka në inventar dhe administrim, janë të shpërndara në efektiv 56 copë armë të ndryshme ndërsa 24 armë të tipeve të vjetra janë gjendje në depo të pa shpërndara në efektiv si rezultat i amortizimit e dëmtimit të tyre. Dokumentacioni lëvizjes së armës (Hyrje/Dalje), është i regjistruar në librat e llogarisë në sasi për copë dhe nuk plotësohet me vlerën e armës e për rjedhojë edhe kontabilizimi në llogari nuk kryhet për vlerën e armëve e municioneve si aktive nga sektori

financës, siç dhe përcaktohet në pikat 36 dhe 37 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Lëvizjet e brendshme të aramtimit për periudhën e auditimit si rezultat i largimeve dhe emërimeve të personelit edhe pse janë në numër të vogël për vitin 2023 janë (gjithsej 26 fletëdalje dhe 16 fletëhyrje), është dhe një fletë hyrje e jashtme me nr.1 datë 20.09.2023, nga QFMT furnizim me armë, si dhe konfirmarrja, të gjithë trasaksionet janë të regjistruara saktë.

U auditua rregullshmëria e shpërndarjes së armëve në efektiv dhe regjistrimi e rakordimi me librin Model 35 të armëve në përdorim nga efektiv e rezulton se, libri Model 35 ishte plotësuar saktë sa i përket konfirmimit nëpërmjet nënshkrimit nga punonjësit për armën e dorzuara në magazinë.

Në drejtim të shkarkimit të municionit evidentojmë se sasia e municionit që kjo strukturë ka në administrim sipas llojit e tipit të armëve është gjendje në institucion me përjashtim të sasisë së municionit që ka në administrim personeli. Struktura për vitin 2022 dhe 2023, dhe për 6-mujorin 2024 nuk ka kryer qitje stërvitore.

Titulli i Gjetjes: Nuk ishin administruar dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (*armë, municione e paisje speciale në sasi dhe vlerë*), sipas parashikimeve ligjore për administrimin e aktiveve në sektorin publik.

Nr. Gjetjes 8	
Subjekti i audituar	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.
Njësit/ subjektet e interesuara nga gjetja	Strukturat Menaxhuese të AMP, MB.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet qartë se; “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, pika nr.36 dhe 37.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (<i>armë, municione e paisje speciale</i>), nuk plotësohet i plotë sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit siç dhe përmban formati i miratuar i dokumentit (<i>emërtesa, njësia, sasia, çmimi, vlera, etj</i>). Gjithashtu regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave pa përcaktuar çmimin përkatës dhe vlerën e transaksionit. Vlera e armatimit municioneve e paisjeve speciale nuk ishte pasqyruar në kontabilitet dhe në bilancet kontabël. Kriteri: Udhëzimi i MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Ndikimi/Efekti: Impakti i këtij veprimi është se nuk pasqyrohet realisht në bilancin vjetor të Institucionit vlera e materialeve (<i>armatim, municion</i>

	<i>dhe paisje speciale</i>), të shërbimit të armatimit, pasi edhe këto mallra kanë një vlerë si të gjithë mallrat e tjerë, si të tillë duhet të pasqyrohen në bilancin e Institucionit. Shkaku: Mosvlerësimi sa dhe si duhet i kontrollit të brendshëm për zbatimin e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” i ndryshuar.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Mosfunksionim i plotë i kontrollit të brendshëm, në organizimin dhe menaxhimin e këtyre aktiveve.
Rekomandimi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me sektorin e armatimit në DP Policisë së Shtetit, të marrin masat që mallrat e materialet, (<i>armë, municione e paisje speciale</i>), të regjistruara deri më tani vetëm në sasi, të bëjnë përcaktimin e çmimeve të tyre dhe në vijimësi dokumentacioni të plotësohet i plotë duke i regjistruar me çmim dhe vlerën e tij. Të përfshihet në bilancin kontabël të Institucionit vlera e armatimit, municionit dhe paisjeve speciale, sipas inventarit, me mbylljen e viti ushtrimor 2024.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimsi dhe në bilancin e fund vitit 2024 të pasqyrohet dhe sektori i armatimit me vlerën përkatëse.
Statusi i rekomandimit	

V. PLAN VEPRIMI I REKOMANDIMEVE TË AUDITIT.

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik*”, i ndryshuar, të urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të MF “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, pika 4.1.12, për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit, grupi i auditimit, referuar gjetjeve të përshkruara në pjesën e parë “*Përmbledhje ekzekutive*” dhe të analizuar sipas sistemeve në pjesën IV “*Gjetje e konkluzione*” sipas nivelit të prioritetit rendit edhe rekomandimet si më poshtë :

PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1	Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masat e menjëhershme për zbatimin e plotë të rekomandimeve të trajtuara në pikën e parë në këtë material. Të hartojë planin e veprimit duke përfshirë të gjitha rekomandimet, të përcaktojë afatet, persona përgjegjës dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e tyre. Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas planit të veprimit.	<i>I mesëm</i>
2	Menaxhimi i lartë i AMP-së, referuar gjetjeve të konstatuara të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në përputhje me përcaktimet	<i>I lartë</i>

	<p>ligjore të komponentëve të MFK-së; hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara; hartimin e objektivave SMART (specifik/të matshëm/të arritshëm/reale dhe në kohën e duhur); përmirësimin e regjistrit të riskut i cili duhet të jetë i konsoliduar me të gjithë drejtoritë dhe sektorët; rishikimin e strukturës dhe organikës, përfshirjen, konform akteve ligjore e nënligjore për administratën publike, duke mundësuar optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion, me qëllim mundësimin e vendimmarrjeve cilësore, performancë në arritjen e objektivave të AMP-së.</p>	
3	<p>Menaxhimi i lartë i AMP-së të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet përcaktimeve me procedure standarte, të të gjitha fazave dhe veprimet konkrete që duhet të ndiqen për realizimin e procedurave prokurorese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (nisur nga kërkesë/nevoja për shërbim ose mallra dhe deri në marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave), referuar akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen dhe sigurinë dhe akteve ligjore e nënligjore për mirëpërdorimin dhe mirëadministrimin e fondeve buxhetore.</p> <p>-Drejtori i Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e regjistrave të prokurimeve në zbatim të plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e APP-së nr.4 datë 18.06.2021, të azhurnohet regjistri në sistemin elektronik të APP-së duke pasqyruar minikontratat e lidhura për procedurat marrëveshje kuadër.</p> <p>-Për të gjitha procedurat prokurorese, dokumentacioni përkatës për realizimin e procedurës ti referohet një numri protokoll (urdhrit të prokurimit) dhe të vijohet me të njëjtin protokoll me fraksion deri në përfundim dhe arkivimin e dosjes së prokurimit.</p>	<i>I lartë</i>
4	<p>Menaxhimi i lartë i institucionit, për pranimet dhe emërimet në punë të punonjësve të AMP-së të veprorë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të ligjit 128/2021 “Për AMP” dhe VKM nr.532/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e AMP”, referuar kritereve të përcaktuara për funksionin dhe përshkrimin e punës.</p> <p>-Sektori i Burimeve Njerëzore në hartimin e urdhrave për lëvizjet, transferimet, emërimet të evidentojë saktë elementët përbërës të pagës sipas funksionit si edhe vjetërsinë në punë</p>	<i>I lartë</i>
5	<p>Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori i financës, të marrin masat e duhura për sistemimin, pozicionimin dhe kontabilizimin e veprimeve në llogaritë përkatëse në bilancin kontabël të vitit 2024, duke zbatuar planin kontabël dhe standardet të miratura të kontabilitetit.</p>	<i>I mesëm</i>
6	<p>Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sektori financës të dokumentojë dhe administrojë librat kontabël të aktiveve në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore të kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik. Procesi i inventarizimit fizik dhe dokumentimi i tij të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p>	<i>I lartë</i>

7	Menaxhimi i lartë i AMP-së, Drejtoria e financës dhe e shërbimeve mbështetëse, të marrë masat e nevojshme proceduriale, duke shmangur penalitetet për ndryshimin e çertifikatës së pronësisë së mjeteve që ka inventar.	<i>I mesëm</i>
8	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me sektorin e armatimit në DP Policisë së Shtetit, të marrin masat që mallrat e materialet, (<i>armë, municione e paisje speciale</i>), të regjistruara deri më tani vetëm në sasi, të bëjnë përcaktimin e çmimeve të tyre dhe në vijimësi dokumentacioni të plotësohet i plotë duke i regjistruar me çmim dhe vlerën e tij. Të përfshihet në bilancin kontabël të Institucionit vlera e armatimit, municionit dhe paisjeve speciale, sipas inventarit, me mbylljen e viti ushtrimor 2024.	<i>I mesëm</i>

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 4.1.12, një kopje e Projekt Raportit duhet të kthehet pranë njësisë audituese të MB ***brenda 10 ditë pune*** nga marrja në dorëzim e Projekt Raportit. Nëse keni argumenta ligjorë apo dokumente mbështetëse, mund të bëni shpjegime në lidhje me përmbajtjen e Projekt Raportit ose t’i kërkoni Drejtorisë së Auditimit në MB, një takim përfundimtar për të rënë dakord për përmbajtjen dhe rekomandimet paraprake të Projekt Raportit. Në Projekt Raport kemi lënë rekomandime, për të cilat institucioni do të hartojë një plan veprimi me përgjegjës konkrete dhe afate konkrete për realizimin e tyre.

GRUPI I AUDITIMIT

Arbëresha Zyka

Mezan Hoxha

Alena Skënderi